5. Për llogaritja e vlerës limit të kontratave për blerjen e prokatit të targave dhe të lejeve të drejtimit është bërë duke marrë për bazë çmimet mesatare të tregut. Ndërsa në rregullat e prokurimit publik ndër të tjera përcaktohet si alternative edhe çmimet e tregut, por nuk përcaktohen se në llogaritjen e vlerës limit mëren për bazë çmimet mesatare apo çmimi me i ulët i tregut. Kjo llogaritje është mbështetur në bazë të shkresës APP në të cilën interpreton se: "në llogaritjen e fondit limit duhet pasur parasysh mesataren e ofertave". Kjo mënyrë llogaritje lehtë hapësira për abuzime, pasi mesatarja mund të dali nga një numër i vogël ofertuesish të cilat mund të paraqesin çmime të larta e për pasojë vlerat e kontratave rriten fiktivisht. Për të konkretizuar këtë, po japim një shembull, konkret: për llogaritjen e fondit limit për blerjen e një artikulli të vetëm të prokatit të targave, po të merreshin për bazë çmimet me të ulët të tregut dhe jo çmimet mesatare, do të kishim ulje të fondit limit vetëm për këtë artikull në masën 14,824,000 leke.

6. Gjatë procesit të zbatimit të punimeve në objektin "Ndërtimi i zyrave të reja të DRSHT, Tiranë" janë kryer investime pa efektivitet, pasi janë bërë ndryshime të projektit të zbatimit që lidhen me sistemin e ngrohje- ftohjes, duke nxjerr jashtë funksionit 257.46 m² sipërfaqe bodrumi në vlerën 2,350,000 lekë.

7. Gjatë viteve 2009,2010 dhe 2011 për kompletimin e zyrave të reja të DRSHT, Tiranë, janë kryer blerje me objekte të ndryshme në shumën totale 4,369,200 lekë. Këto blerje janë bërë me procedura të thjeshtuara "blerje me vlerë të vogël" të ndara në tre vite buxhetore. Meqenëse këto objekte janë pjesë e godinës së re dhe përfshihen të gjitha në vlerën totale të saj; duhej të parashikoheshin që në projektin dhe preventivin fillestar të zbatimit.

8. Në strukturën e preventivit të zbatimit të objektit "Instalimet elektrike në gabine në rrjetin e jashtëm dhe gjenerator për zyrat e reja të DRSHTRR, Tiranë" është parashikuar gabimisht edhe vlera e TVSH për makineritë e pajisjet teknologjike duke rritur kështu koston e ndërtimit të këtij objekti për vlerën 806,830 lekë.

9. Në tenderin për blerjen e pajisjeve për mobilimin e zyrave të reja të DRSHTRR, Tiranë, me fond limit në vlerën 22,815,936 lekë, kërkesat specifike për kualifikim janë vendosur në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Kjo është bërë shkak për skualifikime të padrejta të disa operatorëve pjesëmarrës në tenderë, duke çuar në anulimin e tre procedurave radhazi. Pas anulimeve, doli e nevojshme rishikimi i specifikimeve teknike. Kështu, detyra e projektimit, preventivi, fondi limit, specifikimet teknike dhe skicat, të përgatitur më parë me



vlerë 470,012 lekë, dolën të papërdorshme. Përgatitja e tyre ju ngarkuan dhe njëherë tjetër një personit fizik, i cili u pagua për këtë shërbim vlerën 202,500 leke. *Nga ky veprim i është shkaktuar të kësaj ndërmarrje dëm ekonomik në vlerë 470,012 leke, pasi është pagur dy here njëjta punë.*

Pas kësaj filluan përsëri procedurat e këtij tenderit, tashme me vlerë të fondit limit të reduktuar në 14,563,975 lekë. KVO ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi ka skualifikuar padrejtësisht *dy operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit, për pasojë kostos e blerjeve e këtyre pajisjeve është rritur në vlerën 2,276,500 leke.*

Për të bërë sa më bindëse këto shkelje vlen të theksojmë se, sektori i Auditit të Brendshëm, ka ushtruar kontroll tematik vetëm për procedurën e fundit dhe për zbatimin e kontratës. Në observacionet e paraqitura për këtë auditim nga dy anëtarë të KMD në përbërje të të cilit është edhe një anëtar i KVO, është thënë që, "parregullsitë në marrjen në dorëzim të pajisjeve kanë ardhur sepse 20% e mallit është lëvruar para përfundimit të procedurës së prokurimit". *Pra, ky deponim përforcon shkeljet e konstatuara nga kontrolli që ka gjykuar se, procedurat e prokurimit janë kryer formalisht dhe fituesi është parazgjedhur nga Autoriteti Kontraktor.*

Po kështu nga kontrolli mbi sasitë e furnizuara dhe cilësinë e prodhimit të këtyre pajisjeve u konstatuan se, pajisjet nuk ka ardhur në përputhje me specifikimet teknike siç kërkohet në kontratën e lidhur dhe në dokumentet e tenderit, konkretisht, nuk janë sjell 30 cope pajisje të ndryshme dhe në vend të tyre janë sjell mobilie të tjera si dhe pajisjet janë marrë në dorëzim me mungesa për pasojë është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 385,600 lekë.

Për të gjitha shkeljet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. Elez Gjoza i cili ka pranuar furnizimin e mallit para se të përfundonin procedurat e prokurimit.

10. Është vërejtur mungesë bashkëpunimi midis organeve të policisë së shtetit, organeve tatimore dhe DPSHTRR, pasi:

Gjate shërbimeve të radhës që kryejnë pronarët apo drejtuesit e mjeteve, nuk u kërkohet dokument që vërteton se, nuk kanë detyrime ndaj organeve të policisë rrugore për gjoba nga kundravajtjet administrative. Mungesa e këtij rakordimi sjell shmangien e këtyre gjobave, pasi njëti humbet gjurmët lehtësisht duke ndërruar targën pikërisht vetëm për shkak të gjobave të papaguara.

11. Po kështu edhe subjektet që janë debitorë ndaj zyrës së tatimeve kryejnë lehtësisht shërbimet pa u penguar, pasi nuk u kërkohet ndonjë dokument që i kanë shlyer detyrimet ndaj zyrës së tatimeve dhe anasjelltas zyra e tatimeve u kryhen veprime subjekteve pa u kërkuar me parë dokument që të vërtetojë se kanë paguar detyrimet ndaj DPSHTRR. Këto veprime sjellin mosarkëtim të vlerave monetare në favor të buxhetit të shtetit.

Nisur nga zbulimet e gjetura nga ky auditim ne rekomandojmë:

A. Ndryshime dhe përmirësime në legjislacionin në fuqi:

1. Reforuar disa tregueseve që pasqyrojnë rezultatet e drejtimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, ecuria e kësaj Drejtorie në dukje është pozitive dhe tejte e shëndoshë financiarisht, pasi për vitin 2010 ka realizuar fitim bruto 310,655,100 lekë. Por, nga analiza e të ardhurave të arkëtuara sipas objektit kryesor të veprimtarisë për të cilën është krijuar kjo ndërmarrje, vërejmë se, nga totali i të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2010 prej



1,334,976,608 lekë, 76.7% e tyre ose 1,023,927,058 lekë janë të ardhura të shfrytëzimit, të cilat janë përcaktuese në ecurinë e shoqërisë. Pjesa tjetër prej 311,049,549 lekë janë të ardhura që nuk kanë të bëjnë me aktivitetin kryesor të kësaj ndërmarrje, pasi janë të ardhura dytësore.

Pjesën më të madhe të këtyre të ardhurave e zënë të ardhurat nga kryerja e veprimtarisë si agjent tatimor për mbledhjen e taksave kombëtare për të cilat përfiton 5-6% të tyre, konkretisht, për vitin 2010 ka përfituar rreth 305 milion leke. Pra, fitimi para tatimit për vitin 2010 është 310,655,100 leke, ndërsa të ardhurat nga agjenti tatimor janë 305 milion lekë, prej ku del qartë se, rezultati financiar pozitiv i ndërmarrjes ka ardhur nga aktiviteti si agjent tatimor. Po kështu, vlerat e tarifave të shërbimeve nga ky përfitohen të ardhurat e shfrytëzimit mbartin në strukturën e çmimit një norme fitimi tejte të lartë që shkon rreth 50-60 % kundrejt shpenzimeve të përgjithshme.

Nisur nga analizat e mësipërme ku dalin në pah rezerva në menaxhimin dhe administrimin e ndërmarrjes, si dhe nga Urdhri 8, datë 29.05.2008 i Ministrit të PPT, me anën e të cilit, Ministri ka të drejtë të urdhëroje derdhjen në buxhetin e shtetit të fondeve të tepërta të krijuara nga fitimet e ndërmarrjes, konkretisht gjatë vitit 2010 nga fitimi i ndërmarrjes janë derdhur në buxhetin e shtetit 200 milion lekë, me qëllim përmirësimin e formës së drejtimit të kësaj ndërmarrje e cila ka statusin juridik "Ndërmarrje Shtetërore me vetëfinancim, rekomandojmë që:

-Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit duhet të rishikojë:

-VKM nr. 343, datë 21.07.1999 "Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor"

- Statutin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor nr.40703, datë 22.01.1999 i miratuar nga Ministri i Transporteve dhe Telekomunikacionit, i ndryshuar me Urdhrin nr.80, datë 29.05.2008 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

B. Masa Organizative

1. Në vlerën e tarifës janë përfshirë të gjitha shpenzimet që kryhen për shërbimin e ofruar dhe mbi këtë vlerë është parashikuar që ndërmarrja të këtë 25% rentabilitet. Po kështu u analizua edhe çmimi i materialeve që kanë të bëjnë me blerjen e lëndës së parë dhe prodhimin e tyre e u vërejtë se, mbi shpenzimet e përgjithshme është shtuar edhe një norme fitimi prej 30%. Pra, vlerat e tarifave të shërbimeve kanë në vetvete dy norma fitimi, një norme prej 30 % të çmimit të shitjes së prodhimit të materialeve dhe një norme fitimi 25 % të shitjes përfundimtare të shërbimit, si dhe të gjitha këto vlera pothuajse nuk kanë pësuar ndryshime që nga vitit 2008. Me qëllim përmirësimin e këtyre tarifave rekomandojmë që:

- Të rishikohen dhe të rivlerësohen të gjitha vlerat e tarifave të shërbimeve dhe për çdo vit të korrektohen në bazë të indeksit që tregon inflacionin zyrtar, referuar të dhënave të nxjerra nga Instituti i Statistikave (INSTAT).

- Tarifat e reja të propozohen për miratim Këshillit Drejtues dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

2. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm janë bllokuar dhe nuk lëvizim të gjitha automjetet që janë në dispozicion të sektorëve të Kontrollit Rrugor. Mungesa e këtij kontrolli, përveç mosarkëtimit të të ardhurave nga gjobat për kondravajtjet administrative, sjell indirekt edhe humbje të tjera që vijnë si pasojë e mos detyrimit të paraqitjes së shume subjekteve në spotelet e DRSHTRR për të shlyer detyrimet e prapambetura që kanë ndaj saj.

Me qëllim eliminimin e këtyre pasojave rekomandojmë:



- Të shfuqizohet Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Transportit Rrugor Nr. 168, datë 01.04.2011 "Për përdorimin e automjeteve të Sektorit të Kontrollit Rrugor".
- Fillimin e menjëhershëm të punës së sektorëve të kontrollit rrugor në Drejtoritë Rajonale.

3. Nga rakordimi e numrit të mjeteve që kanë kryer kontroll teknik të detyrueshëm nga koncesionari me numrin e mjeteve të regjistruara të cilat kanë paguar taksat vjetore në DPSHTRR, rezultoi se, 6,655 mjete kanë paguar taksat vjetore, por nuk kanë kryer kontrollin teknik të detyrueshëm. Mos kryerja e kontrollit teknik, sjell mosarkëtim të tarifave të këtij shërbimi në arkën e koncesionarit dhe për pasojë edhe mosarkëtim të të ardhurave për buxhetin, pasi koncesionari në zbatim të kontratës së koncesionit ka detyrimin t'i paguaj buxhetit të shtetit një tarifë prej 5% të xhiros vjetore.

Me qëllim eliminimin e këtyre pasojave rekomandojmë:

- Të bashkëpunohet me koncesionarin për të gjetur mënyrën zgjidhjes që automjetet të cilat paguajnë taksat vjetore, detyrimisht nuk duhet të shmangin kontrollin teknik të detyrueshëm e për pasojë pagimin e tarifave për këtë shërbim.

4. DPSHTRR aktualisht kryen funksionet, bazuar në Rregulloren e Brendshme të DPSHTRR, dërguar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit me shkresën Nr. 4463, datë 24.09.2003 dhe nuk i përgjigjet ndryshimeve strukturore që ka pësuar ky institucion në vite. Me qëllim përmirësimin e gjendjes rekomandojmë:

- Të merren masa për hartimin e Rregullores së funksionimit të DPSHTRR në përputhje me strukturat aktuale të organizimit të drejtorisë së përgjithshme dhe Njësive të varëtisë.
- Të reflektohen në rregullore të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" në lidhje me përgjegjëshmërinë menaxheriale kompetencat dhe përgjegjësitë e Nëpunësit Autorizues, Nëpunësit Zbatues dhe Menaxherët e tjerë të Njësive.

5. Të merren masa që të reflektohen në organigramë dhe në rregullore linjat e varëtisë dhe të raportimit të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues të Njësive,

6. Në rregulloren e Personelit të përcaktohen procedurat (konkurrim, përzgjedhje etj.) që do ndjekë institucioni për rekrutimin dhe për vlerësimin e performancës së punonjësve.

7. Të merren masa që nën përgjegjësinë e Nëpunësit Autorizues të DPSHTRR të hartohet strategjia e riskut si dhe të përcaktohen procedurat për menaxhimin e riskut.

8. Gjatë shërbimeve të radhës që kryejnë pronarët apo drejtuesit e mjeteve në sportelet e DPSHTRR, nuk u kërkohej dokument që vërteton se, nuk kanë detyrime ndaj organeve të policisë rrugore për gjoba nga kondravyajtjet administrative. Mungesa e këtij rakordimi sjell shmangien e këtyre gjobave, pasi mjeti humbet gjurmët lehtësisht duke ndërruar targën pikërisht vetëm për shkak të gjobave të papaguara.

Me qëllim eliminimin e këtyre pasojave rekomandojmë:

- Të bashkëpunohet me organeve të policisë së shtetit, dhe DPSHTRR, me qëllim paraqitjen reciproke të dokumenteve që të vërtetojnë shlyerjen të detyrimeve të ndërsjella të të dy institucioneve.



9. Subjektet që janë debitorë ndaj organeve tatimore kryejnë lehtësisht shërbimet pranë sporteleve të DPSHTR pa u penguar, pasi nuk u kërkohet ndonjë dokument që i kanë shlyer detyrimet ndaj organeve tatimore dhe anasjelltas zyra e tatimeve u kryhen veprime subjekteve pa u kërkuar me parë dokument që të vërtetojë se kanë paguar detyrimet ndaj

DPSHTRR. Këto veprime sjellin mosarkëtim të vlerave monetare në favor të buxhetit të shtetit. Me qëllim eliminimin e këtyre pasojave rekomandojmë:

- Të bashkëpunohet me organet tatimore, me qëllim paraqitjen e dokumenteve reciproke që të vërtetojnë shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella të të dy institucioneve.

10. Për kompletimin e zyrave të reja të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Tiranë, në disa raste janë kryer investime për objekte të ndryshme në shumën totale 4,369,200 lekë. Meqenëse këto investimet janë pjese e godinës së re dhe nuk janë përfshirë në vlerën totale të saj, rekomandojmë që:

- Vlera prej 4,369,200 lekë të regjistrohet në kontabilitet duke i shtuar vlerën godinës së re të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Tiranë.

11. Përllogaritja e vlerës limit të kontratave për blerjen e prokatit të targave dhe të lejeve të drejtimit bëhet duke marrë për bazë çmimet mesatare të tregut. Ndërsa në rregullat e prokurimit publik nuk përcaktohen se në llogaritjen e vlerës limit merren për bazë çmimet mesatare apo çmimi më i ulët i tregut. Kjo llogaritje është mbështetur në bazë të shkresës APP Nr. 1370/1, datë 24.08.2006 në të cilën interpreton se: "në llogaritjen e fondit limit duhet pasur parasysh mesataren e ofertave". Kjo mënyrë llogaritje krijon hapësira për abuzime, pasi mesatarja mund të dali nga një numër i vogël ofertuesish të cilat mund të paraqesin çmime të larta e për pasojë vlerat e kontratave rriten fiktivisht. Me qëllim eliminimin e kësaj pasoje rekomandojmë që:

- Të kërkohet interpretim dhe të merret miratim nga APP, që vlera limit e kontratave të dalin nga llogaritja mesatare e çmimeve të tregut bazuar në 5 oferta të marra nga tregu, ose llogaritja të bëhet në bazë të ofertës më të ulët të tregut.

12. Të analizohet gjendja, të nxirren përgjegjësitë dhe të merren masa ndaj punonjësve përgjegjës për:

- Demin ekonomik të shkaktuar në vlerën totale 4,864,009 lekë. Kjo vlerë përfaqëson pagesat e dyfishta për të njëjtin vend pune për 5 punonjës të larguar nga puna, gjatë periudhës 01.10. 2009- 31.12.2011, të cilët janë shpërblyer në bazë të vendimeve të Gjykatave, si pasojë e vendimmarrjeve të padrejta të ish-Drejtnesve të DPSHTRR.

- Demin ekonomik të shkaktuar në vlerën totale 10,679,066 lekë, pasi gjatë periudhës 01.10. 2009- 31.12.2011 në bazë të vendimeve të Gjykatave, si pasojë e vendimmarrjeve të padrejta të ish-Drejtnesve të DPSHTRR, janë shpërblyer 15 punonjës të larguar nga puna.

C. Masa për shpërblimin e demit ekonomik

1. Të ndiqen procedurat ligjore për t'i kërkuar, z. Elez Gjoza me, detyrë ish-Drejtor Rajonal i Shërbimit të Transportit Rrugor, Tiranë, shpërblimin e demit ekonomik në shumën 470,012 lekë. Kjo vlerë përfaqëson pagesën e shërbimit për përgatitjen dhe hartimin e projektit, preventivit, specifikimet teknike dhe skicave për pajisjen dhe mobilimin e zyrave të reja të



DRSHTRR, Tiranë. Por, kjo punë e paguar dhe ky produkt ka dalë i pa përdorshëm, pasi kryerja e këtij e shërbimi ju ngarkua edhe njëherë tjetër një personit fizik për të cilën është paguar përsëri në vlerën 202,500 leke.

2. Të ndiqen procedurat ligjore për t'i kërkuar firmës ndërtuese "Vila, sh.p.k", shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën 806,830 lekë. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht gjatë zbatimit të kontratës për "Instalimet elektrike në gabine, në rrjetin e jashtëm dhe në gjenerator për zyrat e reja të DRSHTRR, Tiranë", pasi ka llogaritur, situacionuar dhe përfituar TVSH mbi vlerën e makinerive e pajisjeve në shumën 806,830 leke.

3. Të ndiqen procedurat ligjore për t'i kërkuar firmës "A.P.G", shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën 385,600 lekë. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht gjatë zbatimit të kontratës për furnizimin me pajisje dhe mobilimin e zyrave të reja të DRSHTRR, Tiranë, pasi pajisjet nuk janë në përputhje me specifikimet teknike siç kërkohet në kontratën e lidhur dhe në dokumentet e tenderit, si dhe janë marrë në dorëzim me mungesa për pasojë është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën e mësipërme.

4. Të ndiqen procedurat ligjore për t'i kërkuar Anëtareve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave: z. Eduart Gjermeni z. Adil Gjoni, z. Gjovalin Sula, z. Adriatik Gjura dhe z. Rasim Altushi, dhe ish-Drejtor Rajonal i Shërbimit të Transportit Rrugor, Tiranë z. Elez Gjoza shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën 728,196 lekë. Këta punonjës kanë vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik në tenderin "për blerjen e pajisjeve dhe mobilimin e zyrave të reja të DRSHTRR, Tiranë", me fond limit 14,563,975 lekë, pasi tre operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën e mësipërme. Pasoja e kësaj shkeljeve ka sjell rritje fiktive të kostos së blerjes së pajisjeve në vlerën 2,276,500 lekë.

Hyrja

Përshkrimi i çështjeve që auditohet:

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, zbatimi i programit financiar, zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, me ligjshmëria e planifikimit dhe përdorimit të të ardhurave, rregullat e prokurimit, etj.

Auditimi u krye në përputhje me: ligjin 7582, datë 13.07.1992 "Për Ndermarrjet Shtetërore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", VKM nr.343, datë 21.07.1999 "Për krijimin e DPSHTRR", Statutin e DPSHTRR si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e kësaj ndermarrje.

Objektivi kryesor i subjektit të audituar:

Kjo ndermarrje ka për objektivi:



- Regjistrimi i mjeteve, pajisja e tyre me leje qarkullimi, targa, regjistrimi i pronarëve dhe pajisja me certifikata pronësie;
- Kualifikimi dhe pajisja e drejtuesve të mjeteve me leje drejtimi;
- Kontrolli teknik i detyrueshëm i mjeteve rrugore;
- Krijimi i regjistrit kombëtar të mjeteve dhe drejtuesve të tyre;
- Organizimi për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit bazë për transportin rrugor;
- Kryerja e veprimtarisë së "agjentit tatimor", sipas përcaktimeve ligjore;
- Dhënia e lejeve të veprimtarisë së autoshkollave; etj.

Qëllimi dhe procesi i auditimit:

Subjekti i audituar: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Çështjet e audituara: Zbatimi i programit financiar, zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, me ligjshmëria e planifikimit dhe përdorimit të të ardhurave, rregullat e prokurimit, etj.

Objektivat e auditimit: Auditimi i zbatimit të ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare dhe vlerësuese, për periudhën 01.10.2009 deri më 01.12.2011.

Rezultatet e auditimit:

I. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në kontrollin e mëparshëm

Me shkresën Nr 511/6 datë 15.04.2010, KLSH ka dërguar Raportin Përfundimtar dhe Rekomandimet e Kontrollit të ushtruar në këtë drejtori për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2008 deri në 31.09.2009. Në zbatim të këtyre rekomandimeve, DPSHTRR ka hartuar programin përkatës nr.237, datë 22.04.2010 për zbatimin e masave dhe rekomandimeve të KLSH-së duke përcaktuar afatet konkrete, strukturat dhe e personat përgjegjës si dhe me shkresën nr. 2443/1, datë 07.05.2010 i ka kthyer përgjigje KLSH-së brenda afatit ligjor prej 20 ditësh për marrjen e masave dhe ndjekjen e rekomandimeve. Me vone me Programin e Kontrollit nr. 337/13, datë 16.06.2010 të miratuar nga ish-Kryetari i KLSH është kryer verifikimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve. Sipas aktverifikimit datë 22.06.2010 të mbajtur nga grupi i kontrollit të gjitha rekomandimet e lëna janë realizuar.

II. Auditimi mbi zbatimin e programit financiar

Nga auditimi rezultoi se:

a. Mbi zbatimin e programit financiar, analizë e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt kuotave të programuara, realizimi i investimeve, detajimi në nivel projekti, etj.

Për vitin 2010

Në bazë të shkresës së Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Z. Sokol Olldashi nr. 570/1, datë 16.02.2010 "Mbi miratimin e Programit ekonomik për vitin 2010 të DPSHTRR-së", është miratuar programi ekonomik për vitin 2010, sipas propozimit të DPSHTRR-së dërguar me shkresë nr. 558, datë 28.01.2010.

Programi Ekonomik për vitin 2010 me pjesët përbërëse të tij, është miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 1, datë 26.01.2010 "Për miratimin e programit ekonomik të vitit 2010".

1

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

26

27

28

29

30

31

32

33

34

35

36

37

38



Për vitin 2010, programimi dhe zbatimi i programit ekonomik-financiar sipas treguesve përkatës, paraqitet si më poshtë:

Programimi

Të ardhurat

Niveli i të ardhurave në total për vitin 2010 është parashikuar 1,494,900 mijë lekë, me një ulje rreth 3.21 % ndaj realizimit të pritshëm të vitit 2009, ose 10.7 % më pak se programi i këtij viti. Kjo ulje e të ardhurave është rezultat i dhënies me koncesion të aktivitetit të kontrollit teknik, pasi për periudhën 9 mujore të vitit 2009 ky aktivitet ka zënë 15.89 % të të ardhurave të planifikuara dhe 15.49% të të ardhurave të realizuara. Rritje të të ardhurave janë parashikuar në të gjithë sektorët e aktivitetit të drejtorisë.
Për vitin 2010 është planifikuar dhe efekti ekonomik i aplikimit të disa tarifave të reja të miratuara për Drejtorinë e Regjistrimit të Mjeteve.

Shpenzimet

Niveli i shpenzimeve për vitin 2010 parashikohet të jetë 1,153,170 mijë lekë. Janë planifikuar 27 zera shpenzimesh, prej të cilave pesha kryesore i takon zërit "Pagat e punonjësve" me 487,684 mijë lekë i cili së bashku me zërin "Shpërblime nga taksat" me 97,537 mijë lekë, të dyja me 585,221 mijë lekë, zënë 50.7 % të totalit të shpenzimeve të planifikuara të DPSHTRr-së.
Zëri "Shpërblime nga taksat" është llogaritur për një pagesë shtesë prej 2.4 paga për çdo punonjës, sipas urdhërit të Ministrit, bazuar në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare
Zëri "Blerje materiale me vlerë" është parashikuar të jetë 189,000 mijë lekë dhe pas zërit të pagave, zë vendin e dytë prej 16.4 % të totalit të shpenzimeve.

Rezultati financiar

Nisur nga niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve, në programin e vitit 2010, fitimi bruto është parashikuar në vlerën 341,730 mijë lekë dhe fitimi neto 307,557 mijë lekë. Nga ky rezultat është krijuar fondi rezervë në masën 15,378 mijë lekë dhe fondi i veçantë 24.384 mijë lekë, ndërsa fondi i zhvillimit arrin vlerën 267,795 mijë lekë.

Programi i treguesve të punës

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2010 është parashikuar të jetë 660 punonjës të emëruar, nga 648 punonjës të emëruar në fund të vitit 2009. Ulja e numrit të punonjësve është parashikuar si rezultat i dhënies me koncesion të aktivitetit të kontrollit teknik, ndërsa krahasuar me gjendjen në fund të vitit ka një rritje të numrit të punonjësve me 12 punonjës për shkak të marrjes së aktivitetit të ri të tahogرافit.

Realizimi

Të ardhurat

Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2010 janë në shumën prej 1,330,336 mijë lekë, në një kohë që të planifikuara për këtë periudhë kanë qënë 1,494,900 mijë lekë, duke patur një realizim në përqindje prej 89 %, pra rezultojn me mosrealizim të të ardhurave në fakt, krahasuar me nivelin e programimit, për këtë vit.

Duke krahasuar këto nivele me ato të vitit 2009, rezultojn një ulje në vlerë prej 58,732 mijë lekë.

Për periudhën në fjalë, paraqiten me tejkalim të të ardhurave 3 njësi të vartësisë dhe me mosrealizim të të ardhurave 11 njësi dhe konkretisht Drejtoritë Rajonale Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe DTSH.



Struktura e të ardhurave të realizuara në përqindje, sipas natyrës së aktiviteteve të kryera në sistemin e DPSHTRr-së, janë si më poshtë:

- Regjistrimi i mjeteve 31 %
- Lejet e drejtimit 38.6 %
- Taksat 22.69 %
- Kontrolli rrugor 1.65 %
- Të tjera 5.97 %

Realizimi i të ardhurave sipas zërave, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Realizimi për vitin 2010				Në mijë lekë	
Nr.	Zërat e të ardhurave	Programi	Realizimi	Diferenca	
				Tejkalim	Mosrealizim
1.	Regjistrimi i mjeteve	547,800	413,505	-	134,295
2.	Lejet e drejtimit	579,300	513,523	1,253	-
3.	Taksat	300,650	301,903	3,918	-
4.	Kontrolli rrugor	20,400	24,318	30,337	-
5.	Të tjera	46,750	77,087	35,508	200,072
TOTALI		1,494,900	1,330,336	-	164,564

Zëri kryesor "Regjistrimi i mjeteve" rezulton me një mosrealizim prej 134,295 mijë lekë në vlerë, krahasuar me nivelin e parashikuar në programin financiar të vitit 2010. Krahasuar me nivelet e arritura në vitin 2009, kemi një ulje të këtyre të ardhurave prej 12,908 mijë lekë në vlerë. Si shkak i kësaj uljeje, rezulton të jetë ulja e numrit të veprimeve që zenë peshën kryesore të të ardhurave, megjithëse në këtë sektor kemi rritje të numrit total të veprimeve.

Kështu nga 131193 veprime në vitin 2009, rezultojnë 78278 veprime në vitin 2010, pra 52915 veprime më pak, për veprimet që zenë peshën kryesore, si më poshtë:

	Viti 2009	Viti 2010
-Çertifikata e pronësisë së mjetit	85521	60419
-Humbje vjedhje targe mjeti	4916	3283
-Ndërrim lejes qarkullimit vendit (dëmtim)	33628	10.069
-Ndërrim lejes qarkullimi (humbje, vjedhje)	7128	4507

Zëri "Lejet e Drejtimit" rezulton me një morealizim prej 65,777 mijë lekë në vlerë dhe realizim prej 89 % në përqindje, krahasuar me nivelin e parashikuar në programin financiar të vitit 2010. Krahasuar me nivelet e arritura në vitin 2009, kemi një ulje të këtyre të ardhurave prej 33,061 mijë lekësh ose 6%, dhe si shkak rezulton të jetë rënia e numrit të veprimeve me 8% ose 35750 veprime më pak.

Përveç kësaj, niveli i kalueshmërisë në rang republike në testimin teorik është 72,3% % dhe në testimin praktik 78,4 %.

Zëri "Të ardhurat nga taksat" rezulton me një realizim prej 100,4% ose një tejkalim prej 1,253 mijë lekë, krahasuar me nivelin e parashikuar në programin financiar të vitit 2010.

Të ardhurat e realizuara sipas llojit të taksave janë realizuar: taksat e regjistrimit 99,2%, taksat e qarkullimit 100,5%, tarifa e lejes së drejtimit 88,1%. E ardhura nga taksat e përdorimit është



1.623 mijë lekë. Në krahasim me vitin e kaluar kemi rritje të të ardhurave 2% ose 4.894 mijë lekë.

Në zërin e kontrollit në rrugë, të ardhurat rezultojnë me një tejkalim prej 3,918 mijë lekë, mbi parashikimin.

Shpenzimet

Shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2010 janë në shumën prej 1,076,711 mijë lekë, në një kohë që të planifikuara për këtë periudhë, kanë qenë 1,183,672 mijë lekë, duke patur një realizim në përqindje prej 90 %, ose 100,961 mijë lekë më pak se sa parashikimi.

Pra, rezulton me mosrealizim të shpenzimeve në fakt, krahasuar me nivelin e programimit, për këtë vit.

Në përgjithësi të gjithë zërat e shpenzimeve të programuara për periudhën në fjalë kanë rezultuar me mosrealizim, me përjashtim të shpenzimeve të mëposhtme që kanë tejkalime në masën:

- “Blerje energji, ujë”, tejkaluar për 516 mijë lekë
- “Ruajtje objekti, shërbime nga të tretët” tejkaluar për 1,809 mijë lekë
- “Udhëtime, dieta” tejkaluar për 1,791 mijë lekë
- “Shpenzime PTT” tejkaluar për 104 mijë lekë
- “Gjoha, penalitete” tejkaluar për 5,492 mijë lekë

Rezultati financiar

Fitimi bruto i realizuar për vitin 2010 është 253,670 mijë lekë, nga 311,224 mijë lekë i parashikuar në program, pra me një mosrealizim të rezultatit ose një realizim prej 81,24% në krahasim me programin e parashikuar.

Investimet

Realizimi i investimeve për vitin 2010, rezulton për 179,920 mijë lekë nga 320,000 mijë lekë, të programuara, me një realizim prej 56 %, sipas tabelës së mëposhtme:

në 000/ lekë

Nr.	Zërat e Investimeve	Plan	Realizimi	Diferenca në realizim	
				Vlera	Përqindje
1.	Ndërtim-montim	130,250	116,398	-13,852	89 %
2.	Inventar ekonomik	50,000	14,342	-35,658	28 %
3.	Makineri e pajisje	28,000	19,706	-8,294	70 %
4.	Pajisje informatike	111,750	29,374	-82,376	26 %
	Gjithsej	320,000	179,820	-140,180	56 %

Siq shihet nga tabela, investimet për vitin 2010 kanë rezultuar me mosrealizim prej 140,180 mijë lekë ose 56 %. Mosrealizimi është më i theksuar në zërin “Pajisje informatike” me 82,376 mijë lekë.

Për vitin 2011

Në bazë të shkresës nr. 194, datë 13.01.2011 “Mbi miratimin e Programit ekonomik për vitin 2011” të Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit Z. Sokol Ojdashi, është miratuar programi ekonomik për vitin 2011, sipas propozimit të DPSHTRr-së dërguar me shkresë nr. 8863, datë 12.12.2010.

Programi Ekonomik për vitin 2011 me pjesët përbërëse të tij, është miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 34, datë 17.12.2010 “Për miratimin e programit ekonomik të vitit 2011”.

Për vitin 2011, programimi dhe zbatimi i programit ekonomik-financiar, sipas treguesve përkatës, paraqitet si më poshtë:



Programimi

Të ardhurat

Niveli i të ardhurave në total është parashikuar për 1,443,910 mijë lekë, me një rritje rreth 8.96 %. Rritje të të ardhurave janë parashikuar, pothuajse në të gjithë sektorët e aktivitetit të drejtorisë.

Rritja e të ardhurave sipas aktiviteteve, në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit 2010, ka qenë si më poshtë:

-për regjistrimin e mjeteve	15.21 %
-për lejet e drejtimit	6.53 %
-për taksat gjithsej	4.33 %
- të tjera (shtypshkrime të DTSH-së)	-1.37 %
-për kontrollin rrugor	18.63 %

Në sektorin e regjistrimit të mjeteve është parashikuar një rritje e konsiderueshme e të ardhurave për shkak të futjes në qarkullim të modelit të ri të targave.

Në sektorin e lejeve të drejtimit vërejnë që ritmi i rritjes së të ardhurave nga viti në vit ka qenë i ulët dhe për pasojë edhe për vitin 2011 është parashikuar një rritje prej 6.53 %.

Në sektorin e taksave rritja parashikohet të jetë rreth 4.33 %. Këtu bëjnë pjesë të ardhurat nga komisionet e përfituara nga detyra e agjentit tatimor për taksën e regjistrimit të mjeteve, taksën e qarkullimit, taksën e mjeteve të përdorura dhe për tarifën e lejeve të drejtimit. Nga analiza e bërë në këtë sektor, është vërejtur rritje e numrit të mjeteve, por struktura e tyre ka ndryshuar, pasi në qarkullim futen më shumë mjete të përdorimit vetjak (autovehikula) dhe më pak mjete transporti të tjera. Për rrjedhojë edhe të ardhurat nga taksat janë më të ulta.

Në sektorin "të tjera" përfshihen kryesisht të ardhurat nga shypshkrimet e Drejtorisë së Targave dhe Shtypshkrimeve, por që për vitin 2011 janë parashikuar me ulje, për shkak të automatizimit të shërbimeve të DPSHTRr-së.

Edhe për sektorin e kontrollit rrugor janë parashikuar të ardhura me një rritje rreth 18.63 %, pasi ecuria e gjobave ka qenë e mirë.

Shpenzimet

Niveli i shpenzimeve për vitin 2011 parashikohet të jetë 1,279,360 mijë lekë. Janë planifikuar 26 zera shpenzimesh, prej të cilave pesha kryesore e i takon zërit "Pagat e punonjësve" me 548,024 mijë lekë i cili së bashku me zërin "Shpërblime nga taksat" me 109,605 mijë lekë, të dyja me 657,629 mijë lekë, zenë 51.4 % të totalit të shpenzimeve të DPSHTRr-së.

Zëri "Shpërblime nga taksat", është llogaritur për një pagesë shtesë prej 2.4 paga për çdo punonjës, sipas urdhërit të Ministrisë, bazuar në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar.

Zëri "Blerje materiale me vlerë" është parashikuar të jetë 193,600 mijë lekë dhe pas zërit paga, zë vendin e dytë me 15.1 % të totalit të shpenzimeve.

Rezultati financiar

Nisur nga niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve, në programin e vitit 2011, fitimi bruto është parashikuar në vlerën 164,550 mijë lekë dhe fitimi neto 148,095 mijë lekë. Nga kjo rezulton krijimi i një fondi rezervë në masën 7,405 mijë lekë dhe fondi i veçantë 27,401 mijë lekë, ndërsa fondi i zhvillimit arrin vlerën 192,830 mijë lekë.

Programi i treguesve të punës

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2011 është parashikuar të jetë 730 punonjës, i njëjtë me numrin fizik të punonjësve të emëruar në fund të vitit 2010.

Realizimi



Të ardhurat

Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2011 janë në shumën prej 1,470,499 mijë lekë, në një kohë që të planifikuara për këtë periudhë kanë qenë 1,443,910 mijë lekë, duke patur një realizim në përqindje prej 102 %, pra rezultojn me tejkalim të të ardhurave në fakt, krahasuar me nivelin e programimit, për këtë vit.

Duke krahasuar këto nivele me ato të vitit 2010, rezultojn një rritje në vlerë prej 140,163 mijë lekë dhe në përqindje prej 11 %.

Nga 15 njësi vartëse të DPSHTR-së, për periudhën në fjalë paraqiten me tejkalim të të ardhurave 11 njësi të vartësisë dhe me mosrealizim të të ardhurave 4 njësi dhe konkretisht Drejtoritë Rajonale Gjirokastrë, Tiranë, Vlorë dhe Sarandë.

Struktura e të ardhurave të realizuara në përqindje, sipas natyrës së aktiviteteve të kryera në sistemin e DPSHTR-së, janë si më poshtë:

-Regjistrimi i mjeteve 38 %.

-Lejet e drejtimit 34,85%

-Taksat 20,5 %

-Kontrolli rrugor 0,74 %

-Të tjera 5,57 %

Realizimi i të ardhurave sipas zërave, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Realizimi për vitin 2011				Në mijë lekë	
Nr.	Zërat e të ardhurave	Programi	Realizimi	Diferenca	
				Tejkalim	Mosrealizim
1.	Regjistrimi i mjeteve	527,500	563,820	36,320	30,464
2.	Lejet e drejtimit	542,900	512,436	-	5,957
3.	Taksat	307,411	301,454	-	12,630
4.	Kontrolli rrugor	23,500	10,870	-	-
5.	Të tjera	42,599	81,919	39,319	49,051
TOTALI		1,443,910	1,470,499	26,589	-

Zëri kryesor "Regjistrimi i mjeteve" rezultojn me një tejkalim prej 36,320 mijë lekë me një realizim 107 %, krahasuar me nivelin e parashikuar në programin financiar të vitit 2011.

Krahasuar me nivelet e arritura në vitin 2010 kemi një rritje të këtyre të ardhurave prej 150,315 mijë lekë ose 36 %. Si shkak i kësaj rritjeje rezultojn të jetë rritja e numrit të veprimeve nga 245 mijë në vitin 2010 në 310 mijë në vitin 2011, pra 65 mijë veprime më shumë ose 26 %.

Zëri "Lejet e Drejtimit" rezultojn me një mosrealizim prej 30,464 mijë lekë ose një realizim prej 94%, krahasuar me nivelin e parashikuar në programin financiar të vitit 2011.

Krahasuar me nivelet e arritura në vitin 2010, kemi një ulje të këtyre të ardhurave prej 1,087 mijë lekësh dhe si shkak rezultojn të jetë rënia e numrit të veprimeve në disa zëra kryesorë dhe konkretisht në nënzhërin "Paisje me leje drejtimi për të gjitha kategoritë" rezultojn një ulje prej 2700 veprimesh, "Paisje me autorizim" rezultojn me ulje prej 700 veprimesh dhe "Provimi i njohurive praktike" (C,D,C+E) rezultojn me ulje prej 500 veprime. Përveç kësaj, niveli i kalueshmërisë në rang republike në testimin teorik është 73,3 % dhe në testimin praktik 80 %.

Zëri "Të ardhurat nga taksat" rezultojn me një mosrealizim prej 5,957 mijë lekë dhe një realizim 98 % në përqindje, krahasuar me nivelin e parashikuar në programin financiar të vitit 2011. Të ardhurat e realizuara sipas llojit të taksave janë si më poshtë:



- Taksa e regjistrimit në vlerën 22,474 mijë lekë
 - Taksa e qarkullimit në vlerën 147,674 mijë lekë
 - Taksa e lejës së drejtimit në vlerën 9,952 mijë lekë
 - Taksa vjetore e mjeteve të përdorura në vlerën 121,356 mijë lekë
- Vihet re një vlerë e lartë e taksës së mjeteve të përdorura, e cila ka ardhur në rritje si rezultat i aplikimit të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 "Për disa ndryshime në ligjin për sistemin e taksave..." dhe UMF nr. 18, datë 23.08.2011 "Për disa shtesa e ndryshime në UKM për taksat kombëtare".
- Në zërin e Kontrollit në rrugë, të ardhurat rezultojnë me një tejkalim prej 39,319 mijë lekë, mbi parashikimin.

Shpenzimet

Shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2011 janë në shumën prej 1,205,704 mijë lekë, në një kohë që të planifikuara për këtë periudhë kanë qenë 1,279,360 mijë lekë, duke patur një realizim në përqindje prej 94 %, ose rreth 73,656 mijë lekë më pak se sa parashikimi.

Pra, rezultoni me mosrealizim të shpenzimeve në fakt, krahasuar me nivelin e programimit, për këtë vit.

Në përgjithësi të gjithë zërat e shpenzimeve të programuara për periudhën në fjalë kanë rezultuar me mosrealizim, me përjashtim të shpenzimeve të mëposhtme që kanë tejkalime në masën:

"Blerje materiale", tejkaluar për 24,672 mijë lekë
 "Blerje energji, ujë", tejkaluar për 528 mijë lekë

"Blerje mallra me vlerë", tejkaluar për 24,924 mijë lekë
 "Shpenzime amortizimi", tejkaluar për 7,717 mijë lekë
 Llogaria "Gjoha, penalitete" është realizuar 5,492 mijë lekë

Rezultati financiar

Fitimi bruto i realizuar për vitin 2011 është 264,806 mijë lekë nga 164,550 mijë lekë i parashikuar në program, pra me një tejkalim të rezultatit ose një realizim prej 161% në krahasim me programin e parashikuar.

b. Mbi zbatimin e programit të fondeve me destinacion shpenzime për investimet në Drejtorinë e Përgjithshme dhe njësitë varëse.

Për vitin 2010

Programimi

Bazuar në mundësitë e pritshme për realizimin e një rezultati ekonomik bruto për vitin 2009 prej 418,261 mijë lekë dhe një fitim neto prej 376,435 mijë lekë, Fondi i Zhvillimit i pritshëm për të gjithë Drejtorinë e Përgjithshme që do të krijohet në mbyllje të rezultatit të vitit 2009 dhe që do të përdoret për vitin 2010, është rreth 334,412 mijë lekë.

Për vitin 2010 parashikohen të kryhen investime me vlerën 320,000 mijë lekë.

Investimet e parashikuara për t'u përdorur gjatë vitit 2010 kanë strukturën e mëposhtme sipas natyrës:

-Ndërtim-montim 130,250 mijë lekë
 -Inventar ekonomik 50,000 mijë lekë
 -Makinieri e pajisje 28,000 mijë lekë
 -Pajisje informatike 111,750 mijë lekë
 Gjithsej 320,000 mijë lekë



Në nivel projekti parashikohen investime në 14 objekte në zërim Ndërtim-montim, ku mund të përmendim ndërtim Godinë administrative për zyrat rajonale Shkodër, Berat, Gjirokastrë, gjithsej në vlerën 81,000 mijë lekë, si dhe sisteme kontrolli dhe rikonstruksione të ndryshme në disa zyra rajonale.

Realizimi

Realizimi i investimeve për vitin 2010, rezulton për 179,920 mijë lekë nga 320,000 mijë lekë, të programuara, me një realizim prej 56 %, sipas tabelës së mëposhtme:

në 000/ lekë

Nr.	Zërat e Investimeve	Plani	Realizimi	Diferenca në realizim	
				Vlere	Përqindje
1.	Ndërtim-montim	130,250	116,398	-13,852	89 %
2.	Inventar ekonomik	50,000	14,342	-35,658	28 %
3.	Makineri e pajisje	28,000	19,706	-8,294	70 %
4.	Pajisje informatike	111,750	29,374	-82,376	26 %
	Gjithsej	320,000	179,820	-140,180	56 %

Siç shihet nga tabela, investimet për vitin 2010 kanë rezultuar me mosrealizim prej 140,180 mijë lekë ose 56 %. Mosrealizimi është më i theksuar në zërin "Pajisje informatike" me 82,376 mijë lekë.

Për vitin 2011

Programimi

Bazuar në mundësitë e pritshme për realizimin e një rezultati ekonomik bruto për vitin 2010 prej 252,949 mijë lekë dhe një fitim neto prej 227,654 mijë lekë, Fondi i Zhvillimit i pritshëm për të gjithë Drejtorinë e Përgjithshme që do të krijohet në mbyllje të rezultatis të vitit 2010 dhe që do të përdoret për vitin 2011, është rreth 192,830 mijë lekë.

Për vitin 2011 parashikohen të kryhen investime me vlerën 302,000 mijë lekë, ku përveç fondit të zhvillimit, do të përdoret edhe fondet e mbetur nga viti 2010, si rezultat i mosrealizimit të disa investimeve me vlera të mëdha si: godinë administrative për DR Berat, Shkodër, etj. dhe kursimit të fondeve gjatë tenderimit. Pra, pritet të përdoren rreth 109,170 mijë lekë fonde të papërdorura dhe të trashëguara.

Investimet e parashikuara për t'u përdorur gjatë vitit 2011, kanë strukturën e mëposhtme sipas natyrës:

-Ndërtime	193,100 mijë lekë
-Informatikë	12,100 mijë lekë
-Inventar ekonomik	50,500 mijë lekë
-Makineri e pajisje	49,018 mijë lekë
Gjithsej	304,718 mijë lekë

Në nivel projekti parashikohet investime në 24 objekte, prej të cilave 14 investime ndërtimore, 4 informatike, 2 inventar ekonomik dhe 4 makineri e pajisje, etj.

Nga sa më sipër, janë parashikuar investime me vlerë të madhe:

Investime ndërtimore: "Godinë administrative, kabanon për kontrollin fizik dhe tahografin" në: DR Laç prej 35,000 mijë lekë, DR Tiranë prej 60,000 lekë, DR Berat prej 40,000120 mijë lekë, ku vetëm këtu parashikohet një investim i përgjithshëm prej 135,000 lekë ose rreth 45 % të totalit të investimeve.

Realizimi



Realizimi i investimeve për vitin 2011, rezulton për 155,320 mijë lekë nga 304,718 mijë lekë, të programuara, me një realizim prej 50%.

III. Zbatimi i dispozitave ligjore që rregullojnë pagat dhe shpërblimet.

Nga auditimi u konstatua se:

a. Respektimi i strukturave organike të miratuara për tremujorin e II të vitit 2010, tremujorin e III dhe IV të vitit 2011.

Sipas shkresave të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit z. Sokol Ollashi, janë miratuar programet ekonomike të DPSHTRR-së për vitet 2010 dhe 2011 në bazë të vendimeve të Këshillit Drejtues, ku përfshihen edhe treguesit e punës.

Administrimi i marrëdhënieve të punës në DPSHTRR rregullohet bazuar në Kodin e Punës.

Për realizimin e këtij treguesi, paraqesim tabelën:

Emërtimi	Viti 2010			Viti 2011		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Punonjës gjithsej	660	688	104	730	733	100

Në programin e treguesve të punës për vitin 2010, numri mesatar i punonjësve për vitin 2010 është parashikuar të jetë 660 nga 648 punonjës të emëruar në fund të vitit 2009 dhe nga 757 të planifikuar në vitin 2009. Krahasuar me programin e vitit 2009, numri i fuqisë punëtore ka ulje si rezultat i dhënies me koncesion të aktivitetit të Kontrollit Teknik, ndërsa krahasuar me gjendjen në fund të vitit ka një rritje të numrit të punonjësve me 12 punonjës, për shkak të marrjes së aktivitetit të ri të tahogرافit.

Numri mesatar faktik i punonjësve gjatë vitit 2010 ka rezultuar 689 punonjës, pra me një tejkalim me 29 punonjës krahasuar me planifikimin ose 4 % më shumë se programi.

Në programin e treguesve të punës për vitin 2011, numri mesatar i punonjësve për këtë vit parashikohet të jetë 730, me një rritje prej 70 punonjësish krahasuar me numrin mesatar të punonjësve për vitin 2010. Realizimi është 733 punonjës, ose 3 punonjës më shumë se planifikimi.

Në DPSHTRR Aparati në bazë të shkresës së MPPT nr. 2153/1, datë 27.04.2010, është miratuar struktura për Aparatin për vitin 2010, me gjithsej 84 punonjës. Nga kontrolli për tremujorin e II të vitit 2010 rezultoi se për këtë periudhë numri mesatar i punonjësve ka qenë 78 punonjës nga 84 të planifikuar, dha pa tejkalime në strukturat e miratuara me shkresën e mësipërme.

Në bazë të shkresës së MPPT nr. 6416/2, datë 30.11.2010, është miratuar struktura për Aparatin për vitin 2011, me gjithsej 90 punonjës. Nga kontrolli i koheshënuesit dhe listë pagesave për tremujorin e III dhe IV të vitit 2011, rezultoi se për këtë periudhë numri mesatar i punonjësve ka qenë 88 persona nga 90 të planifikuar dha pa tejkalime në strukturat e miratuara me shkresën e mësipërme.

b. Realizimi i fondit të pagave dhe respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Në të gjitha shkresat e Ministrit të MPPT me anë të të cilave miratohen programet ekonomike vjetore, jepen porosi të veçanta për faktin që shpërblimi më i pagë për vështirësi në punë të



bëhet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Konkretisht porositet që shpërblimi në punë të bëhet sipas nenit 2.3 "për personat që janë përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e Buxhetit të Shtetit, të të ardhurave nga taksat kombëtare", të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare"(jo ato vendore).

Për vitet 2010 dhe 2011, në DPSHTRR, pagat e punonjësve janë vendosur në bazë të vendimeve të Këshillit Drejtues në zbatim të nenit 9/c, të Statutit.

Në vitin 2011 është parashikuar fondi i pagave gjithsej prej 548,024 mijë lekë gjithsej dhe një pagë mesatare mujore prej 62,560 lekë. Fondi i pagave ka pësuar një rritje prej 16,89 % nga realizimi i pritshëm për vitin 2010, për shkak të shtimit të numrit të punonjësve si dhe është parashikuar një rritje prej 10% të pagave, meqenëse gjatë vitit 2010 nuk u bë asnjë ndryshim.

Në tabelën e mëposhtme po paraqesim realizimin e fondit të pagave dhe pagës mesatare vjetore për vitet 2010, 2011:

Emërtimi	Viti 2010			Viti 2011		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Fondi i pagave	437,684	468,883	96	548,024	499,556	91
Paga mes.muj.	61,576	56,790	92	62,560	56,790	90

Realizimi i fondit të pagave për vitin 2010 është 96 % dhe për vitin 2011 fondi i pagave është realizuar 91 %.

Nga kontrolli rezultoi se listëpagesat janë plotësuar me të gjithë elementët përbërës të pagave. Për pagat e punonjësve mbahej kartelë për çdo punonjës.

Gjatë kontrollit për respektimin e vendimeve të Këshillit Drejtues, nuk rezultuan probleme. Kështu ishin zbatuar këto vendime në lidhje me pagat.

Ishin zbatuar urdhrat e Ministrit PPT lidhur me shpërblimin mbi pagë për vështirësi në punë. Kështu ky shpërblim ishte bërë sipas nenit pikës 2.3, të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare". Rezulton se ky shpërblim ishte ulur nën shumën e përcaktuar me këtë dispozitë.

Nga kontrolli për respektimin e dispozitave ligjore për sigurimet shoqërore, sigurimet suplementare dhe tatimin mbi të ardhurat personale, rezultoi se llogaritjet ishin kryer në mënyrë të saktë.

c. Respektimi i dispozitave ligjore për dhënie të shpërblimeve nga të ardhurat.

Në DPSHTRR Aparati shpërblimet e punonjësve jepen sipas urdhrat të Ministrit nr. 80, datë 29.05.2008, pikal0/c, sipas së cilës krijohet rezerva e veçantë deri në 5 % të fondit të pagave vjetore. Mënyra dhe qëllimi i përdorimit të këtij fondi kryhet me analogji si në rastet e përmendura në udhëzimin nr. 21, datë 18.09.2007 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 369, datë 13.06.2007, "Për fondin e vecantë në institucionet buxhetore". Shpërblimet janë dhënë në bazë të vendimeve të Këshillit Drejtues.

IV. Mbi administrimin e pronës shtetërore; Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në Aparatin e DPSHTRR, u konstatua se:



a. Ligjshmëria dhe saktësia e pagesave të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë dhe në valutë, për periudhën objekt kontrolli.

Nga auditimi u konstatua se:

I. Arka në lekë

Nga kontrolli rezultoi se Sektori i Financës kishte zbatuar aktet ligjore e nënligjore dhe veprimet e kryera ishin justifikuar me evidencë mbështetëse në formë dokumentare, sipas nenit 6, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Kështu mandatarkëtimet dhe mandatpagesat ishin plotësuar më rregull, sipas formularëve përkatës dhe të nënshkruar nga personat e ngarkuar për këtë qëllim.

Për blerjet e vogla ishin zbatuar dispozitat ligjore për këtë qëllim, si udhëzimi i KM nr. 1, datë 20.03.2007 "Për blerjet me vlera të vogla". Kështu praktikat ishin kompletuar me urdhrin e prokurimit, procesverbalet, raportin përfundimtar, ofertat bashkëlidhur marrë nga 3 subjekte të ndryshme, faturat e shitësit.

Veprimet e kryera janë kontabilizuar në ditarin përkatës, sipas radhës kronologjike, ditar i cili është nënshkruar edhe nga specialistja e financës. Kontabilizimi i veprimeve është kryer në përputhje me ligjin 9228, datë 29.04.2004 dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

Nuk u konstatuan raste të shkeljes së disiplinës financiare me apo pa dëm ekonomik.

II. Arka në valutë

Nga auditimi rezultoi se ky institucion ka shpenzuar fonde valutore në Euro për kryerjen e shërbimeve jashtë shtetit, në kuadrin e zhvillimit të takimeve zyrtare me institucionet homologe në shtetet e huaja, si dhe për arësye të tjera.

Kryerja e veprimeve nëpërmjet arkës në valutë për periudhën objekt kontrolli, në përgjithësi, është bërë duke zbatuar dispozitat ligjore, për shpenzime udhëtim e dieta jashtë shtetit, si VKM

nr. 304, datë 08.05.2003 « Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve buxhetore, kur dalin jashtë shtetit ». Kështu, dokumentacioni mandatarkëtime dhe mandatpagesa ishte plotësuar në rregull, sipas ligjit. Mandatarkëtimet kishin bashkëlidhur çeqet e bankave për tërheqjet në valutë, dokumentacionin tjetër dhe përshkrimin e saktë të veprimeve që kryheshin.

Mandatpagesat ishin plotësuar më rregull, sipas formularëve përkatës dhe të nënshkruar nga personat e ngarkuar për këtë qëllim, Përgjegjësi i Sektorit të Financës, Specialistja, arkëtarja dhe marrësi në dorëzim i të hollave në valutë.

Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit beheshin në bazë të urdhrin me shkrim të titullarit të institucionit, të preventivit të shpenzimeve që do të kryhen për çdo udhëtim dhe ishin justifikuar me urdhërshërbimet të nënshkrura rregullisht si dhe dokumentacionin tjetër justifikues, si bileta udhëtimi, fletë hoteli, fatura taksie, karburanti, fotokopje pasaporte, etj.

III. Banka në lekë

Nga kontrolli rezultoi se ishin zbatuar aktet ligjore e nënligjore dhe pagesat me urdhërshërbime ishin të shoqëruara me dokumenta justifikues, sipas nenit 6, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004. Blerjet e mallrave, materialeve dhe kryerja e shërbimeve, në përgjithësi janë kryer konform udhëzimeve të KM nr. 1, datë 20.03.2007 dhe urdhrave të brendshëm si dhe vendimeve të Këshillit Drejtues.

Kështu, urdhërshërbimet ishin plotësuar në rregull sipas formularëve të miratuar për këtë qëllim nga bankat në fjalë dhe ishin të nënshkruara nga personat përkatës të ngarkuar për këtë qëllim, me dokumentacionin justifikues bashkëlidhur, si fatura, urdhërprokurimi, procesverbali, raporti përfundimtar, kopje e fletëhyrjes, etj.



Nga auditimi për kontabilizimin e veprimeve në ditar, rezultoi se në përgjithësi, të gjithë urdhërxhirimet ishin pasqyruar drejt nëpër llogaritë sintetike e analitike, sipas natyrës së shpenzimit, në përputhje me ligjin 9228, datë 29.04.2004 dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën 01.10.2009- 31.12.2011, nga ana e DPSHTRR-së janë kryer pagesa në zbatim të vendimeve të gjykatave, në 20 raste, për shumën e përgjithshme prej 15,543,075 lekë, duke shpërblyer punonjësit e larguar nga puna në bazë të vendimeve të titullarëve të gjykuara të padrejta nga gjykatat e rretheve gjyqësore dhe ato të apelit. Këto pagesa kanë rënduar shpenzimet e ndërmarrjes për 15,543,075 lekë. Thëksojmë se DPSHTRR i ka ndjekur çështjet në të gjitha shkallët e gjyqësorit, ku përveç gjykatave të apelit, DPSHTRR ka bërë rekurse në Gjykatën e Lartë pothuajse për të gjitha rastet duke bërë edhe kërkesë për pezullim ekzekutimi të vendimeve të përmbarimit gjyqësor. Nga ana e Gjykatës së Lartë nuk është marrë asnjë vendim për këto rekurse të DPSHTRR-së.

Nga sa më sipër, në 15 raste për shumën prej 10,679,066 lekë nuk mund të përcaktohet nëse në vend të të larguarit nga puna të jetë cakuar person tjetër, si më poshtë:

1. Më datë 17.11.2009, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 619,151 lekë, në favor të përfituesit znj. Miranda Xhuti. Kjo pagesë është kryer në bazë të lajmërimit për ekzekutim vullnetar nr. 11462, datë 19.08.2009, të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të lëshuar me vendimin nr. 8951, datë 11.12.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për detyrimin e DPSHTRR-së të shpërblejë dëmin duke paguar pagën e 10 muajve pune për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustifikuar të kontratës së saj të punës, pagën e 2 muajve për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, 2 muaj pagë për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit dhe 1 muaj e gjysëm page për shpërblimin vjetërsi pune.

Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë nr. 3871, datë 03.06.2009 dhe kërkesa për pezullim ekzekutimi nr. 5784/1, datë 01.09.2009.

2. Më datë 10.12.2009 dhe 22.12.2009, DPSHTRR ka kryer 2 pagesa në shumën totale prej 599,497 lekë, në favor të përfituesit znj. Arjana Sholla. Këto pagesa janë kryer në bazë të lajmërimit për ekzekutim vullnetar nr. 15836, datë 20.10.2009 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të lëshuar në vendimin nr. 955, datë 20.09.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për detyrimin e DPSHTRR-së të shpërblejë dëmin duke paguar 16.5 muaj pune për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustifikuar të kontratës së saj të punës, pagimin e taksës përmbarimore 39,360 lekë, si dhe shpenzimet gjyqësore në shumën prej 30,900 lekë. Gjithsej detyrimi 599,497 lekë.

Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 2571, datë 26.08.2009 dhe është bërë Kërkesë për Pezullim ekzekutimi nr. 3588, datë 16.11.2009 dhe nga Gjykata e Lartë Nr.B-87, datë 16.11.2009.

3. Më datë 15.12.2009, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 323,568 lekë në favor të përfituesit z. Mark Lleshi. Kjo pagesë është kryer në bazë të lajmërimit për ekzekutim vullnetar nr. 16073, datë 26.10.2009 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të lëshuar në vendimin nr. 589, datë 18.12.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, për detyrimin e DPSHTRR-së të shpërblejë dëmin duke paguar pagën për periudhën 6 mujore nga data 25.04.2009 deri më 25.12.2009 me pagën aktuale prej 50.400 lekë, në shumën 302,400 lekë, si dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna, plus taksën përmbarimore në masën 7 % në shumën 21,168 lekë, në total shuma 323,568.

Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 588, datë 04.03.2008.



4. Më datë 22.12.2009, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 658,389 lekë në favor të përfituesit z. Lorent Fezga. Kjo pagesë është kryer në bazë shkresës nr. 16069, datë 20.10.2009 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të lëshuar në vendimin nr. 1452, datë 26.05.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për detyrimin e DPSHTRR-së të shpërblejë dëmin duke paguar pagën për periudhën prej 1 viti si dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna, plus pagën e 1,5 muajve punë shpërblim vjetërsie dhe tarifën përmbarimore.
- Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 1153, datë 12.03.2007 dhe është bërë Kërkesë për Pezullim ekzekutimi nr. 7483/1, datë 03.11.2009.
5. Më datë 08.01.2010, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 558,365 lekë, në favor të përfituesit z. Agim Çela. Kjo pagesë është kryer në bazë të lajmërimit për ekzekutim vullnetar nr. 19099, datë 14.12.1999 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" nr. 4563 Akti, datë 19.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për detyrimin e DPSHTRR-së të shpërblejë dëmin duke paguar pagën për një periudhë 6 muajore si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajusifikuar të kontratës, pagën e 5 muajve pune si rezultat i moszbatimit të afatit të njoftimit, në bazë të neneve 143-144 të Kodit të Punës, 1,5 paga për vjetërsinë në punë, pagën për lejen e zakonshme për vitin 2006, shpenzimet gjyqësore dhe taksat, gjithsej 558,365 lekë.
- Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 7716, datë 06.11.2009 dhe është bërë Kërkesë për Pezullim ekzekutimi nr. 8800, datë 24.12.2009.
6. Më datë 21.06.2010, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 1,840,830 lekë në favor të përfituesit z. Gjon Nezha. Kjo pagesë është kryer në bazë shkresës nr. 14160, datë 01.10.2010 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të lëshuar në vendimin nr. 948/824, datë 31.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për detyrimin e DPSHTRR-së të shpërblejë dëmin duke paguar pagën për periudhën nga data 07.04.2006-01.11.2007 si dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna.
- Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 134, datë 20.01.2010 dhe është bërë Kërkesë për Pezullim ekzekutimi datë 24.05.2010.
7. Më datë 21.06.2010, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 308,448 lekë, në favor të përfituesit z. Mark Lleshi. Kjo pagesë është kryer në bazë të Urdhërit për Vënien e Sekuestros Ekzekutive të Zyrës Përmbarimore Kurbin, nr. 440, datë 02.02.2010, në zbatim të "Urdhërit të Ekzekutimit" Nr. 58-42 datë 13.01.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin, ku kjo Gjykatë ka vendosur: "detyrimin e DPSHTRR-së të shpërblejë dëmin duke paguar pagën për periudhën e qëndrimit padrejtësisht pa punë si dhe lejen e zakonshme të pamarre prej tij".
- Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 588, datë 04.03.2008 dhe çështja është në proces.
8. Më datë 06.09.2010, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 505,804 lekë, në favor të përfituesit z. Shkëlqim Kejku. Kjo pagesë është kryer në bazë të Urdhërit për Vendosje Sekuestro Ekzekutive nr. 12458, datë 17.08.2010 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të lëshuar në vendimin nr. 865, datë 19.03.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, për detyrimin e DPSHTRR-së të shpërblejë dëmin duke paguar pagën për periudhën prej 8 muajve si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajusifikuar të kontratës, pagën e 2 muajve punë për mosrespektim të afateve të njoftimit, si dhe shpenzimet gjyqësore dhe taksën, në shumën e përgjithshme prej 505,804 lekë.
- Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 1115, datë 18.02.2010 dhe është bërë Kërkesë për Pezullim ekzekutimi nr. 4202, datë 21.06.2010.
9. Më datë 02.11.2010, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 657,809 lekë, në favor të përfitueses znj. Sadije Agojli. Kjo pagesë është kryer në bazë të lajmërimit për



ekzekutim vullnetar Nr. 762/Sh dhe nr. 11203 prot, të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të lëshuar në vendimin nr. 3979, datë 13.05.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, sipas të cilit është vendosur detyrimi i

DPSHTRR-së t'i paguaje znj. Sadije Agolli pagën e 14 muajve punë, si dhe taksën përmbarimore në masën 2 % të shumës.

Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 2349, datë 15.04.2010 dhe është bërë Kërkesë për pezullim ekzekutimi Nr. 6379/1, datë 22.09.2010.

10. Sipas Njoftim Debitimit datë 10.05.2010 lëshuar nga Raiffeisen Bank dhe shkresës nr. 1091, datë 17.05.2010 të Drejtorisë Rajonale Gjirokastrë, rezulton se është paguar z. Maliq Muçi me 779,987 lekë, në bazë të Urdhrit për Vënien e Sekuestros Konservative me nr. 57, datë 05.0-3.2010, në zbatim të Urdhrit të Ekzekutimit nr. 151, datë 10.09.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë, si dëmshpërblim për ndërprerje të pajustifikuar të kontratës së punës.

Vendimi nuk është ankimuar në Gjykatën e Apelit dhe as në Gjykatën e Lartë.

11. Sipas fletës së kontabilizimit rezulton të jetë paguar nga Drejtoria Rajonale Kurbin z. Dilaver Lika, me 970,663 lekë, në bazë të Urdhërit për Vënien e Sekuestros Konservative nr. 392, datë 01.02.2010 të Zyrës Përmbarimore Kurbin, në zbatim të "Urdhërit të Ekzekutimit" nr. 58-42 datë 13.01.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin Tiranë i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Kurbin, si dëmshpërblim për ndërprerje të pajustifikuar të kontratës së punës.

Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 2319, datë 26.11.2009 dhe çështja është në proces.

12. Më datë 18.03.2011, DPSUTRR ka kryer pagesën në shumën prej 574,616 lekë në favor të përfituesit z. Bashkim Myrtezai. Kjo pagesë është kryer në bazë të urdhërit për vendosje sekuestro konservative nr. 009-11, datë 28.02.2011 të Përmbaruesit Gjyqësor Privat Andrea Katundi Korçë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të vendimit gjyqësor nr. 41-2010-354 (2206) datë 20.01.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, sipas të cilit është vendosur detyrimi i DPSHTRR-së t'i paguaje z. Bashkim Myrtezai 6 muaj pagë si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustifikuar të kontratës së tij të punës, pagën e 2 muajve punë si dëmshpërblim për mosrespektimin e procedurave për njoftimin dhe komunikimin gjatë zgjidhjes së kontratës, si dhe 1.5 paga mujore shpërblim për vjetërsi në punë.

Nuk ka informacion nga Drejtoria Rajonale Korçë për ankimim në Gjykatën e Apelit dhe Rekurs në Gjykatën e Lartë, për arësye se juristi që ndiqte çështjet është pushuar edhe ky nga puna.

13. Më datë 24.03.2011, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 913,472 lekë, në favor të përfitueses znj. Eli Vyshka. Kjo pagesë është kryer në bazë të lajmërimit për ekzekutim vullnetar nr. 18500, datë 29.12.2010 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të lëshuar për vendimin nr. 8850, datë 27.02.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (i ndryshuar me vendimin nr. 891, datë 30.10.2009), sipas të cilit është vendosur detyrimi i DPSHTRR-së t'i paguaje znj. Eli Vyshka pagën e 1 viti punë si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustifikuar të kontratës së saj të punës, pagën e 2 muajve punë si dëmshpërblim për mosrespektimin e procedurave për njoftimin dhe komunikimin gjatë zgjidhjes së kontratës, si dhe pagën e 2 muajve si dëmshpërblim për mosrespektimin në afateve të njoftimit, si dhe shpenzimet gjyqësore dhe taksën përmbarimore.

Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 8187, datë 26.11.2010 dhe është bërë Kërkesë për pezullim ekzekutimi nr. 1016, datë 03.02.2011.

14. Më datë 04.05.2011, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 182,094 lekë, në favor të përfituesit z. Pirro Kaçori. Kjo pagesë është kryer në bazë të Urdhërit Vendosje Sekuestro Ekzekutive nr. 294-51, datë 29.04.2011 të Përmbaruesit Gjyqësor Privat Julian Prifti, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" nr. 41-2010-4314(672), datë 17.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, sipas të cilit është vendosur detyrimi i DPSHTRR-së t'i paguaje z. Pirro



Kaçori si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së tij të punës. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nr. 1959, datë 26.07.2010 është apeluar nga ana e DPSHTRR-së dhe Gjykata e Apelit Korçë, me vendim nr. 397, datë 30.09.2010, ka vendosur mospranimin a ankimit duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Nuk është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë dhe për këtë arsye është marrë masa "Largim nga puna" për ish-juristin z. Detion Shehu.

15. Më datë 19.01.2012, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 1,186,373 lekë, në favor të përfituesit z. Vilma Çekani. Kjo pagesë është kryer në bazë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 2134, datë 20.10.2011, për lënien në fuqi të vendimit nr. 2710, datë 07.04.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për detyrimin e DPSHTRR-së, të shpërblejë dëmin duke paguar pagën e 2 muajve pune për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit, 6 pesëmbëdhjetë ditësha për shpërblimin vjetërsi pune dhe pagën e 12 muajve për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së saj të punës.

Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë nr. 8720, datë 17.11.2011 dhe kërkesë për pezullim ekzekutimi nr. 10032/1, datë 19.12.2011.

-Në 5 raste për shumën e përgjithshme prej 4,864,009 lekë vërtetohet se janë paguar 2 persona në të njëjtin vend pune, si më poshtë:

1. Më datë 01.10.2010, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 1,003,200 lekë, në favor të përfituesit z. Drini Kryemadhi. Kjo pagesë është kryer në bazë të shkresës së MPPT nr. 4936/1, datë 15.09.2010 dhe Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 600 dhe numër akti 2181/903, për lënien në fuqi të vendimit nr. 4841, datë 20.07.2005 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt detyrimin e të paditurit (Kryeministri i Republikës së Shqipërisë dhe MPPT) për shpërblimin e dëmit duke paguar pagën e 10 muajve pune si dhe të shpërblejë atë dhe me dy muaj paga të tjera të afatit të njoftimit të parëspektuar, rrjedhur nga lirimi nga detyra pa shkaqe të arësyeshme.

Z. Drini Kryemadhi ka qenë i emëruar me detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR dhe është liruar nga puna me urdhërin e Kryeministrit të Republikës nr. 258, datë 27.09.2002.

Nga të dhënat e nxjerra prej Sektorit të Burimeve Njerëzore rezultoi se është emëruar në këtë detyrë z. Shpëtim Cami me urdhërin nr. 258, datë 27.09.2002.

Më pas çështja është ndjekur nga MPPT.

2. Më datë 12.10.2010, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 1,244,520 lekë, në favor të përfituesit z. Shpëtim Zhuka. Kjo pagesë është kryer në bazë të lajmërimit për ekzekutim vullnetar nr. 12840, datë 31.08.2010 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të lëshuar në vendimin nr. 2245, datë 14.07.2010 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për pagesën e 12 pagave mujore si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së tij të punës dhe 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës për largimin nga puna.

Z. Shpëtim Zhuka ka qenë i emëruar me detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Targave dhe Shtypshkrimeve në DPSHTRR dhe është liruar nga puna me urdhërin e z. Kreshnik Bozho nr. 477, datë 26.01.2009.

Nga të dhënat e nxjerra prej Sektorit të Burimeve Njerëzore rezultoi se është emëruar në këtë detyrë z. Asllan Gjeta, me urdhërin e lëshuar nga Z. Kreshnik Bozho nr.41, datë 26.01.2009 dhe marrëdhëniet financiare i kanë filluar më datë 26.01.2009.

Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 4449, datë 30.06.2010 dhe është bërë Kërkesë për Pezullim ekzekutimi nr. 6045/3, datë 17.09.2010.

3. Më datë 14.01.2011, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 1,202,336 lekë, në favor të përfituesit z. Petro Doni. Kjo pagesë është kryer në bazë të lajmërimit për ekzekutim



MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, DREJTORIA E PLANIMIT DHE
TË TREGIMEVE TË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

vullnetar nr. 12138, datë 02.08.2010 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të lëshuar me vendimin nr. 9491 datë 06.11.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit), sipas të cilit është vendosur detyrimi i DPSHTRR-së t'i paguaje z. Petro Done pagën e 1 viti punë si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së tij të punës, pagën e 2 muajve punë si dëmshpërblim për mosrespektimin e procedurave për njoftimin dhe komunikimin gjatë zgjidhjes së kontratës, si dhe pagën e 1 muaji si dëmshpërblim për mosrespektimin e afateve të njoftimit. Z. Petro Done ka qenë e emëruar me detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Teknik dhe Rregjistrimit në DPSHTRR dhe është liruar nga puna me urdhërin e ish-Drejtorit të Përgjithshëm z. Shensi Aga nr. 3, datë 05.01.2006.

Nga të dhënat e nxjerra prej Sektorit të Burimeve Njerëzore rezulton se është emëruar në këtë detyrë z. Sadi Dokja, me urdhërin e lëshuar nga Ministri i MPPTT Z. Lulzim Basha nr. 2344/I, datë 21.03.2006 dhe marrëdhëniet financiare i kanë filluar më datë 17.03.2006.

Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr. 1599, datë 11.03.2010 dhe nga kjo Gjykatë është bërë Kërkesë për Pezullim ekzekutimi nr. 6388, datë 17.09.2010.

4. Më datë 24.02.2011, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 627,125 lekë, në favor të përfituesit z. Aurel Agolli. Kjo pagesë është kryer në bazë të urdhërit për vendosje sekuestro ekzekutive nr. 004-11, datë 15.02.2011 të Përmbaruesit Gjyqësor Privat Andrea Katundi Korçë, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" të lëshuar me vendimin nr. 41-2010-4823 (762 prot.) datë 24.12.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, sipas të cilit është vendosur detyrimi i DPSHTRR-së t'i paguaje z. Aurel Agolli shumën prej 627,125 lekë. Z. Aurel Agolli ka qenë e emëruar me detyrën e Kryetarit të Degës së Lejeve të Drejtimit në Drejtorinë Rajonale Korçë dhe është liruar nga puna me urdhërin e z. Kreshnik Bozho nr. 12, datë 01.02.2010.

Nga të dhënat e nxjerra prej Sektorit të Burimeve Njerëzore rezulton se është transferuar në këtë detyrë z. Nikolin Gambeta, me urdhërin e lëshuar nga Z. Kreshnik Bozho nr. 74, datë 09.02.2010 dhe marrëdhëniet financiare i kanë filluar më datë 12.02.2010. Nuk është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, dhe për këtë arsye është marrë masa "Largim nga puna", për ish-Juristin z. Detlon Shehu.

5. Më datë 29.04.2011, DPSHTRR ka kryer pagesën në shumën prej 786,828 lekë, në favor të përfituesit z. Musa Gjura. Kjo pagesë është kryer në bazë të lajmërimit për ekzekutim vullnetar nr. 747, datë 27.12.2010 të Zyrës së Përmbarimit Dibër, sipas "Urdhërit të Ekzekutimit" për titullin ekzekutiv nr. 466, datë 11.09.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, sipas të cilit është vendosur detyrimi i DPSHTRR-së t'i paguaje z. Musa Gjura pagën e 1 viti punë si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së tij të punës, shpenzimet gjyqësore, si dhe taksën përmbarimore.

Z. Musa Gjura ka qenë e emëruar me detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Peshkopi dhe është liruar nga puna me urdhërin e z. Kreshnik Bozho nr. 150, datë 19.11.2008.

Nga të dhënat e nxjerra prej Sektorit të Burimeve Njerëzore rezulton se është emëruar në këtë detyrë z. Mensur Kica, me urdhërin nr. 301, datë 11.06.2010 lëshuar nga Z. Kreshnik Bozho dhe marrëdhëniet financiare i kanë filluar më 15.06.2010.

Nuk ka informacion për numrin e shkresës për rekurs në Gjykatën e Lartë dhe as për kërkesë pezullimi.

Pra, rezulton se janë paguar dy persona për të njëjtin vend pune në shumën e përgjithshme prej 4,864,009 lekë.



MINISTRI E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
RAPORTI PËR RAJONINIA E DREJTORIAJE DREJTORIAE E. E RAJONIAE E
TE SHËNIMEVE TE TRANSPORTIT RAJONAL

Per sa siper DPSHTRR duhej te analizonte gjendjen, te nxirrte pergjegjesite dhe te merrte masat per ndjekjen e te gjitha ceshtjeve ne te tre shkallet e gjyqesiorit brenda afateve ligjore, per eliminimin e pagesave te dyfishta.

Rezultojne 5 raste per masa "Largim nga puna" te cilat jane ende ne proceset gjyqesore te shkallës së parë dhe të apelit, si më poshtë:

1. Vendimi i DPSHTRR nr. 72, datë 21.06.2010 për marrje masë "Largim nga puna" të znj. Nadire Ahmeti, me detyrë "Protokoll-arkivë", në Drejtorinë Rajonale Durrës. Ky vendim është ankimuar dhe në bazë të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr. 552, datë 20.09.2011 është vendosur pranimi i padisë së znj. Nadire Ahmeti dhe ndryshimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. 2821, datë 01.11.2010, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë së kësaj paditëse, si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Në bazë të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës duhet të dëmshpërblehet znj. Nadire Ahmeti me pagën e 3 muajve për për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit, 8 muaj e gjysëm paga për shpërblimin vjetërsi pune si dhe të shpërblejë dëmin duke paguar pagën e 8 muajve pune për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së saj të punës.

Vendimi i Gjykatës së Apelit nuk është ekzekutuar.

Është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë më datë 06.12.2011 dhe është bërë Kërkesë për Pezullim ekzekutimi nr. 3521, datë 16.03.2012 dhe me nr. Gjykatës së Lartë nr.D-35, datë 12.03.2012.

2. Vendimi i DPSHTRR nr. 72, datë 10.06.2011 për marrje masë "Largim nga puna" të znj. Majlinda Prenci, me detyrë "Operatore Kompjuteri", në Drejtorinë Rajonale Tiranë. Ky vendim është ankimuar dhe në bazë të vendimit Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 505, datë 27.01.2012, është vendosur detyrimi i DPSHTRR-së:

- Të paguajë në favor të paditëses Majlinda Prenci pagën e 10 muajve pune për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së saj të punës, në aplikim të nenit 155 të kodit të Punës.

- Të paguajë në favor të paditëses Majlinda Prenci pagën e 3 muajve për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit, sipas nenit 143 të Kodit të Punës.

- Të paguajë në favor të paditëses Majlinda Prenci pagën e 2 muajve punë si rezultat i mosrespektimit të procedurës aplikuar neni 144 i Kodit të Punës

- Të paguajë në favor të paditëses Majlinda Prenci pagën e 2,5 muajve punë për shpërblimin vjetërsi pune aplikuar neni 145 i Kodit të Punës

Nga ana e DPSHTRR është depozituar Rekursi para Gjykatës së Apelit Tiranë dhe çështja është në proces.

3. Vendimi i DPSHTRR nr. 103, datë 05.08.2011 për marrje masë "Largim nga puna" të znj. Entela Koliçinaku, në Drejtorinë Rajonale Korçë, me detyrë "Pranuese Dokumentash", vendimi është ankimuar dhe është në proces gjyqësor të shkallës së parë.

4. Vendimi i DPSHTRR nr. 104, datë 05.08.2011 për marrje masë "Largim nga puna" të z. Detion Shehu me detyrë "Përgjegjës i Sektorit të Personalit dhe Shërbimeve", në Drejtorinë Rajonale Korçë. Ky vendim është ankimuar dhe në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nr. 116, datë 16.01.2012, është vendosur detyrimi i DPSHTRR-së:

- Të paguajë në favor të paditësit z. Detion Shehu 2 paga mujore si dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, në aplikim të nenit 144/5 të Kodit të Punës.

- Të paguajë në favor të paditësit z. Detion Shehu 0.5 pagë si shpërblim për pushimet e pamarrta, në aplikim të nenit 94/5 të Kodit të Punës.

- Të paguajë në favor të paditësit z. Detion Shehu 2.5 paga mujore bruto Gjithsej shuma 136.000 lekë.



procesverbalet e marrjes në dorëzim dhe fletëdaljet janë të shoqëruara me urdhërdorëzimi dhe të firmosura nga personat e caktuar.

Janë mbajtur kartela dyfishe dhe është bërë rakordimi me magazinën në sasi e në vlerë, sipas ligjit nr. 6942, datë 24.12.1984, "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare" dhe ligjit për kontabilitetin.

d. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave.

VITI 2010

-Për vitin 2010, në DPSHTRr Aparati është kryer inventar fizik i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe inventarit në përdorim si dhe ai i vlerave materiale, sipas ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 dhe VKM nr. 70, datë 11.03.1985, kapitulli mbi inventarizimin, bazuar në urdhrin e titullarit nr.756, datë 15.12.2010, ku ishin përcaktuar 2 komisionet e inventarizimit të përbërë nga 3 anëtarë dhe afati i fillimit dhe i përfundimit të inventarit. Pas kryerjes së inventareve, komisionet e inventarizimit kishin përgatitur, zbardhur dhe nënshkruar, fletët përkatëse të inventarizimit dhe ishte hartuar informacioni përkatës për kryerjen e inventarit fizik të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe inventarit në përdorim, sipas të cilave rezultoi të mos ketë patur diferenca si në sasi ashtu edhe në vlerë.

Me urdhër Nr. 756, datë 17.12.2010 të Drejtorit të Përgjithshëm, "Për krijimin e komisionit për asgjësimin e aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese", ishte ngritur komisioni përkatës i përbërë prej 5 punonjësish.

Ky urdhër ka dalë në bazë të Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 32, datë 17.12.2010 dhe për këtë komisioni u mbledh për të kontrolluar dhe grumbulluar një për një materialet e shqyrtuara nga komisioni i vlerësimit në prani të përgjegjësit material.

Vlera fillestare e inventarit ekonomik që ishte vendosur të nxirrej jashtë përdorimit ishte 3,439,218.29 lekë, amortizim të akumuluar në vlerë 3,041,543.82 lekë, pra një vlerë e mbetur prej 397,674.47 lekë.

Komisioni u mbledh përsëri për vlerësimin e mënyrës së asgjësimit. Komisioni, duke u bazuar në procesverbalin e vlerësimit të komisionit për nxjerrje jashtë përdorimit, vendosi të bëjë asgjësimin e plotë të materialeve, të inventarit të imët, paisjeve të zyrës si dhe atyre informatike dhe materialeve në magazinë.

Pa kësaj u realizua shkatërrimi dhe asgjësimi i këtyre materialeve, mbi bazën e procesverbalit nr. 2, datë 23.12.2010, mbeturinat e të cilave u transportuan me rrujetet e DPSHTRr-së në vendin e hedhjes së mbeturinave në Sharrë. Në fund është hartuar relacioni përkatës për Drejtorin e Përgjithshëm.

VITI 2011

-Për vitin 2011, në DPSHTRr Aparati, është kryer inventar fizik i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe inventarit në përdorim si dhe ai i vlerave materiale, sipas ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 dhe VKM nr. 70, datë 11.03.1985, kapitulli mbi inventarizimin, bazuar në urdhrin e titullarit nr. 517, datë 26.12.2011, ku ishin përcaktuar 2 komisionet e inventarizimit të përbërë nga 3 anëtarë secili si dhe afati i fillimit dhe i përfundimit të inventarit. Pas kryerjes së inventareve, komisionet e inventarizimit kishin përgatitur, zbardhur dhe nënshkruar, fletët përkatëse të inventarizimit për kryerjen e inventarit fizik të aktiveve të qëndrueshme të



REPUBLIKA E ALBANIË

RAPORTI PËR AUDITIMIN E QENDRUESHMIKË DHE QENDRËSË PËR PASTRTETI TË VEPRIMEVE TË TRANSPORTIT DUEOR

trupëzuara dhe inventarit në përdorim, sipas të cilave nuk pati diferenca si në sasi ashtu edhe në vlefë.

Me Vendimin Nr. 26, datë 29.12.2011 të Këshillit Drejtues, "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e DPSHTRr", është miratuar relacioni i paraqitur nga Komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në Aparatin e DPSHTRr-së dhe në 6 drejtori rajonale: DRSHTRr Berat, Kukës, Elbasan, Tiranë, Korçë, Vlorë.

Në DPSHTRr është miratuar për nxjerrje jashtë përdorimit:

-Inventar Ekonomik, 29 artikuj, vlera fillestare 668,659 lekë
-Pajisje Informatike 24 artikuj, vlera fillestare 4,356,683 lekë
-Inventar i Imët, 36 artikuj, vlera fillestare 104,746 lekë
Gjithsej 5,130,088 lekë

e. Gjendja e mallrave stok e me qarkullim të ngadalshëm, shkaqet e krijimit dhe masat e marra për evadimin e tyre.

Nga auditimi rezultuan gjendje mallra stoqe në vlerën totale prej 2,093,148 lekë, prej të cilave magazina qendrore e biletave 1,091,340 lekë dhe magazina teknike 1,001,808 lekë, si më poshtë:

N/R	Pershkrimi	Njesia	Gjendje	Kosto	Vlefte
1	Bileta takse qarkullimi për 2010	cope	267.00	20.00	5,340.00
2	Bileta takse rregjistrimi për 2010	cope	267.00	20.00	5,340.00
3	Pulla takse qarkullimi për 2009	cope	10,650.00	20.00	213,000.00
4	Bileta takse qarkullimi për 09	cope	213.00	20.00	4,260.00
5	Pulla takse qarkullimi për 2010	cope	13,350.00	24.20	323,070.00
6	Pulla takse rregjistrimi për 2009	cope	10,650.00	20.00	213,000.00
7	Bileta takse rregjistrimi për 2009	cope	213.00	20.00	4,260.00
8	pulla takse rregjistrimi për 2010	cope	13,350.00	24.20	323,070.00
9	Bileta takse rregjistrimi për 2011	cope	720.00	18.00	12,960.00
10	Pulla takse rregjistrimi për 2011	cope	36,000.00	27.47	988,348.00
TOTALI					2,093,148

Gjendja e mallrave stoqe në magazinën qendrore të biletave prej 1,091,340 lekë, përfaqëson sasi të biletave dhe pullave takse rregjistrimi dhe qarkullimi, të cilat janë krijuar për shkak se pasi janë tenderuar në vitet përkatëse në bazë të pritshmërisë së mjeteve për të prerë taksat, realizimi faktik i mjeteve të paraqitura ka qenë më i ulët nga programimi.

Gjendja e mallrave stoqe në magazinën teknike prej 1,001,808 lekë, përfaqëson pulla takse rregjistrimi, 36000 cope, të cilat kanë si shkak të krijimit të tyre ndryshimin e ligjit të taksave që hyri në fuqi më 23 gusht 2011 dhe për periudhën deri në dhjetor 2011 u përdorën vetëm pullat e taksës së qarkullimit.

Këto mallra stoqe janë krijuar prej vitit 2009 e në vazhdim.



MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

KUJDESIA E PËRMBLEDHËSISË DHE PËRGJITHSHMËS
TË VEPRIMEVE TË TRANSPORTIT RUGOR

V. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.

a. *Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit. Kontrolli i veprimeve kontabël të regjistruar në ditar.*

Kontabiliteti në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor mbahet i kompjuterizuar sipas programit ALPHA.

Pasqyrat financiare janë mbyllur në bazë të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare". Hartimi i këtyre pasqyrave ishte bazuar në standartet e miratuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

Kontabilizimi i veprimeve të ndryshme bëhet mbi bazën e regjistrimit kronologjik sipas rradhës së kryerjes së tyre në ditar, duke zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.

b. *Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore nga institucionet e vartësisë dhe përgatitja e përmbledhësës së pasqyrave nga Drejtoria e Përgjithshme dhe raportimi në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.*

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është e organizuar në 14 njësi vartësie, nga të cilat 13 janë ndërmarrje shërbimi dhe 1 është ndërmarrje prodhimi. Të gjitha njësitë vartëse janë të organizuara me bilanc dhe rezultat ekonomik-financiar të veçantë. Deri në vitin 2010 në fund të çdo viti ushtrimor, drejtoritë rajonale një kopje të bilancit e paraqisnin në degët e tatim-taksave të rretheve përkatëse dhe një kopje në Drejtorinë e Përgjithshme. Por duke filluar nga viti 2011, njësitë e vartësisë nuk kanë më marrëdhënie me degët e tatim-taksave të rrethe, por fondet e arkëtuara derdhen në DPSHTRR Aparati, e cila harton bilancin përmbledhës të veprimtarisë së përgjithshme dhe derdh tatimet e taksat në Drejtorinë e Tatim-Paguesve të Medhenj.

Pasqyrat financiare për vitin 2009 dhe vitin 2010 janë mbyllur në bazë të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare" dhe në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të miratuara nga Ministri i Financave me Urdhërin nr. 4292, datë 15.06.2006, hyrë në fuqi më datën 01.01.2008. Kontabiliteti mbahet në monedhën vëndase në lekë.

Është kryer auditimi i llogarive dhe i saktësisë së llogarive vjetore nga ekspertët kontabël të cilët për vitin 2009 dhe për vitin 2010 kanë dhënë opinion se: "Pasqyrat Financiare të ndërmarrjes "Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor" japin një pamje të vërtetë dhe të sigurtë të gjendjes financiare të ndërmarrjes me datë 31.12.2009, të rezultatit të saj financiar dhe të fluksit të parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar".

Më poshtë po pasqyrojmë rezultatet e auditimit të llogarive vjetore të ushtruar nga KLSH:

Për vitin 2010 sipas bilancit të konsoliduar DPSHTRR, ka rezultuar me fitim për 258 767 876 lekë, konkretisht:

Totali i te ardhurave	1 334 976 608 lekë
Totali i shpenzimeve	1 076 208 732 lekë
Fitimi i ushtrimit	258 767 876 lekë




KONTROLI I PARË I VITIT 2011

RAPORT I PËRCAKTIMIT DHE DHEKIMIT TË DASHKONJËS CHËPIMIALE DHE TË SHËRREBUEVE TË TRANSPORTIT KRUÇOR.

Nga analiza e rezultatit vëmë re se 76.7% e te ardhurave janë te ardhura te shfrytëzimit, te cilat përcaktojnë ecurinë e shoqërisë dhe pjesa tjetër janë te ardhura dytësore. Krahasuar me vitin 2009 kanë ulje te ndjeshme ne masën 262 753 533 lëke.

Megjithatë drejtoria rezulton me një kontribut marxhinal pozitiv i cili mbulon shpenzimet fikse te saj (shpenzime personeli+amortizimi) duke rezultuar me fitim. Fitimi i vitit është shpërndarë Rezerve Statutore, Rezerve Ligjore, dhe Rezerva te Tjera.

Ne grafikun e mëposhtëm po pasqyrojmë rezultati financiar te kesaj ndermarrje per 4 (kater) vitet duke filluar nga viti 2007:



Sic shihet nga grafiku, ne vitin 2010 krahasuar me tre vitet e mëparshme rezultati financiar është me i ulët, si pasojë e mosrealizimit te te ardhurave ne te njëjtin nivel me vitet e kaluara.

Me poshte po japin te dhenat e bilancit te konsoliduar per 4 (kater) vite:

Bilanci	2007 Viti	2008 Viti	2009 Viti	2010 Viti
AKTIVE				
Aktive afatshkurtra	1 713 000 130	1 314 916 941	1 540 222 239	1 500 939 367
Aktive monetare	48 968 612	70 588 018	174 116 005	133 717 495
Arkesa te arketueshme	57 066 220	112 602 264	123 294 972	76 835 810
veniant	1 854 034 932	1 494 537 597	1 837 633 215	1 731 246 940
aktivi i aktiveve afatshkurtra	388 463 166	381 062 462	410 591 798	539 113 539
Afatgj. materiale	25 855 346	63 912 586	85 245 702	60 161 784
Afatgj. jomater	2 268 353 694	1 943 512 641	2 320 756 414	2 329 593 460
aktivi i aktiveve				
PASIVE				
Detyrimet afatshkurtra	235 315 108	454 621 465	396 754 235	439 955 067
Grantet he te ardhura te shqyrt	1 744 598	1 830 948	16 626 559	6 725 951
Detyrimet afatgjera	0	1 404 539	0	0
Tashti i Detyrimeve	257 639 726	457 856 971	413 389 794	437 681 028
Kapitali aksionar	183 557 903	861 750 239	957 402 110	1 111 535 113
Rezerva ligjore	22 113 685	101 571 715	128 213 879	143 710 736




MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
 NË NJË BLEXHË ME TËNDRYSHUARIN E PASQYRAT FINANCIARE
 PËR VITIN 2007

			1 034 759	14 734 509
Rezerva Statutore				
Rezerva te tjera	748 731 627	-2 417 382	374 084 552	385 256 708
Fund i vinit eshtuimer	356 560 773	524 931 087	456 625 622	231 723 366
Totali i Pasivit	2 268 353 694	1 943 514 641	2 338 756 415	2 329 593 460

Për të gjithë postet e bilancit të konsoliduar, mungojnë shënimet shpjeguese në kundërshtim me Nenin 12 "Përbërësit e pasqyrave financiare", të Ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006.
 Me poshte po paraqesim grafikisht kapitali i investuar per 4 (kater) vite:



Referuar grafikut, kapitali i investuar, përveç vitit 2008 që ka një rënie të ndjeshme, vitet e tjera është pothuajse në të njëjtin nivel. Në uljen e kapitalit të investuar në vitin 2008, ka ndikuar negativisht pakësimi i Rezervës ligjore, nga 748 731 627 leke në -2 417 382 leke, për të cilën sic u tha më sipër mungojnë shënimet shpjeguese.

Me poshte po japim disa nga treguesit që pasqyrojnë rezultatet e drejtimit të kësaj Drejtorie:

- Raporti i likuiditetit të përgjithshëm (Aktive afatshkurtra /detyrime rrjedhëse)

Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
7.2 here	3.2 here	4.6 here	4 here

Ky raport është më i lartë se treguesi teorik 1 (një) dhe tregon që aktivet afatshkurtra, mbulojnë detyrimet rrjedhëse (detyrime që duhet të likuidohen brenda vitit).

Aftësia likuiduese e shoqërisë paraqitet me e sakte nëpërmjet raportit të likuiditetit të menjëhershëm që është Likuiditet/detyrime rrjedhëse si më poshte:



MINISTRORE E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
RAPORTI MË RAQITJE TËN EKSPLOATIMIT DHE SHËRBIUT
MË KËMBANITË E TRANSPORTIT DHEKOMB

Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
6.6 here	2.9 here	3.4 here	3.8 here

Ky raport është nën treguesin teorik 1 (një) dhe tregon që me likuiditetet që ka në dispozicion shoqëria është në gjendje të mbulojë detyrimet rrjedhëse.

-Koha mesatare e arketimit të klienteve (Kliente/Shitje/360 dite):

Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
15.1 dite	18.9 dite	48 dite	42.6 dite

Ky raport tregon kohën që duhet të prese Drejtoria për të arkëtuar faturën nga momenti i realizimit të shërbimit. Për vitin 2010, shoqëria duhet të prese mesatarisht 42.6 dite për arketimin e fatures. Kemi një përmirësim të këtij treguesi në krahasim me vitin e kaluar.

-Raporti i Kthimit të Aktiveve Afatshkurtra (ROI)(Shitje/Aktive afatshkurtra):

Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
0.6 here	0.9 here	0.7 here	0.59 here

Krahasuar me dy vitet e mëparshme, aktivet afatshkurtra janë shfrytëzuar më pak.

-Raporti i kthimit në kapital (ROE), (Fitimi neto/Kapitalin e vet):

Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
19.7%	35.3 %	23.8%	12.2%

Në krahasim me vitet e mëparshme ky raport është përkeqësuar dhe tregon se për çdo lek të investuar, merret fitim 12.2%.

-Raporti i borxhit (Detyrime/Kapitali i investuar):

Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
11.3 %	23.5%	17 %	16%

Nga treguesit e mësipërm shohim se, shoqëria punon 84% me kapital të vetë dhe 16 % kapital të huajtur. Kreditoret financojnë rreth 16% të kapitalit të investuar të shoqërise.


Raportin e borxhit e paraqesim dhe grafikisht, si më poshtë:



KOMITETI I KONTROLLIT

U. POLITIKË E AUDITIMIT E QENITËSIA E SHËRBIMIT E PËRVEKËTIMIT E
IS E TË ARBËRVE TË TRANSPORTIT KOSMET.

Raporti i borxhit



-Norma e materialeve (Shpenzime per materiale/te ardhurat nga veprimtaria):

Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
26.3 %	24%	25.9 %	26.6%

Shpenzimet per materiale zene 26.6% te te ardhurave nga aktiviteti. Kjo norme eshte rritur ne krahasim me vitin e kaluar dhe tregon nje perkeqesim te kostos.

- Gjendja e likuiditeteve ne fillim te periudhes eshte 1,540,222,238 leke
- Mjete monetare te krijuara nga klientet jane 5,476,622,097 leke.
- Janë paguar furnitorë dhe punonjës - 944 817 846 leke
- Tatim fitimi eshte - 46,776,512 leke
- Paguar detyrime te paguara - 4,524,310,610 leke

Gjithsej detyrime te paguara për vitin 2010 janë - 5,515,904,968 leko. Pra janë bere 39,282,871 leke pagesa me tepër se likuiditetet e krijuara, për te cilat është prekur gjendja e likuiditeteve gjendje nga vitit i kaluar.

Si konkluzion , referuar treguesve te mesiperm, pamvaresisht se disa raporte te vecanta jane ne rente krahasuar me vitet e meparshme, ecuria e Drejtorise ne dukje eshte pozitive. Por, duhet patur kujdes ne menaxhimin e likuiditeteve, pasi nga analiza direkte e pasqyres se Cash-Flow del se, jane harxhuar likuiditete me shume se sa jane krijuar gjate vitit. Si rrjedhim jane pakesuar edhe likuiditetet gjendje ne fillim te periudhes.

VI. Mbi ligjshmerine e planifikimit dhe perdorimit te te ardhurave qe krijon DPSHTRR dhe drejtorite rajonale:

Me poshte po trajtojme disa probleme te ndryshme te konstatuara nga kontrolli ne lidhje me te ardhurat e krijuara, pasi ligjshmeria e planifikimit dhe realizimit te tyre eshte trajtuar gjercsisht ne piken "II" "Kontrolli mbi zbatimin e programit financiar" te ketij projektraporti:



KOMITETI I ASISTENTËS DREJTORIA

RAPORTI PËR AUDITIMIN E DREJTORIAJË NË ORGANIZATËN E SHËRBIMEVE
TË LLOJESHEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është krijuar me VKM nr. 343, datë 21.07.1999, e cila ka status juridik "Ndërmarrje Shtetërore me vetëfinancim" dhe është në varesi direkte të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit. Kjo ndërmarrje ka për objekt:

- Regjistrimi i mjeteve, pajisja e tyre me leje qarkullimi, targa, regjistrimi i pronarëve dhe pajisja me çertifikata pronësie;
- Kualifikimi dhe pajisja e drejtuesve të mjeteve me leje drejtimi;
- Kontrolli teknik i detyrueshëm i mjeteve rrugore;
- Krijimi i regjistrit kombëtar të mjeteve dhe drejtuesve të tyre;
- Organizimi për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit bazë për transportin rrugor;
- Kryerja e veprimtarisë së "agjentit tatimor", sipas përcaktimeve ligjore;
- Dhënia e lejeve të veprimtarisë së autoshkollave; etj.

Për ushtrimin e këtyre aktiviteteve nga DPSHTRR janë përcaktuar vlerat e tarifave sipas llojeve të shërbimeve dhe nga arketimi i të cilave perbehen të ardhurat e shfrytëzimit.

Nga auditimi që j'u bë analizës së kostos së tarifave të shërbimit rezultoi se:

Çdo tarifë shërbimi sipas llojit të veprimtarisë është përgatitur në analize si më poshtë:

- Vlera e materialeve (fatura, procesverbale, regjistra, prokat, etj).
- Vlera e kohës së punës direkte
- Vlera e kohës së punës ndihmëse
- Shpenzime ndihmëse (ruajtje objekti, amortizim, riparim, mirëmbajtje ,etj)
- Shpenzimet e përgjithshme të Drejtorisë Rajonale
- Shpenzimet e përgjithshme të Drejtorisë së Përgjithshme

Shuma

-Mbi këtë shumë shtohet 25% efektiviteti ekonomik (fitimi)

-Mbi shumën e dalë shtohet 20% vlera e TVSH

Shuma totale, përben tarifen e shërbimit.

Pra, në vlerën e tarifës janë përfshirë të gjitha shpenzimet që kryhen për shërbimin e ofruar dhe mbi këtë vlerë është parashikuar që ndërmarrja të ketë 25% rentabilitet, çka do të thotë që në pamjen e parë rezultati financiar i ndërmarrjes do të jetë me fitim të parashikuar në masën 25 % të të ardhurave të mbledhura.

Po kështu u kontrollua edhe analiza e kostos së çmimit të materialeve që kanë të bëjnë me blerjen e lëndës së parë dhe prodhimin e tyre të përgatitur nga Drejtoria varesë ajo e Targave dhe Shtypshkrimeve, Durrës, si më poshtë:

- Vlera e lëndës së parë, materiale ndihmëse
- Vlera e kohës së punës, sigurime shoqërore e shëndetësore
- Energji elektrike, uje, amortizim , etj.

Shuma

-Mbi këtë shumë shtohet 15 % shpenzime reparti

Shuma

-Mbi këtë shumë shtohet 30 % shpenzime të përgjithshme

Shuma

-Mbi shumën e dalë shtohet edhe 30% fitimi.

Shuma totale e të gjitha shpenzimeve të mesipërme përben çmimin e shitjes së materialeve.

Materialet e prodhuara u shpërndahen të gjitha drejtorive rajonale për kryerjen e shërbimeve.



DPSHTRR kur nderton vlerat e tarifës së shërbimeve, çmimin e materialeve e ka të përcaktuar, pasi ka marrë për bazë çmimet e shitjeve sipas kësaj drejtorie.

Pra del qarte se, vlerat e tarifave të shërbimeve kanë në vetvete dy norma fitimi, një norme prej 30 % të çmimit të shitjes dhe një norme fitimi 25 % të shitjes përfundimtare të shërbimit. Thënë ndryshe, të ardhurat e mbledhura nga tarifat e shërbimeve të arketuara nga subjektet fizike, juridike shtetërore të cilat blejnë shërbimin nga DPSHTRR, përmbajnë në vetvete një normë fitimi rreth 55% kundrejt shpenzimeve direkte.

Per ta konkretizuar këtë po japim një shembull për të ardhurat e mbledhura vetëm nga shitja e targave, si më poshtë:

Çmimi i një targë që Drejtoria e Targave dhe Shtypshkrimeve ua shet drejtorive rajonale është 800 leke dhe çifti 1600 leke pa TVSH. Ky çmim ka në vetvete 37 % vlerën e fitimit të kësaj drejtorie, ose 216 leke fitim për çift dhe për çift 432 leke pa TVSH. Ndërsa DPSHTRR ka përcaktuar tarifen e shërbimit për një çift targash 2500 leke pa TVSH, kjo vlerë ka në vetvete edhe vlerën e fitimit të vendosur nga Drejtorisë e Përgjithshme që është 25 % ose 500 leke për çift.

Pra, shitja e një çifti targash që është 2500 leke mbart në vetvete një normë fitimi në vlerë 932 leke (432 leke+500 leke) ose 59.4 % e vlerës së tarifës (2500 leke- 932 leke fitim), pra për 2500 leke të ardhura ndërmarrja merr fitim 932 leke ose e shprehur ndryshe mbi shpenzimet e totale prej 1568 leke rezulton një normë fitimi prej 932 leke për çift targash.

Kjo strukturë çmimi është ndërtuar përbashkë për të gjitha vlerat e tarifave për çdo lloj shërbimi, si regjistrimi i mjeteve, lejet e qarkullimit, lejet e drejtimit, kontrolli fizik, etj.

Si përfundim, ashtu siç është trajtuar dhe më lart, ecuria e kësaj Drejtorie në pamje të përgjithshme duket tejte e shëndoshe financiarisht, pasi për vitin 2010 ka realizuar një fitim bruto 310,655,100 leke. Por, nga analiza e të ardhurave të arketuara sipas objektivit kryesor të veprimtarisë për të cilën është krijuar kjo ndërmarrje, vërejmë se nga totali i të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2010 prej 1,334,976,608 leke, 76.7% e tyre ose 1,023,927,058 leke janë të ardhura të shfrytëzimit, të cilat janë përcaktues në ecurinë e shoqërisë. Pjesa tjetër prej 311,049,549 leke janë të ardhura që nuk kanë të bëjnë me aktivitetin kryesor të kësaj ndërmarrje, pasi janë të ardhura dytesore. Pjesën më të madhe të këtyre të ardhurave e zënë të ardhurat e nga kryerja e veprimtarisë si agjent tatimor për mbledhjen e taksave kombëtare për të cilat përfiton 5-6% të tyre dhe për vitin 2010 ka përfituar rreth 305 milion leke.

Pra, fitimi para tatimit për vitin 2010 është 310,655,100 leke, ndërsa të ardhurat nga agjenti tatimor janë 305 milion leke, prej ku del qarte se i gjithë rezultati financiar pozitiv i ndërmarrjes ka ardhur nga aktiviteti si agjent tatimor, edhe pse vlerat e tarifave të shërbimeve janë ndërtuar në strukturë me një fitim tejte të lartë që shkon rreth 50-60 %.

Nisur nga analiza e mësipërme ku dalin në pah rezervat në menazhimin dhe administrimin e ndërmarrjes, si dhe nga Urdhëri 8, datë 29.05.2008 i Ministrit të PPT, me anën e të cilit, Ministri ka të drejtë të urdhërojë derdhjen në buxhetin e shtetit të të gjithë fondeve të tepërta të krijuara nga fitimet e ndërmarrjes ku konkretisht gjatë vitit 2010 nga fitimi e ndërmarrjes janë derdhur në buxhetin e shtetit 200 milion leke dalim në konkluzionin se:

- Është e nevojshme që Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të rishikojë formën e drejtimit dhe të statusin e kësaj ndërmarrje.



2. Në vitin 2010 sipas programit financiar arketimet nga gjabat që vendosin strukturate kontrollit rrugor të DPSHTRR kanë qenë të planifikuara në masën 20,400 mijë leke, dhe në fakt janë realizuar në masën 24,318 mijë leke, me një tejkalim për 3,918 mijë leke. Ndërsa në vitin 2011 sipas programit financiar arketimet nga këto gjabat kanë qenë të planifikuara në masën 23,500 mijë leke dhe janë realizuar në masën 10,870 mijë leke, me mos realizim prej 12,630 mijë leke.

Mos realizimi i ketyre të ardhurave për vitin 2011 ka ardhur për shkak të daljes së urdherit të Drejtorit të DPSHTRR nr.168, datën 01.04.2011 "Për përdorimin e automjeteve të sektorit të Kontrollit Rrugor". Me anën e këtij urdhëri janë bllokuar dhe nuk levizim të gjitha automjetet që janë në dispozicion të sektoreve të Kontrollit Rrugor në cdo Drejtori Rajonale. *Munëgesa e këtij kontrolli, përveç mosarketimit të të ardhurave nga gjabat për kundravajtje rrugore, sjell indirekt edhe humbje të tjera që vijnë si pasojë e mosdetyrimit të paraqitjes së shumë subjekteve në sportelet e DPSHTRR për të shlyer detyrimet e prapambetura që kanë ndaj saj.*

3. U krye auditimi me qëllim räkordimin e numurit të mjeteve që kanë kryer kontroll teknik të detyrueshëm me numrin e mjeteve të regjistruara të cilat kanë paguar taksat vjetore.

Auditimi u përqendrua vetëm për vitin 2011, pasi në datën 21 prill 2011 ka dalë Ligji nr. 10418 "Për Legalizimin e Kapitalit dhe Faljen e Borsit Tataror dhe Doganor". Me anën e këtij ligji janë falur të gjitha detyrimet e prapambetura të pronarëve të mjeteve që kanë patur për taksën e regjistrimit dhe taksën e räkullimit rrugor të përvitshëm deri në datën 31.12.2010. Por, për shkak të mos nxjerrjes së akteve nëligjore, zbatimi i tij është bërë i mundur rreth tre muaj me vonë në datën 14.07.2011. Gjate kësaj periudhe vakuumi, mund të ndodhte evazion fiskal, pasi mund të mos arkëtoheshin taksat e prapambetura të viteve paraardhëse nga disa pronarë mjeteesh që mund të kryhenin shërbimin e radhës përkisht në këto periudhe vakuumi.

Nga auditimi u konstatua:

Sipas të dhënave që disponon Drejtoria Ekonomike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, për vitin 2011 janë regjistruar dhe kanë paguar taksat gjithsej 262,857 mjete. Nga ky numër zbrisim numrin e mjeteve që kanë patur detyrimet e viteve paraardhëse dhe janë arkëtuar gjatë vitit 2011 (para daljes së ligjit të sipërcituar), dhe numri i mjeteve që kanë paguar taksat vetëm për këtë vit është 259,865.

Shërbimi i kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore në të gjithë vendin në baze të kontratës datë 03.09.2009 i është dhënë me koncesion, shoqëri "SGS Automotive Albania". Sipas të dhënave operative të marra në datë 26.03.2012 nga Drejtoria Ekonomike pranë DPSHTRR tek kjo shoqëri, mjete që kanë kryer kontroll teknik vjetor e periodik të pakten 1

herë përgjatë vitit 2011 janë 252,352. Ky numër është zhveshur nga kontrollet e dyta periodike të mjeteve që e kanë detyrim ligjor, por ka të përfshirë numrin e ciklomotoreve që janë 3,255, dhe të cilat sipas ligjit nr. 9975, dt. 28.07.2008, "Për sistemin e taksave në RSH", kryejnë kontroll teknik por, nuk arkëtojnë taksat e mesipërme.

Bejme räkordimet:

- Kane paguar taksat gjatë vitit 259,865 mjete,
- Kane kryer kontrollin teknik të detyrueshëm vjetor 252,352 mjete dhe 3,255 ciklomotore.
- Del një diferencë prej 10,868 mjete që nuk kanë kryer kontrolle teknike të detyrueshme (259,865-252,352-3.255)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËR GJITHSHMË TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR".

Nga numri 10,868 mjete zoresim numrin e mjeteve qe jane regjistruar per here te pare me 0(zero) km, te cilat jane perjashtuar nga kryerja e kontrollit teknik, dhe jane ne numur 4,213 (1662 motomjete dhe 2551 mjete).

Ne perfundim del nje diference prej 6,655 mjete (10,868-4,213) qe kane paguar taksat por nuk kane kryer kontrole teknike.

Mos kryerja e kontrollit teknik te 6,655 mjeteve te ndryshme, sjell mosarketim te tarifave te ketij sherbimi ne arken e koncesionarit dhe per pasoje edhe te ardhura te munguara per buxhetin e shtetit, pasi koncesionari ne zbatim te kontrates se koncesionit ka detyrimin t'i paguaje buxhetit te shtetit nje tarife prej 5% te xhiros vjetore.

VII. Mbi debi-kreditë.

a. Gjendja dhe dinamika e debi -- kredive krahasuar me fillimin e vitit dhe vitet paraardhës.

Debitorët

Në fund të vitit vitin 2010 gjendja e debitorëve në fillim të vitit është 172,398,413 lekë, në fund të këtij viti debitorët janë në vlerën 151,654,770 lekë, duke rezultuar kështu me një ulje prej 20,743,643 lekë. Të gjithë këta debitorë rezultojnë se janë të arkëtueshëm.

Kreditorët

Në fund të vitit 2010 gjendja e kreditorëve në fillim të vitit është 396,764,235 lekë, në fund të këtij viti kreditorët janë në vlerën 430,955,067 lekë, duke rezultuar kështu me një rritje prej 34,190,832 lekë.

Struktura e kreditorëve paraqitet si më poshtë:

			në lekë
Nr.	Huat dhe parapagimet	Gjithsej	430,955,067
	Nga këto:		
a.	Të pagueshme ndaj furnitorëve		366,861,896
b.	Të pagueshme ndaj punorjësve		14,948,317
c.	Detyrimet tatimore		47,798,459
d.	Parapagimet e arkëtuara		1,346,394

Prej gjëndjes së kreditorëve në fund të vitit 2010 në shumën 430,955,067 lekë, detyrimet ndaj furnitorëve janë 366,861,896 lekë kundrejt 341,586,632 lekë në fillim të vitit 2010, duke shënuar një rritje prej 25,275,214 lekë.

Këtu duhet theksuar se në nivel institucioni nuk hartohet një evidencë analitike për debitorët dhe kreditorët, por secila drejtori rajonale i ndjek vetë debitorët e saj dhe nuk raportohen në Qendër dhe as përfshihen analitikisht në bilancet që dërgohen në DPSHTRR Aparati.

b. Evidentimi, dokumentimi dhe kuadrimi i debi-kredive.

Debi kreditë janë të pasqyruara saktë në evidencën kontabël. Ato janë të kuadruara me treguesit e paraqitur në bilancin e viteve 2009 dhe 2010 dhe me portitarët përkatës.

c. Shkaqet e mosarketimit të debitorëve.

Nga evidencat e Sektorit Juridik, rezulton se në DPSHTRR Aparati debitorët janë në 32 subjekte në shumën e përgjithshme prej 2,143,785 lekë në fund të vitit 2011, dhe pothuajse për



të gjithë janë ngritur paditë civile, në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 357, datë 28.07.2010, si më poshtë:

1. Padia për subjektin Cela Tatizat, 600,000 lekë, në proces gjykimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Padia për shumën për të cilën kanë detyrim solidar palët Manjola Dhano, Vladimir Hodaj, Vladimir Zëre dhe Sadedin Çeliku, 201,454 lekë, në proces gjykimi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Padia për subjektin E-88, 30,000 lekë, është ndjekur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila me vendimin nr. 1235, datë 14.02.2012 ka rrëzuar kërkesë padinë. Është depozituar ankimi për ndjekjen e çështjes pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
4. Për subjektin Mark Lleshi, 244,106 lekë, është ngritur kundër padi për të kërkuar shumën për të cilën ai është debitor pranë DPSHTRR-së dhe është në proces gjykimi së bashku me padinë e tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
5. Për debitorët Shpëtim Cani dhe Lorent Fezga, 175,790 lekë, janë rrëzuar paditë edhe nga Gjykata e Apelit dhe është depozituar pranë Gjykatës së Iartë, rekursi për kundërshtimin e vendimit dhe pranimin e padisë.
6. Padia për subjektin Real Com, 831,620 lekë, është në proces gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

VIII. Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.

Nga të dhënat e marra nga sistemi elektronik dhe nga regjistri i realizimit të prokurimeve, del se DPSHRR-ja, gjatë viteve 2010 dhe 2011, ka realizuar gjithsej 22 procedura prokurimi me fond limit 333.110.822,95 leke, pa TVSH dhe janë lidhur po 22 kontrata me vlerë të përgjithshme 311.085.386 leke, pa TVSH, respektivisht:

-Në vitin 2010 janë realizuar 12 procedura prokurimi me fond limit , 276.177.719,95 leke, pa TVSH dhe janë lidhur po 12 kontrata me vlerë 261.182.485 leke pa TVSH.

Nga këto janë realizuar:

- 9 (nente) procedura të formes "Prokurim i hapur " elektronik me fond limit 228.376.429,95 leke, pa TVSH dhe janë lidhur po 9 kontrata me vlerë 214.270.375 leke pa TVSH.

-3 (tre) procedura janë të formes "Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit me fond limit 47.801.290 leke, pa TVSH dhe janë lidhur po 3(tre) kontrata me vlerë 46.912.110 leke pa TVSH.

-Jane anuluar 2 (dy) procedura, për shkak të mungesës së konkurrencës

-Në vitin 2011 janë realizuar 10 procedura prokurimi me fond limit 56.933.103 leke dhe janë lidhur po 10 kontrata me vlerë totale 49.902.901 leke pa TVSH.

Nga këto:

- 8 procedura prokurimi elektronike të hapura me fond limit 40.499.735 leke, dhe janë lidhur 8 kontrata me vlerë të përgjithshme 33.701.751 leke, pa TVSH

-2 procedura prokurimi me negociim me fond limit 16.433.368 leke, pa TVSH dhe janë lidhur 2 kontrata me vlerë 16.201.150 leke ,pa TVSH .

6 (gjashtë) procedura prokurimi janë anuluar. Anullimi i këtyre procedurave është bërë për këto arsye:

5 janë anuluar për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit nga Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në përputhje me kërkesat e vendosura në DT dhe 1 është anuluar për shkak të mungesës së konkurrencës.



Ne te gjitha rastet e anulimit te procedurave te prokurimit jane analizuar shkaqet e anulimit te procedurave ne zbatim te Krenit VII te VKM-se nr 1, date 10.01.2007 "Per rregullat e prokurimit publik" me te gjitha ndryshimet perkatese dhe pas kesaj menjehere kane filluar perseri procedurat ne perputhje me Ligjin nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", VKM nr.1 dt.10.01.2007 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me te gjitha ndryshimet perkatese si dhe aktet ligjore e nenligjore ne zbatim .

Auditimi u krye me zgjedhje dhe u pergjendrua kryesisht ne pergatitjen dhe dorezimin e regjistrave te prokurimit, hartimin e i specifikimeve teknike, perlogaritjen e vleres limit te kontratave dhe, ne zbatimin e procedurave te prokurimeve.

Nga auditimi u konstatua:

1. Regjistrat e prokurimeve

Sektori i prokurimeve ka pergatitur dhe dorezuar regjistrat vjetore te parashikimet te prokurimeve, ne zbatim te VKM-se nr.1 dt.10.01.2007 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" dhe ne perputhje me formen dhe menyren qe parashikohet ne Udhезimet e APP-se. Keshtu, ky Autoritet Kontraktor ka derguar prane Agjencie se Prokurimit Publik brenda afateve ligjore :

- Regjistrin i Realizimit vjetor te vitit 2009.
- Regjistri i Parashikimeve te Prokurimeve Publike te vitit 2010 dhe vitit 2011.
- Regjistri i Realizimit per cdo 4- mujor te vitit 2010 dhe vitit 2011.
- Regjistri i Realizimit vjetor te vitit 2010 dhe vitit 2011.

2. Hartimi i specifikimeve teknike.

Ne te gjitha procedurat e prokurimit te zhvilluar nga ky Autoritet Kontraktor, hartimi i specifikimeve teknike eshte bere ne cdo rast me Grup pune i ngritur me Urdher te Titullarit te AK ne varesi te objektit te prokurimit. Ne pergjithesi specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 23 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" si dhe akteve ligjore ne zbatim . Megjithate ka patur raste qe si rezultat i kerkesave per sqarim te paraqitura nga Operatoret Ekonomike apo dhe me inisiativen e vot Autoritetit Kontraktor jane bere modifikime ne specifikimet teknike ne varesi te objektit te prokurimit . Si rezultat eshte shtyre dhe data e tenderit ne zbatim te LPP-se.

3. Llogaritja e vleres limit te kontratave.

Vlera limit e Kontrates publike eshte shuma totale e pagaeshme , pa tysh e llogaritur nga Autoriteti Kontraktor perpara dergimit per botim te njoftimit te Prokurimit. Per te gjitha procedurat e prokurimit te zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor per perlogaritjen e vleres limit te kontrates jane zbatuar kerkesat e percaktuar ne rregullat e prokurimit publik. Megjithate u verejten se, per cdo tender te realizuar per blerjen e prokatit te targave dhe prokatit te lejeve te drejtimit, Drejtoria e Pergjitheshme ka ngarkuar Drejtorine vartese te saj Drejtorine e Targave dhe Shtypshkrimeve , Durres per te percaktuar sasite te nevojshme si dhe perlogaritjen e vleres limit te kontrates dhe argumentimin e llogaritjes se tyre. Ne te gjitha tenderat e realizuar gjate periudhes se mesipenne per keto objekte, perlogaritja e vleres limit te kontrates eshte bere nga Drejtoria e sipercituar duke marre per baze emimet mesatare te tregut. Per kete kjo drejtori llogarit emimet mesatare te tregut bazuar ne ofertat e ardhura nga subjektet private sipas kerkesave te bera nga vate kjo drejtori. *Ndersa ne krenit II*



REPUBLIKA E ALBANIËS MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT DHE RREZET E TRANSPORTIT PËR RUGË

pika 2 të VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e Prokurimit Public" përcaktohen si alternative edhe cimitet e tregut, por nuk përcaktohen se në llogaritjen e vlerës limit meren për bazë cimitet mesatare të tregut apo cimi me i ulët i tregut.

Nisur nga ky vakum ligjor, DPSHTRR me shresën 48800, datë 18.08.2006 i ka kërkuar mendim Agjencisë së Prokurimit Publik për argumentimin e vlerës limit të kontratës. APP me shkresën nr.13170/1 i kthen përgjigje se: "duhet referoheni testimit të tregut duke patur parasysh mesataren e ofertave që kompanit ofrojnë për objektet e prokurimit".

Pra, për llogaritjen e vlerës limit të kontratave nuk është bërë në bazë të cimeve me të ulta të tregut por të cimeve mesatare të tregut. Kjo mënyrë llogaritje mund të lere hapsira për spekulime pasi mesatarja mund të dalë nga një numër i vogël ofertuesish të cilat mund të paraqesin cime të larta e për pasojë vlerat e kontratave rriten efektivisht.

Për të konkretizuar këtë mjafton të japim një shembull, përkisht të tenderit me negociim për blerjen e prokatit të targave në sasi të vogla të tenderat e tjere, por që cimet janë të njëjta por të gjitha tenderat e realizuar gjatë vitit 2010-2011, konkretisht:

Llogaritja e fondit limit për prokatit të targave në bazë të testimit të tregut të tre ofertave të marra dhe të cimeve mesatare të tyre:

Emertimi	Sasia / copë	Cimi mesat	Vlera e fondit limit të hedhur në tender	Cimi/OP UTAL	Vlera e ofertes	Cimi/ OP/ RS&M	Vlera e ofertes	OP. KIG.D D.SUL Cicope 569.14	Vlera e ofertes
Prokat targe (520 x 112 mm) me fushë të bardhë me shirit blu në anën e djathtë	36,000	489.57	17,311,320	401.68	14,450,480	472.78	17,020,530		20,453,040
Prokat targe (520 x 112 mm) me fushë të bardhë pa shirit blu në anën e djathtë	420	530.12	200,288	429.39	171,755	483.84	193,535	588.93	235,572
Prokat targe (520 x 112 mm) me fushë jeshile me shirit blu në anën e djathtë	3,000	561.19	1,683,570	567.9	1,703,100	505.96	1,517,880	609.71	1,829,130
Prokat targe (520 x 112 mm) me fushë të verdhë me shirit blu në anën e djathtë	600	545.49	327,294	484.79	290,874	522.55	313,330	629.11	377,466
Prokat targe (264 x 205 mm) me fushë të bardhë me shirit blu në anën e djathtë	600	513.14	314,004	484.79	290,874	492.14	295,281	593.08	353,848
Prokat targe (264 x 205 mm) me fushë të bardhë pa shirit blu në anën e djathtë	100	593.47	59,347	470.94	47,094	594.44	59,444	715.03	71,503
Prokat targe (264 x 205 mm) me fushë jeshile me shirit blu në anën e djathtë	100	568.25	66,825	509.45	63,945	633.14	63,314	762.14	76,214
Prokat targe (264 x 205 mm) me fushë të verdhë me shirit blu në anën e djathtë	30	772.51	38,626	526.34	26,317	807.35	40,366	593.85	42,192
Prokat targe (212 x 205 mm) me fushë të bardhë me shirit blu në anën e djathtë	3,000	462.48	1,387,290	429.39	1,288,170	434.08	1,302,240	523.8	1,571,400
Prokat targe (212 x 205 mm) me fushë të bardhë pa shirit blu në anën e djathtë	200	490.87	98,174	401.68	80,336	473.78	94,556	558.14	113,628
Prokat targe (130 x 115 mm) me fushë të bardhë	1,000	273.67	273,670	235.47	235,470	265.42	265,420	320.1	320,100



Ministria e Ekonomisë dhe Financës Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Shërbimeve Fiscales Të Përbashkëta të Tatimeve dhe Shërbimeve Fiscales

Shirit ngjyrosës i karaktereve me ngjyrë të zezë (R/D2710 – 305 mts)	60	24,13.89	1,448,393	18,698.85	1,121,931	24,385.54	1,463,132	29,335.27	1,760,116
Shirit ngjyrosës i karaktereve me ngjyrë të bardhë (R/D2710 – 305 mts)	5	26,190.95	132,455	30,472.2	152,361	22,256.64	111,283	26,744.01	133,720
Shirit ngjyrosës i karaktereve me ngjyrë blu (R/D2710 – 305 mts)	2	26,190.95	52,982	30,472.2	60,944	22,256.64	44,513	25,744.01	53,488
Shirit ngjyrosës i karaktereve me ngjyrë të kuqe (R/D2710 – 305 mts)	2	26,190.95	52,982	30,472.2	60,944	22,256.64	44,513	26,744.01	53,488
Totali pa TVSH			23,415,210		10,051,806		22,829,090		27,453,965
TVSH			4,689,044		4,010,379		4,565,818		5,490,781
			18,134,264		14,062,275		27,394,908		32,944,686

Sic shihet nga tabela e mesipërme, po te merreshin per baze cmimet me te ulta te tregut dhe ti krahasojme ato me cmimet mesatare do te kishim ulje te fondit limit ne vleren 4,071,989 leke. Po keshu edhe po te marrim per baze cmimet e ofertes se dyte dhe ti krahasojme ato me cmimet mesatare do te kishim perseri ulje te fondit limit ne vleren 739,356 leke. Per te perforcuar kete arsyetim, po te bejme nje llogaritje vetem per nje artikull qe ze peshen me te madhe te vleres se prokatit, me "permasat 520 x 112 mm, me fushë të bardhë, me shirit blu në anën e djathtë" qe jane blere gjate kesaj periudhe ne sasine totale prej 156,000 cope (ne dy tendera) mund te kishim nje kursim te fondeve 12 milion leke pa TVSH, pasi fondi limit i tyre eshte llogaritur me cmimin mesatar per 480.87 leke dhe ne total 75,015,720 leke pa TVSH (156,000 cope x 480.87 leke), ndersa po te llogaritej me cmimin me te ulet qe ishte 401.68 leke dhe ne total 62,662,080 leke pa TVSH (156,000cope x 401.68 leke) kemi nje difference prej 12,350 mije pa TVSH dhe me 14,824 mije leke.

4. Zbatimi i procedurave te prokurimit

Auditimi u krye per te gjitha procedurat e prokurimit te paraqitur me siper. Nga kontrolli i ushtruar nuk u konstatuan shkelje te rregullave te prokurimit publik.

Vlen te theksojme se ne te gjitha tenderat e me mesiperm kane dale fitues ofertat me vlere me te vogel ekonomike, por ka patur edhe raste te skualifikimit te disa operatoreve ekonomike te cilet kane paraqitur ofertat ekonomike me vlera me te ulta se fituesit. Me poshte per cdo rast po trajtojmë ne menyre analitike ligjshmerine e arsyeve te skualifikimit te ketyre operatoreve ekonomike:

4.1. "Blerje targa prokat per automjete dhe motomjete"

Nga auditimi u konstatua:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

TË DHËNA MBITENDERIN	KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE	NJËSIA E PROKURIMIT
Urdhër prokurimi nr 182 date 25/03/2010.	Rakip Duka Kryetar Isa Sinxhi Alma Haxhiu	Albana Gjazi Adefa Dauti Albana Mitani
Vlera e përllogaritur e kontratës 34.281.259,60 leke pa TVSH		
Procedura e Bazarit me mjete elektronike). Hapja e ofertave date 06.05.2010 Ora: 10.00		
Tender i anuluar		

Ne tender kane mare pjese 4 operatore ekonomik. KVO gjate shqyrtimit dhe vleresimit te ofertave te tyre konstatoi se 3 prej tyre nuk plotesonin kerkesat e dhena ne dokumentat e tenderit, konkretisht operatorit: "LANDEU", "ERICH UTSCHE AG" dhe "UTAL".



-Nga verifikimi ofertes ekonomike rezultoi qe : Ne Formularin e çmimit te ofertes ne piken 2 ka gabim aritmetik. Per kete KVO vendosi te mos beje korigjime per shkak se oferta e Operatorit Ekonomik "ERICH UTSCHE AG" shpallet e pavlefshme sipas percaktimeve te bera me siper.

3. Operatori ekonomik "UTAL"

Nga te dhenat e Regjistrimit kombetar gjyqesor te paraqitur nga ky Operator Ekonomik rezulton qe: 49 kuota zoterohen nga ortakut "ERICH UTSCHE AG", nderkohe qe Operatori ekonomik "ERICH UTSCHE AG" ka paraqitur oferte me vete per kete objekt prokurimi, ne kundershtim kjo me VKM nr. 1 date 10.01.2007 "Per rregullat e prokurimit publik", me te gjitha ndryshimet, Kreu V, pika 4/b/1 "Hapja dhe vleresimi i ofertave", ku citohet "Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdo lloj kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi." Kjo eshte ne kundershtim dhe me kërkesat e percaktuara ne Dokumentat e Tenderit, Shtojcën 2 "Formulari i deklarimit te ofertes", pika 8, ku citohet "Nuk do të marrim pjesë si ofertues me më shumë se një ofertë për këtë procedurë."

-Sigurimi i ofertes i paraqitur nga operatori Ekonomik mban datën 06.05.2010, nderkohe qe eshte i vlefshem deri me date 02.10.2010. Pas llogaritjes se diteve mbi afatin e vlefshmerise se ofertes rezulton qe : Afati i vlefshmerise se ofertes eshte per 149 dite, pra jo per 150 dite sic eshte percaktuar ne dokumentat e tenderit, ne kundershtim kjo me kërkesat e vendosura ne DT.

-Ne te gjitha dokumentacionin e perkthyer te paraqitur nga ky Operator Ekonomik dokumenti i perkthyer eshte sigluar nga perkthyesi Petrit Dollani , nderkohe qe ne Vertetimin e noterit vertetohet firma e perkthyeses Suela Ibraj (Gjergo).

U auditua ligjeshmëria e arsyeve te s'kualifikimit te 3 ketyre shoqerive dhe rezultuan se, skualifikimet jane bere ne perputhje me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik" dhe te dokumentave Standarte te Tenderit (DST), pasi siq eshte trajtuar me lart Operatoret Ekonomike nuk plotësojne nje pjese te mire te "Kriterëve te Pergjithshme te Pranim/kualifikimit" te kerkuara ne DST.

Ne kushtet e konkurrences minimale, pasi mbas skualifikimeve ka mbetur vetem nje operator ekonomik, titullari i Autoritetit Kontraktor ne zbatim te legjislacionit ne fuqi ka anuluar proceduren e prokurimit dhe me pas ka filluar edhe menjehere proceduren e prokurimit si me poshte:

4.2. "Blerje targa prokat per automjete"

Te dhëna të përgjithshme për tenderin:

TE DHËNA MBI TENDERIN	KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE	NJËSIA E PROKURIMIT
Udhëtar prokurimit nr. 494, date 20.10.2010	Rakip Drita Kryetar	Albana Gjuzi
Vlera e përfshirur e kontratës 87.813.043,95 lekë pa TVSH	Kastrut Qelajni	Jonida Caçuli
Procedura e hapur me mjete elektronike (Hapja e ofertave date 10.11.2010 ora 10.00)	Aleksander LLAZARI	Albana Mifari
Operatori ekonomik fitues, subjekti "RSM". Vlera 34,262,000 lekë, pa TVSH.	Isa Sinani	Andrea Kusta
Konsolidim pjesë 4 subjekte	Zenel Hysenbegasi	
Kualifikim 2 subjekte		
Skualifikim 2 subjekte		
Kontrata, me vlerë 101.114.430 lekë, me TVSH. Afati i lëvizimit te mallit: 60 dite		



Ne tender kanë marrë pjesë 4 operatore ekonomik. Janë skualifikuar dy operatore. Operatori ekonomik i shpallur fitues është "R.S.M" shpk me vlerë të ofertes 84,262,000 leke lekë, pa TVSH. Një nga operatorët e skualifikuar është edhe subjekti "ILVA ELEKTRIK" e cila e ka oferten 72,842,000 leke ose me të vogël se fituese operatori "R.S.M" me diferencë prej 11,420,000 leke pa TVSH.

KVO e ka skualifikuar këte operatore për keto arsye:

Operatori Ekonomik është paraqitur për këtë procedurë prokurimi si bashkim Operatoresh Ekonomike me Subjektin "Yiwu Fuwong Traffic Signs Co.Ltd". Sipas Prokures së paraqitur nga Operatori Ekonomik "Ilva Elektrik, rezulton që:

- Prokura është paraqitur vetëm dokumenti i perkthyer, mungon dokumenti origjinal. Nuk është e noterizuar si dhe nuk është percaktuar perfaqesuesi i grupit, perqindja e pjesëmarrjes si dhe sasia e mallrave konkrete për secilin anetar. Pra prokura është në kundërshtim me kërkesat e vendosura në DT, Kreu Pjesëmarrja dhe Kualifikimi pika 4 (Bashkimi i Operatoreve Ekonomike) pika 4.7; 4.8; 4.9) si dhe në kundërshtim me Shtojcën 7 të DT.

- Në zbatim të Ligjit të Prokurimit Publik si dhe sipas percaktimit të bërë në shtojcën 7 të DT secili anetar i grupit në rastin e bashkimit të Operatoreve Ekonomike duhet të dorëzojë dokumentacionin e percaktuar në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit.

- Operatori Ekonomik "Ilva Elektrik" ka paraqitur dokumentacionin në emrin e tij por për ortakun e tij (sipas prokures) "Yiwu Fuwong Traffic Signs Co.Ltd" nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit.

- Çertifikata e standartit cilesor ISO 9001: 2000 nuk i përket subjektit "Yiwu Fuwong Traffic Signs Co.Ltd" por është leshur në emër të një subjekti tjetër, në emër të Subjektit "CAGNAN FUWONG TECHNOLOGY CO.LTD".

- Çertifikata ISO e paraqitur është për projektimin dhe prodhimin e sinjaleve të trafikut pra jashtë objektit të prokurimit në kundërshtim me percaktimin e bërë në DT, Shtojca 7 pika 2 (Kriteret e vecanta të kualifikimit) pika B (Kapaciteti Teknik) pika 2/a që kërkohej për prodhimin e targave prokat të licencuara për automjete, e prodhuesit.

- Dokumenti i Çertifikates ISO është paraqitur dokumenti i perkthyer i pa noterizuar.

- I gjithë dokumentacioni i paraqitur nga ky Operator Ekonomik është dokumenti i perkthyer, mungon dokumenti origjinal.

- Sigurimi i ofertes nuk specifikon pjesëmarrjen si bashkim të Operatoreve Ekonomike.

- Deklarata për konflikt interesi është paraqitur nga Operatori Ekonomik "Ilva Elektrik", mungon deklarata për konflikt interesi, për Ortakun, për Operatorin Ekonomik "Yiwu Fuwong Traffic Signs Co.Ltd".

- Persa i përket Kapacitetit Financiar

- Persa i përket kapacitetit Financiar është paraqitur xhiroja dhe çertifikata e gjendjes financiare vetëm nga Operatori Ekonomik "Ilva Elektrik", në kundërshtim me seksionin 4 të DT (Pjesëmarrja dhe Kualifikimi) Kreu (Bashkimi i Operatoreve Ekonomike) pika 4.9 pasi kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi i marrë së bashku në përputhje me perqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të percaktuar në akt marrëveshje.

- Persa i përket Kapacitetit Teknik

- Është paraqitur një Kontratë në gjuhë të huaj (anglisht) me nr RW080524- RW081202. Kontrata është e pavlefshme pasi është firmosur dhe vëlbosur vetëm nga një palë. Për kontratën me të njëjtin numer janë paraqitur dy perkthime me dy Bleresa të ndryshëm. Dokumentit të perkthyer i mungon noterizimi.



-Eshte paraqitur nje Kontrate vetem e perkthyer. Mungon Kontrata origjinale si dhe mungon noterizimi.Jane paraqitur disa Fatura shitje,te cilat nuk vertetojne realizimin e Kontrates .

-Nga Operatori Ekonomik jane paraqitur disa flete analiza : 2 flete analiza ne gjuhe te huaj, mungon perkthimi.2 flete analiza te pa firmosura, por te vulosura .Per flete analizat jane paraqitur disa Vertetime noterizimi si me poshte :

-Vertetimi nr 3506, date 27.11.2010 eshte paraqitur 5 (pese) here

-Vertetimi nr 3507 , date 27.11.2010 eshte paraqitur 2 here

Persa i perket mostrave te paraqitura : Mostrat e paraqitura nuk jane ne perputhje me specifikimet teknike te percaktuara ne DT , pika 8 dhe 10.

Persa i perket mostrave te shiritave: Ne daten e hapjes se tenderit nuk jane paraqitur nga Operatori Ekonomik por me shkresen nr 18 prot, date 30.11.2010 , protokolluar me tonen nr 8292 prot, date 01.12.2010 , Operatori Ekonomik "Ilva Elektrik" deklaroi qe do te paraqese shiritat ngjyroses brenda dates 01.12.2010.KVO-ja pasi mori ne konsiderate deklaraten e ketij Subjekti , hapi zarfin per te marre mostrat me shiritat, konstatoi qe : Nuk jane 4 modelet e shiritave te kerkuar ne DT por Adeziv ngjites te cilat gjithashtu nuk permbajne elemente sigurie.

U auditua ligjeshmeria e arsyeve te s'kualifikimit te shoqerise se mosiperme dhe rezultoi se: skualifikimi i ketij subjekti eshte bere ne perputhje me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik" dhe te dokumentave Standarte te Tenderit (DST), pasi shoqeria nuk ploteson nje pjese te mire te, "Kerkesave te Pergjithshme dhe specifike per kualifikimit" si dhe specifikimet teknike te dhena ne DST.

4.3. "Automatizim i Aktivitetit te DPSHTRR"

Te dhëna të përgjithshme për tenderin:

TE DHËNA MBI TENDERIN	KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE	NJESIA E PROKURIMIT
Udhëer prokurimi nr 164 date 19.03.2010.	Kozeta Gina Kryetare	Albana Gjuz
Vlera e përlogaritur e kontratës 66.250.000 lekë pa TVSH	Besnik La'uj,	Ajela Dasi
Procedura e hapur me mjete elektronike Hapja e ofertave date 13.05 2010 ora 10.00	Zamir Hoxha	Albana Miftari
Operatori ekonomik fitues, subjekti "IFOSFT SYSTEMS me vlore 61,728,850 lekë" leke, pa TVSH.	Zerai Hyasbegasi	Rudenc Binguri
Kane marre pjese 5 subjekte	Eugen Nasufi	Ermina Kulla
Kualifikuar 2 subjekte Skualifikuar 3		
Kontrata, me vlore leke,74.074.620 me TVSH Aftu i zbatimit te kontrates 6(gjashet) meaj .		

Ne tender kane marre pjese 5 peratore. Jane skualifikuar 3 operatore. Fitues i tenderit ka dale shoqeria "IFOSFT SYSTEMS" sha me vlore oferte 61,728,850 lekë. Nje nga tre operatoret ekonomik te skualifikuar pikerisht operatori "Sinteza CO &Programme Shqip"e ka oferten ne vleren 59,916,711 leke ose me te vogel se fituesi ne vleren 1,812,139 leke pa TVSH.

Skualifikimi i ketij operatori eshte bere pas shqyrtimit te procedures nga Komisioni i Prokurimit Publik me Vendim nr 165/4 prot, date 20.07.2010, Vendim ku eshte vendosur te behet Rivleresimi i Procedures se Prokurimit .



Skualifikimi është bërë pas rishqyrtimit pas kthimit të procedurës për Rivleresim nga KPP-ja për keto arsye:

- Marrveshja e bashkepunimit nuk është shoqëruar me sasinë e mallrave konkrete që duhet të furnizojë çdo anëtar i këtij bashkimi. Kontrata e Bashkepunimit e paraqitur nga ky operator Ekonomik nr 1199 dhe nr 113 është hartuar para noterit me datë 13.05.2010. Në këtë akt marrveshje është shprehur në mënyrë të përgjithshme se shoqëria "Sinteza Co" do të kryejë furnizimin dhe konfigurimin e pajisjeve software, ndërsa shoqëria "Programe Shqip" do të kryejë furnizimin dhe implementimin e pajisjeve software, duke mospërcaktuar elementet konkrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi operatorësh ekonomike në kundërshtim me Kërkuesin VII, pikë 2 /b) Bashkimi i Operatorëve Ekonomike të VKM nr 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik".

- Në marrveshjen e bashkepunimit është përcaktuar që pjesëmarrja në këtë procedurë prokurimi do të jetë e ndarë në 50% me 50 %, ndërsa në formularin e cënimit të ofertës në mospërputhje me kontratën e bashkepunimit, konstatohet një raport përqindje i ndryshëm nga ai i sipërpermendur. Nga llogaritjet që u bënë në formularin e cënimit të ofertës, rezultoi që shoqëria "Sinteza Co" do të realizojë 53.2 % të kontratës, ndërsa Shoqëria "Programe Shqip" do të realizojë 46.8 % të kontratës.

- Pas rishqyrtimit të ofertës së paraqitur nga ky bashkim Operatorësh Ekonomike konstatohet se: Shoqëria "Programe Shqip" nuk ka paraqitur Çertifikatë bankare dhe si pasojë nuk përmbushet Kapaciteti Financiar pikë 2 " Kërkesat e Vecanta për kualifikim " të DT. Shoqëria "Programe Shqip" shpik ka paraqitur vertetimin nr 37/4789, datë 09.04.2010, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilin është deklaruar xhiroja vetëm për vitin 2009 në kundërshtim me kërkesat e vecanta për kualifikim. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arrin në këtë konkluzion duke marrë për bazë dhe përcaktimin e bërë në Kërkuesin VII, pikë 2/c të VKM -- se nr 1, datë 10.01.2007 " Për rregullat e Prokurimit Publik " me të gjitha ndryshimet.

- Pas rishqyrtimit të specifikimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i Operatorëve Ekonomike konstatohet se: Specifikimet teknike nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në njoftimin e Kontratës dhe në DT.

Në këtë kusht duke iu referuar dhe konstatimit të bërë nga KPP-ja mbi ofertën e këtij Operatori Ekonomik Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të konsiderojë të pavlefshme ofertën e bashkimit të Operatorëve Ekonomik "Sinteza & Programe Shqip".

Sic shihet, shoqëria e mesipërme nuk plotëson një pjesë të mirë të, "Kërkesave të Përgjithshme dhe të "Kritereve specifike të kualifikimit" të dhëna në DST e për pasojë skualifikimi i tij është bërë në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" dhe të dokumentave Standarte të Tenderit (DST).

4.4. "Blerje uniforma për kontrollorët rrugor".

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

TË DHËNA MBI TENDERIN	KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE	NJËSIA E PROKURIMIT
Urdhër prokurimi nr. 225, datë 21.01.2011	Rasip Daka Kryetar	Albana Gjuzi
Vlera e përllogaritur e kontratës 6.130.000 lekë pa TVSH	Lavderim Hahli	Adela Duri
Procedurë e "Raport" Prokurim Elektronik Sipas ofertës date 02.06.2011 ora 10.00	Violeta Berishti	Jorida Cafuli
Operacion elektronik finies, subjekt "Gjigjesh". Vlera 5.816.000 lekë, pa TVSH		Albana Miftari



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PË RGJITHSHMË TË SHËRB IMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR".

Kane marrë pjesë 4 subjekte		
Kualifikuar 2 subjekte Skualifikuar 2 subjekte		
Kontrata, me vlerë leke, 7.015.200 me TVSH. Afat i levizimit të mallit 40 ditë		

Ne tender kanë marrë pjesë 4 operatore ekonomik. Janë skualifikuar dy operatore. Operatori ekonomik i shpallur fitues "Gjegjefti" me vlerë të ofertes 5,846,000 leke. Një nga operatorët e skualifikuar është subjekti "ELAS" i cili ka oferten në vlerën 5,261,420 leke ose me të vogël se fituesi për 584,580 leke.

Skualifikimi i këtij operatori është bërë nga KVO për keto arsye:

- Operatori ekonomik nuk i plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit, shtojcën 7, kapitulli 2, "Kriteret e veçanta për kualifikim", pika 3/2/b, pasi ky operator nuk ka paraqitur Çertifikatën ISO 9001:2008.
 - Çertifikata ISO e paraqitur nga ky operator ekonomik i përket shoqërisë "ÇELIK KARDESLER TEKSTIL, SANAYI INSAAT", e cila është ISO 9001: 2000 (nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar ISO 9001:2008), e cila nuk është pjesëmarrëse në këtë prokurim, pasi nuk ka bërë bashkim shoqërie me operatorin ekonomik "ELAS" shpk.
 - Operatori ekonomik "ELAS" shpk ka marrë nga Shoqëria "ÇELIK KARDESLER TEKSTIL, SANAYI INSAAT" vertetim prodhuesi, i cili nuk garanton faklin për prodhimin me cilësi të mallit, objekt prokurimi.
 - Operatori ekonomik "ELAS" në dokumentat (Ekstartet) e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, në objektin e veprimtarisë së tij ka "Prodhimi i tregëtimit të artikujve me baze drusore, import-eksport të tregëtimit të artikujve të ndryshëm, industrial, ushqimor, konfeksione etj. Shërbim i tregëtimit të pajisjeve elektromekanike, elektroshtepiake. Tregëtimit të mirëmbajtje të linjave hidraulike, pajisje për zyra, të artikujve të kondicionimit të ventilitimit. Tregëtimit të mineralëve të produkteve të tyre, artikujve metalorë, tuba profile, çeliku dhe skrapëve të çelikut etj. Import-eksport të vajrave lubrifikante dhe nënprodukteve të nafës etj. të paketuara" dhe nuk ka objektin për prodhimin e veshjeve sikurse kërkohej në DT.
 - Operatori ekonomik nuk i plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit, shtojcën 7, kapitulli 2, "Kriteret e veçanta për kualifikim", pika 3/3/3 dhe 3/3/4, pasi ky operator nuk disponon robaqepsinë (sipas pikës 3/3/3) dhe Autoriteti Kontraktor nuk mund të bëjë inspektimin para nxjerrjes së operatorit fitues (sipas pikës 3/3/4).
 - Për sa me sipër ky operator nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në DT
- Sic shihet, shoqëria e mesipërme nuk plotëson një pjesë të mirë të, "Kërkesave të Përgjithshme dhe të "Kritereve specifike të kualifikimit" të dhëna në DST e për pasojë skualifikimi i është bërë në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" dhe të dokumentave Standarte të Tenderit (DST)

4.5. "Blerje prokat leje drejtimi"

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

TË DHËNA MBI TENDERIN	KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE	NJËSIA E PROKURIMIT
Undër prokurim nr. 37, datë 18.08.2010	Rekin Duka Kryetar	Adriana Gjazi
Vlera e përlogurit e kontratës 37.133.400 lekë pa TVSH	Dor Gjellësht	Jenilda Çeloli
Procedura e "Hapës". Prokurim Elektronik. Hapja e ofertave datë 29.09.2010 ora 10:00	Brunilda Hoxha	Albana Mitrov
Operatori ekonomik fitues, subjekti "ALLAMINYONIDA Nym"		



KOMITETI ELIMINUES I TENDERTË

REKURSI "ALLAMI NYOMDA NYRT" ME VLERE OFERTE 37, 121,500 LEKE PA TVSH. ESHTË SKUALIFIKUAR NE VLEREN 34,375,000 LEKE OSE ME TE ULET SE FITUESE ALLAMI NYOMDA NYRT, ME DIFERENCE 2,746,500 LEKE.

Vlera 37,121,500 leke (pa tvsh)		
Kane marre pjese 3 subjekte		
Kualifikuar 2 subjekte		
Skualifikuar 1 subjekte		
Kontrata, me vlerë 44,545,800 leke, me TVSH Afati i levrimit te mallrave 90 dite		

Ne tender kane marre pjese 3 operatore ekonomik . Operatori Ekonomik i shpallur fitues eshte "ALLAMI NYOMDA Nyrt" me vlerë oferte 37, 121,500 leke pa TVSH. Eshte skualifikuar operatori ekonomik "ALEAT" i cili ka oferten ekonomike ne vleren 34,375,000 leke ose me te ulet se fituese ALLAMI NYOMDA Nyrt, me difference 2,746,500 leke.

KVO e ka skualifikuar kete operator per keto arsye:

- Gjate kalimit te ofertes ne rruge elektronike te ketij Operatori Ekonomik eshte regjistruar si emer Subjekti, emri "ALEAT" Nga shqyrtimi rezulton se dokumentacioni i paraqitur nga ky ofertues nuk ka asnje lidhje me emertimin "ALEAT", por me emertimin "SAFRAN MORPHO".

• Persa i perket Specifikimeve teknike:

• Malli objekt prokurimi eshte prokat leje drejtimi .Specifikimet teknike te paraqitura nga ky Operator Ekonomik per kete objekt prokurimi jane per karte identifikimi dhe jo per mallia objekt prokurimi (prokat leje drejtimi).

• Persa i perket elementeve vizual te sigurise se patentes ne specifikimet teknike te paraqitura nga ky Operator Ekonomik, per sa eshte shprehur, nuk garanton prodhimin e kinegrames sipas percaktimeve ne specifikimet teknike te DT.

• Simboli i dyfishte AL i percaktuar ne specifikimet teknike te DT eshte ne pjesen e perparme .Ne oferten e ketij Operatori Ekonomik ky simbol paraqitet ne pjesen e mbrapme.

• Rezultatet e testimit te fortesise se kartes jane paraqitur ne gjuhe te huaj, nderkohe qe gjuha e ofertes e percaktuar ne DT eshte ne shqip.

• Per te gjitha pikat e mesiperme Operatorit Ekonomik iu kerkuan per te dhene sqarime ne rruge elektronike, te cilat nuk u dhane as ne rruge elektronike dhe as ne forme shkresore nga ky Operator Ekonomik.

• Persa i perket afatit te levrimit te mallit, ne DT eshte kerkuar qe levrimi i mallit objekt prokurimi te behet brenda 90 diteve nga data e nenshkrimit te Kontrates. Nga Operatori Ekonomik "ALEAT" ne kundërshtim me kërkesat e vendosura ne DT, ne formularin e çmimit te ofertes deklarohet qe levrimi i mallit behet:

- per formularet e lejes se drejtimit per nje periudhe 3 muaj, dhe per

- per prokatet plastike per nje periudhe prej 4 muajsh, nderkohe qe ne DT shtojca 9 (Sasia dhe Grafiku i levrimit) eshte percaktuar per te dy llojet e mallit afati i levrimit per periudhen 90 dite.

Nga auditimi u konstatua se, skualifikimi i ketij operatori eshte bere pasi nuk plotëson nje pjese te mire te, "Kërkesave te Përgjithshme dhe te "Kriterëve specifikë te kualifikimit" te dhena ne DST e per pasoje skualifikimi i eshte bere ne perputhje me ligjin nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik" dhe te dokumentave Standarte te Tenderit (DST). Per sa eshte trajtuar me siper eshte mbajtur aktverifikimi me punonjesit perkates te cilet nuk kane bere verejtje por e kane konfirmuar ate.

4.6. Ndertim i zyrave te reja, per Drejtorine Rajonale te Sherbimit te Transportit Rrugor, Tirane (DRSHTRR).

Nga auditimi u konstatua:



MINISTRI E TËRIT

BAJORT "PËRANOHJATA E ULJES JODE E KALORIT E LËNJES
NË SHËRBIMIN E TRANSPORTIT RUGOR."

Ndertimi i këtij objekti u bë i domosdoshëm për krijimin e ambjentëve të reja për zyra administrative dhe salla shërbimi për DRSHTRR Tirane.

Projekti i zbatimit dhe preventivi për godinën e re është hartuar në vitin 2005 nga studio e projektimit "D&C PARTNERS", me vlerë 60,725,629 leke me TVSH dhe në vitin 2007 ky preventiv është ripunuar duke j'u referuar çmimeve të zerave të punimeve të vitit 2006 nga Enti Kombëtar i Banesave dhe referencave të tregut shqiptar. Vlera e re e objektit "Godinë e Re,, u bë 73,205,996 leke me TVSH. Në objektet "Rruga Hyrese për në parqe,, "Rrethimi dhe ndricimi parqe,, "Asfaltim parqe dhe rruga hyrese,, janë preventivuar nga Znj. Etleva Danaj specialiste në Drejtorinë Ekonomike të DRSHTRR, Tirane. Vlera gjithsej e preventivuar e objektit u bë 98,057,353 leke me TVSH e cila ka shërbyer si fond limit i tenderit.

Objekti është pajisur me leje shesh ndertimi miratuar me vendim Nr.3, datë 20.10.2007 të Komunes Kashar me sipërfaqe 7918 m2, me leje ndertimi miratuar me vendim Nr.3 datë 20.10.2007 të Komunes Kashar me emërtim objekti "Godinë administrative të DPSHTRR Tirane,, Certificate pronësie në zonën kadastrale Nr.2105, me numër pasurie 1184/6, lloji i pasurisë "toke are,, me sipërfaqe totale 7918 m2.

Tenderi është zhvilluar në vitin 2007 dhe operatori fitues është shpallur shoqëria "BAMI,, e cila ka lidhur kontratën e sipërmartjes me datë 27.07.2007 me vlerë 76,576,627 leke me TVSH, me afat përfundimi 12 muaj.

Zerat e punimeve sipas preventivit fitues paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Njesia	Preventivi baze	Vlera e ofertes	Fondi rezerve	TVSH	Shuma e ofertes
0	1	2	3	4	5	6	7=(4+5+6)
1	Godina administrative	leke					
a	Punime ndertimore	leke	57609348	39.490.361	394.806	7.977.093	47.862.560
b	Punime hysanfare	leke	2298363	1.314.523	9.695	193.844	1.520.064
c	Punime elektrike	leke	3551602	4.046.105	26.199	529.221	4.601.525
d	Punime ngrohje	leke	9745781	2.360.390	14.401	290.878	2.655.669
	Shuma 1		73205996	47.211.581	445.701	8.993.036	56.649.318
2	Rruga hyrese në DR Tirane	leke	1292940	717.501	7.275	146.955	881.731
3	Asfaltim parqe & rruga hyrese	leke	17105727	11.275.896	112.759	2.277.731	13.666.336
4	Rrethim parqe & ndricimi	leke	6452690	4.486.120	44.861	906.196	5.437.177
	Shuma 2	leke	24351357	16.459.517	164.895	3.330.882	19.935.254
	Totali (1+2+3+4)	leke	98057353	63.701.098	610.096	12.323.918	76.635.112

Me amendamentin nr.3937 prot. datë 02.06.2008, firmosur nga Z.Kreshnik Bozho ish-Drejtor i Përgjithshëm i DPSHTRR, për arsye të moslirimit në kohë të sheshit të ndertimit, u bë shtyrje e afatit të përfundimit të punimeve edhe me 195 ditë të tjera. Afati i përfundimit të punimeve bëhet 30.11.2009.

Gjatë procesit të zbatimit të punimeve në objektin kryesor "Ndertimi i zyrave të reja" janë bërë ndryshime të projektit të zbatimit që lidhen e sistemin e ngrohje - ftohjes. Sipas projektit fillestar të hartuar nga studioja e projektimit "D&C PARTNERS,, ngrohja e ambjentëve ishte parashikuar me sistem kalldaje uji 150 kw,gize,10 bar dhe ftohja e ambjentëve me Chiller 200kw.

Në zgjidhjen e re që j'u dha për zbatim, u konkludua për instalimin e një chilleri 200 kw tip ngrohje - ftohje dhe i instaluar në ambjentet e jashtme të godinës. Kjo zgjidhje nxorri jashtë funksionit sipërfaqen e bodrumit ku ishte parashikuar për t'u instaluar kalldaja, chilleri dhe dy



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT I PËRFAJQIMIT DHE MËTODAVE NË ZBATIMIN E PËRSHKËTIMIT
TE SHËRBIMEVE NË TRANSPORTIN RRUOR.

rezervuare uji dhe naftë me kapacitet 5000 litra secili. Largimi nga ky variant nxorri jashtë funksionit 257.46 m² sipërfaqe bodrumi dhe investimi i kryer për të në shumën 2,350,000 leke me TVSH rezultoi pa efektivitet të plotë.

Gjatë procesit të zbatimit, si pasojë e ndryshimeve të detyruara të vëllimeve të preventivuar të llogaritura gabim dhe për shkak të ndryshimit të sistemit të ngrohje-ftohjes është bërë shtesë kontratë me nr.4960, datë 16.7.2010, me vlerë 9,826,960 leke. Situacioni përfundimtar është në vlerën 86,126,248 leke me TVSH.

Nga auditimi i kryer mbi dokumentacionin teknik të zbatimit dhe verifikimet e punimeve në objekt nuk rezultuan probleme. Objekti është përfunduar, marrë në dorezim dhe është vënë në shfrytëzim. Por u vërejt se, për ndërtimin e këtij objekti investitori nuk i ka dhënë zgjidhje qysh në fazën e parë kompletimit të projektit të zbatimit me të gjitha nën objektet e nevojshme për t'a vënë atë në shfrytëzim. Për pasojë gjatë viteve 2009,2010 dhe 2011 janë parashikuar fonde dhe janë kryer blerje me vlera të vogla në shumën totale 4,369,200 leke me TVSH, konkretisht:

Në vitin 2009:

- Mbulimi me karton xhës i tavaneve të godinës në vlerën 477,000 leke TVSH.

Në vitin 2010

-Blerje prizat për në vlerën 450,000 leke me TVSH.

-Central telefonik në vlerën 462,000 leke me TVSH.

-Sistem kamera në vlerën 448,800 leke me TVSH.

- Pach panele, kablllo etj, në vlerën 358,800 leke me TVSH.

-Shpim gjeologjik (pus uji) në vlerën 480,000 leke me TVSH.

- Mbjellje pemë në vlerën 477,600 leke me TVSH.

Në vitin 2011:

-Rrjeti i brendshëm për taksat me vlerë 169,200 leke me TVSH.

-Sistemi i arshives së drejtimit të mjeteve me vlerë 480,000 leke me TVSH.

-Aksesore për lidhjen e sistemit me vlerë 470,400 leke me TVSH.

- Mbjellje pemë në vlerën 410,400 leke me TVSH.

Sic shihet, këto blerje janë bërë me procedura të thjeshtuara "Blerje me vlerë të vogël" të ndara në tre vite buxhetore, dhe në çdo rast nuk është treguar vlera limit prej 480 mijë leke me TVSH. Por, meqenëse këto objekte janë pjesë e godinës së re dhe përfshihen të gjitha në vlerën totale të kësaj godine; DPSHTRR duhet të parashikonte që në projektin fillestar të zbatimit dhe të përfshihinte si zëra të preventivit të zbatimit të tenderin për ndërtimin të godinës.

4.7. "Instalime elektrike në gabine në rrjetin e jashtëm dhe gjenerator për zyrat e reja të DRSHTRR, Tiranë"

Nga auditimi u konstatua:

Projekti i zbatimit dhe preventivi për objektin "Instalime elektrike në gabine në rrjetin e jashtëm dhe gjenerator për zyrat e reja të DRSHTRR, Tiranë", është hartuar në vitin 2009 nga ing. Rasin MAJKO me vlerë të preventivuar 7,176,403 leke pa TVSH. Në këtë vlerë nuk është parashikuar

vlera e TVSH-së për makineritë dhe pajisjet teknologjike. Por mbase dorezimit të projektit dhe preventivit të zbatimit, preventivi është rishikuar nga drejtoria ekonomike dhe me pas është hedhur në tender. Rishikimi i preventivit është bërë nga Ing. Etleva Danaj duke shtuar edhe 20 % vlerën e TVSH-së për makineritë dhe pajisjet teknologjike.



KONTROLLI I LARTË I QYTIMIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E SHTETDORIT DREJTORIAL TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RUGOR"

Projekti i hartuar siguron furnizimin me energji elektrike të instaluar 250 KVA duke marrë energjinë nga Fidri 20 kv F7 i n/stacionit Kashar. Pjesë përberëse e projektit të zbatimit janë: një transformator fuqie 250 KVA, dy bokse linje (cela) T.M. 24 KV 200 A, një boks transformatori T.M.24 KV 200 A, një panel tip Bi-Ti me dy automat 250 A, një panel matje me TRI 500/5A dhe një gjenerator 250 KVA 380 V.

Pas realizimit të tenderit gjatë vitit 2009 operator fitues u shpall shoqëria "Vila" sh.p.k. me vlerën e ofertes 5,800,000 leke pa TVSH dhe ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me datë 20.01.2010 me vlerë 6,960,000 leke me TVSH, firmosur nga Z. Kreshnik Bozo, ish Drejtor i Përgjithshëm i DPSHTRR- Titane.

Objekti ka përfunduar me datë 14.02.2010 dhe me datë 21.06.2010 është hartuar proces verbal i kollaudit firmosur nga mbikëqyesi i punimeve Z.Vangjush Lubonja dhe kolaudatori Z.Gani Gjini.Vlera e situacionit përfundimtar është 5,798,410 leke pa TVSH dhe 6,958,092 leke me TVSH.Afati garancisë së punimeve është përcaktuar 24 muaj pas datës së përfundimit të punimeve.

Në preventivin e ofertes të paraqitur nga shoqëria "Vila" sh.p.k. është aplikuar përqindja e TVSH-se edhe për makineritë e paisjet elektrike në vlerën 886,000 leke.

Në llogaritjet preventive që lidhen me TVSH-ne është aplikuar një standart llogaritjeje ndryshe nga objektet e tjera. Kështu në objektin "Godina e Re për DRSHTRR, në preventivin e operatorit fitues, mbi vlerën e makinerive e paisjeve teknologjike nuk është aplikuar TVSH, ndërsa është aplikuar vetëm mbi punimet e montimit dhe aksesoreve të nevojshëm për montimin e makinerive.

Menyra e llogaritjes është reflektuar edhe në situacionimin dhe financimin e punimeve. Shoqëria "Vila" sh.p.k. ka llogaritur mbi vlerën e makinerive e paisjeve 806,830 leke, ndërsa nuk duhej të kishte llogaritur, situacionuar dhe financuar këto vlera.

Sa sipër është rritur fiktivisht kosto e këtij objekti në vlerën 806,830 leke TVSH

Llogaritja e TVSH-se për makineritë dhe paisjet teknologjike është në kundërshtim me UKM Nr.2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit,, (shembull llogaritjeje nr.2)

Mban përgjegjësi specialistia e investimeve në Drejtorinë Ekonomike znj.Etleva Danaj.

U shqyrtuan observacionet e paraqitura nga znj.Etleva Danaj dhe merren në konsideratë pjesërisht, vetëm pjesa që përket ndarjes së përgjegjësisë, pasi TVSH është parashikuar fillimisht që në preventivin e zbatimit të përgatitur nga projektuesi. Drejtoria Ekonomike duhej t'a rishikonte këtë preventiv dhe të hiqte vlerën e TVSH -se.

4.8. Auditimi në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë.

Auditimi u ushtrua vetëm për zbatimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratës për blerjen e paisjeve për mobilimin e zyrave të reja të kësaj Drejtorie.

Nga auditimi u konstatua:

Në përfundim të ndërtimit të godinës së re të DRSHTRR, me kërkesë të kësaj drejtorie: detyrën e projektimit, preventivin, fondin limit, specifikimet teknike dhe skicat për mobilimin e kësaj godine, e ka përgatitur dhe dorëzuar në datën 19.05.2009 subjekti privat shoqëria "Sportiva

sh.p.k", përfaqësuar nga arkitekt Gentian Parruca. Për këtë punë kjo shoqëri është paguar në bazë të fakturës tatimore të shitjes të datës 30.09.2009, me vlerë 470,012 leke me TVSH.



KONTROLI I LARTË TË TENDERIT

RAPORTI MË RAUNTIMIN E QËRTUAR NË DREKTORIN E PËRKOMUNIKIMIT
TË LIDHJEVE TË TRANSPORTIT DROGOS

Ne baze të këtij dokumentacioni është zhvilluar procedura e prokurimit në datën 13.08.2009, si me poshtë:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

TË DHËNA MBI TENDERIN	KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE	NJËSIA E PROKURIMIT
Udhëzr prokurimi 2400, datë 08.07.2009	Andrea Kusta Avni Tobli Lorenc Tandili Fajon Fusha Endrit Milla	Ardita Bezoli Sashenka Zefi Eris Cibaku
Vlera e përlogaritur e kontratës 19,013,280 lekë pa TVSH		
Procedura e hapur elektronike. Hapja e ofertave datë 13.08.2009, ora 11.00		
Tenderi i anuluar		

Ne tender kanë marrë pjesë 11 operatore ekonomikw. Pas shqyrtimit të ofertave teknike KVO ka kualifikuar 2 operatore ekonomikw dhe ka skualifikuar 9 të tjerat. Skualifikimi i tyre është bërë pasi nuk kanë plotësuar një nga kriteret e përcaktuara në shtojcën 5, "kriteret e veçanta", pikërisht sepse nuk kanë paraqitur një dokument që vërteton se materialet e ofruara do të jenë anti-zjarr (shkalla e proves 11M), kerkese kjo e cila duhej të shoqërohej me një certifikatë të lëshuar nga vendi i origjinës (prodhuesi).

Disa nga këta operatore kanë bërë ankesa në: Autoritetin Kontraktor, Avokatin e Prokurimeve dhe në Agjencinë e Prokurimit Publik, për skualifikim të padrejtë të tyre.

Pas korrespondencave të ndërsjellëta për shqyrtimin e këtyre ankesave midis operatorëve ekonomikw dhe këtyre institucioneve, Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr 11121/3, datë 22.09.2009 ka dalë me këtë përfundim duke i kthyer këtë përgjigje Autoritetit Kontraktor: "pas riparimit të një defekti teknik që ka ndodhur në sistemin elektronik në faqen zyrtare të APP nuk gjendet asnjë ofertë e paraqitur dhe pasoja e kësaj të çon detyruesisht në anulimin e procedurës dhe shpalljen nga e para të këtij objekti prokurimi".

Në keto kushte, Titullari i Autoritetit Kontraktor anuloi procedurën e prokurimit dhe e rifilloi atë nga e para në datën 13.11.2009, si me poshtë:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

TË DHËNA MBI TENDERIN	KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE	NJËSIA E PROKURIMIT
Udhëzr 3284, datë 13.10.2009	Albert Naxha Avni Tobli Lorenc Tandili Vijar Cekici Endrit Milla	Ardita Bezoli Sashenka Zefi Eris Cibaku
Vlera e përlogaritur e kontratës 19,013,280 lekë pa TVSH		
Procedura e hapur elektronike. Hapja e ofertave datë 13.11.2009, ora 11.00		
Tenderi i anuluar		

Ne tender kanë marrë pjesë 5 operatore ekonomikw. Pas shqyrtimit të ofertave teknike, KVO ka kualifikuar 1 operator ekonomik dhe ka skualifikuar 4 të tjerat. Skualifikimi i tyre është bërë

pasi nuk kanë paraqitur një dokument që vërteton se materialet e ofruara do të jenë anti-zjarr (shkalla e proves 11M), kerkese kjo e kerkuar në shtojcën 5, "Kriteret e Veçanta" të DST.



MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

REPUBLIKA E ALBANIËS
MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

KVO, nisur nga mungesa e konkurrences pasi mbeti vetem një ofertë e vlefshme, i ka kërkuar Titullarit të Autoritetit Kontraktor anulimin e tenderit.

Ne kështu, Titullari i Autoritetit Kontraktor anuloi procedurën e prokurimit dhe dhe e rifilloi atë nga e para në datën 20.01.2010, si më poshtë:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:

TË DHËNA MBI TENDERIN	KOMISIONI VLERËSIMIT TË OFERTAVE	NJËSIA E PROKURIMIT
Urdhër 3936, datë 16.12.2009	Eduart Gjermazi Avni Tobli Gjovalin Sula Visar Cekici Albert Xhaxha	Ardita Becoll Sathenka Zefi Bris Cibuku
Vlera e përlogaritur e kontratës 19,013,280 leke pa TVSH		
Procedura e hapur elektronike. Hapja e ofertave datë 20.01.2010, ora 11:00		
Tenderi i anuluar		

Në tender kanë marrë pjesë 11 operatore ekonomikë. Pas shqyrtimit të ofertave teknike KVO ka kualifikuar 3 operatore ekonomikë dhe ka skualifikuar 8 të tjerat. Skualifikimi i tyre është bërë për shkak të faktit që në dy tenderat e mësipërm të anuluar, përkishte se nuk kanë paraqitur një dokument që verteton se materialet e ofrura do të jenë anti-zjarr (shkalla e provës IIM), e kërkuar në shtojcën 5, "Kriteret e Vecanta" të DST.

Si përfundim KVO shpalli të vlefshëm tre operatorët: "MUCA" me vlerë ofertë 16,178,100 leke, "A.P.G" me vlerë ofertë 17,850,000 leke dhe "M.LEZHA" me vlerë ofertë 18,400,000 leke dhe fituesin e operatorit ekonomik me vlerë më të vogël "MUCA".

Duhet theksuar se, 2 (dy) nga 8 (tete) operatorët e skualifikuar kanë paraqitur në tender oferta ekonomike me të ulta se operatorin fitues, përkishte operatorët: "BOLT" me vlerë 11,028,600 leke me TVSH, dhe "EMKO" me vlerë 13,820,000 leke.

Në datën 12.02.2010 operatori "EMKO" ka paraqitur ankese në Autoritetin Kontraktor për skualifikim të padrejtë, për të cilën i është kthyer përgjigje se skualifikimi është bërë në përputhje me ligjin. Me pas ky operator paraqet ankesën në APP. Në datën 21.05.2010, APP vendosi të mos marrë parasysh ankesën e këtij operatori.

Në datën 15.02.2010 Operatori i skualifikuar për arsyen e mësipërme "Ilar&C-Porti" ka paraqitur ankese në Autoritetin Kontraktor për skualifikim të padrejtë, për të cilën i është kthyer përgjigje se skualifikimi është bërë me të drejtë. Me pas paraqet ankesën në APP e cila në datën 21.05.2010 vendosi të mos marrë parasysh ankesën e këtij operatori.

Po kështu edhe operatori i kualifikuar "A.P.G" bëri ankese pranë Autoritetit Kontraktor duke kërkuar skualifikimin e operatorit fitues "MUCA" pasi ka marrë pjesë në dokumentacionin e ofertes teknike. Autoriteti Kontraktor i kthen përgjigje se ankesa e tij nuk qëndron. Ky operator paraqet ankesën edhe në Komisionin e Prokurimit Publik. Në datën 21.05.2010, KPP urdheroi Autoritetin Kontraktor të rishqyrtojë procedurën duke skualifikuar si operatorin fitues "MUCA" ashtu edhe operatorin "A.P.G".

Në kushtet e skualifikimit të dy operatorëve nuk sigurohet konkurrenca minimale. TAK anuloi për shkak të kësaj proceduren e prokurimit.



Si konkluzion: Njësia e Hartimit të Dokumentave të tenderave përvec kërkesave të përgjithshme për kualifikim të përcaktuara sipas nenit 45 dhe 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ka vendosur në shtojcen 5, "Kritereve të vecanta" të DST edhe disa kërkesa specifike për tu plotësuar nga kandidatët ofertues. Vecanërisht një nga keto këto kërkesa është që: "Materialet e mobilimit duhet të jenë anti-zjarr (shkalla e proves IIM)" dhe për të vertetuar kete, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një certifikate të lëshuar nga vendi i origjines (prodhuesi).

Vendosja e kësaj kërkesë është e paargumentuar ligjërisht dhe diskriminuese ndaj operatorëve ekonomikë, pasi kjo kërkesë ka lënë hapësirë që KVO gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave teknike të skualifikojë në mënyrë subjektive disa operatorë ekonomikë të cilët kanë paraqitur ofertat më të vogla ekonomike. Dhe, pikerisht skualifikimet janë bërë për shkak të mospermblidhjes së kësaj kërkesë, duke e çuar kështu numurin e operatorëve ekonomikë në konkurrencë minimale, me pasojë anulimin disa here të procedurave të prokurimit.

Pra, shkak i deshtimit të tre procedurave të mesiperme është vendosja e kësaj kërkesë specifike për kualifikim në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik".

Përgjegjësi mbajnë anëtarët e komisioneve të hartimit të dokumentave të tre tenderave: znj. Ardita Becolli, znj. Eris Cibuku dhe znj. Sashenka Zefi.

Nuk u paraqiten observacionet nga anëtarëve të komisionit të hartimit të dokumentave për projektraportin e kontrollit.

Pas deshtimit të se tretës here të këtij tenderi doli e nevojshme rishikimi i specifikimeve teknike si dhe rikompozimi edhe njëherë i mobilimit të zyrave të kësaj drejtorie. Në keto kushte, detyra e projektimit, preventivi, fondi limit, specifikimet teknike dhe skicat, të përgatitur me pare nga subjekti privat shoqëria "Sportiva" me vlerë 470,012 leke, dolën të papërdorshme dhe nuk kanë gjetur zbatim. Nga ky veprim i është shkaktuar buxheti të kësaj ndërmarrjeje dem ekonomik në keto vlerë, pasi kjo punë është paguar dy here, konkretisht:

Detyra e projektimit, preventivi, fondi limit, specifikimet teknike dhe skicat për mobilimin e zyrave, ju ngarkuan dhe njëherë tjetër për t'u përgatitur nga fillimi personit fizik arkitekt Genci Bregu, i cili i dorëzoi kete dokumentacion në datën 21.07.2010 dhe për kete shërbim është paguar në vlerën 202,500 leke.

Për kete shërbim ngarkohet me përgjegjësi ish-Drejtori Rajonal i Shërbimit të Transportit Rrugor Tirane z. Elez Gjoza.

U shqyrtuan observacionet e paraqitura nga ish-Drejtori Rajonal i Shërbimit të Transportit Rrugor Tirane z. Elez Gjoza të protokolluar në KLSH në datën 11.06.2012. Keto observacione nuk merren në konsideratë, pasi nuk kanë mbështetje ligjore. Në to, vetëm sa bëhet teori për të justifikuar shkëlqen e trajtuar dhe nuk jepen argumenta ligjor apo dokumenta dhe prova të vëra shërkësore që të hedhen poshtë shkëlqet e konstatuara nga auditimi.

Pas kësaj në datën 09.09.2010 fituan perseri procedurat e tenderit si më poshtë:

Të dhëna të përgjithshme për tenderin:



KONTROLI I ANKESË TENDERIT

Udhëzimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në Prokurimet e Përbashkëta të Transportit Publik

TË DHËNA MBI TENDERIN	KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTAVE	NJËSIA E PROKURIMIT
Udhëzimi për prokurim 2693/1, datë 03.03.2010	Ediart Gjermani Adil Gjoni Gjevali Sela Ratim Allushi Adriatik Gjura	Ardita Becolli Sonila Neguri Visar Cekici
Vlera e përlogacitur e kontratës (2,136,646 lekë pa TVSH)		
Procedura e hapur elektronike. Hapja e ofertave datë 09.09.2010, ora 11.00		
Operatori ekonomik fitues, subjekti "A.P.G". Vlera 7,599,000 lekë, pa TVSH		
Paraqitur interes 9 operatorë ekonomik.		
Kualifikuar 7 operatorë ekonomik Kualifikuar 2 operatorë ekonomik		
Kontrata, me vlera 9,118,800 lekë, me TVSH		

Ne tender kanë marrë pjesë 9 subjekte. KVO pas shqyrtimit të ofertave me procesverbalin nr.4, datë 28.09.2010, i ka kualifikuar të 9 subjektet me këtë renditje: të parën subjektin "Erzeni" me ofertën ekonomike me të vogël në vlerën 5,322,5000 lekë, të dytin subjektin "HASANAGA" me vlerë ofertë 6,487,500 lekë, të tretin subjektin "M.LEZHA" me vlerë ofertë 6,679,800 lekë, të katërtin bashkimin e operatorëve "Shatro&BOLT" me vlerë ofertë 7,554,000 lekë, të pestin subjektin "A.P.G" me vlerë ofertë 7,599,000 lekë, e kështu me rradhë të gjitha subjektet e tjera.

Por, operatori ekonomik i renditur i dyti "HASANAGA", në datën 07.10.2010 ka paraqitur ankese pranë Autoritetit Kontraktor, pasi KVO nuk ka aplikuar në mënyrë korrekte formulën për përcaktimin e ofertave anomalisht të ulta në shkollë të nenit 56 të ligjit të prokurimit.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese, grupi i punës i ngritur nga TAK, ka datë me konkluzionin se ankuesi ka të drejtë pasi KVO ka shkelur ligjin e sipercituar. Pas kësaj, sipas procesverbalit nr.7, datë 14.10.2010, KVO ka rishqyrtuar ofertat ekonomike nga ku ka rezultuar se tre operatorët e parë "Erzeni", me ofertën ekonomike 5,322,5000 lekë, "HASANAGA" me ofertën ekonomike në vlerë 6,487,500 lekë, dhe "M.LEZHA" me ofertën ekonomike në vlerë 6,679,800 lekë, i kanë ofertat e të tyre anomalisht të ulta. Për këtë, sipas shkresave nr. 4414, datë 15.10.2010 të TAK, janë njoftuar këta operatorë që deri në orën 12.00 të datës 18.10.2010, të paraqesin shpjegime duke argumentuar analizat e qmimeve. Përveç këtij njoftimi nuk ka shenim që këta operatorë kanë konfirmuar marrjen e njoftimit apo ndonjë dokument tjetër si nënshkrim në librin e protokollit, konfirmim, dërgim faksi, e-mail, etj.

Sipas procesverbalit nr.8, datë 18.10.2010 të KVO, deri në orën 13.00 nuk ka ardhur asnjë shpjegim me shkrim apo në rrugë elektronike nga të tre këta operatorë. Për pasojë, KVO i ka skualifikuar të tre këta operatorë ekonomikë.

Por, ndodhur para këtij fakti, KVO brenda afatit të vlefshmerisë së ofertave duhej të bente konfiskimin e garancisë së ofertave, në përputhje me nenin 49, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe pikë "2", të kreu III të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit Publik", të cilat përcaktojnë qartë se: "Formulari i sigurimit të

ofertës shërben si masë mbrojtëse për autoritetin kontraktor, në rastet e tërheqjes së ofertave në mënyrë të njëanshme, pas hapjes së tyre apo refuzimit të nënshkrimit të kontratës".

Nga ky veprim i janë shkaktuar buxhetit të kësaj ndërmarrjeje të ardhura të munguara në vlerën totale 728,196 lekë. Kjo vlerë përfaqëson sigurimin e garancisë së ofertës në masën 2% mbi fondin limit për të tre ofertat e operatorëve të skualifikuar (12,136,646 x2 %x3).



Po kështu, sipas procesverbalit nr.8, date 18.10.2010, pas rishqyrtimit edhe njeherw te ofertave teknike, KVO ka skualifikuar edhe operatorin e katert "Shatro&BOLT" me vlerë oferte 7,554,000 leke. Skualifikimi i ketij operatori eshte bere pasi ne kontraten e bashkimit te kesaj shoqerie nuk eshte percaktuar objekti i prokurimit.

Per kete skualifikim, operatori ekonomik "Shatro&BOLT" ne daten 29.10.2010 ka paraqitur ankese ne Autoritetin Kontraktor i cili nuk i ka dhene te drejte dhe me pas ne daten 09. 11. 2010 ka paraqitur ankese ne Komisionin e Prokurimit Publik, i cili dhe ky nuk i ka dhene te drejte.

Ne vijim pas skualifikimit te te kater operatoreve te mesiperm, KVO sipas procesverbalit nr.9, date 20.10.10 rendit te parin Operatorin Ekonomik "A.P.G" me vlerwn 7,599,000 lekë, pa TVSH". Dhe, me procesverbalin nr.10, date 23.12.10, bën edhe njehere tjeter rivlerësim të ofertave nëse ka ndonjë oferte anomalisht të ulët, dhe perseri pas kesaj rezultoi se oferta ekonomike e operatorit "APG" shpk është pikerisht e tillë. Per kete, po në këtë procesverbal shënohet afati i përfundimtar i pranimit te shpjegimeve data 03.01.11 (14 ditë kalendrike apo 10 ditë pune). Shpjegimet janë sjellë nga operatori ekonomik APG më datë 14.01.11.

KVO, pasi i shqyrton, i merr te mirwqena dhe i konfirmon ato dhe bën renditjen përfundimtare të tyre, duke shpallur fitues operatorin ekonomik me vlerë oferte 7,599,000 lekë, pa TVSH.

Si konkluzion: nga krahasimi i ufatve të lëna për marrjen e shpjegimeve nga operatorët ekonomikë që rezultojnë me oferta anomalisht më të ulëta sipas procesverbalit nr. 7, date 14.10.2010 i cili ka percaktuar 3 dite dhe sipas procesverbalit 10, date 23.12.10, i cili ka percaktuar 10 dite, si dhe nga rishqyrtimi edhe njeherw i ofertes teknike te operatorit ekonomik "Shatro&BOLT, dalim ne perfundimn se:

Skualifikimi i operatorëve ekonomikw "Erzeni", "Hasanago", "M. Lezha" dhe "Shatro&BOLT" te cilet kane paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta ekonomike, e operatorit ekonomik "APG" shpk, eshte bere në kundërshtim me nenin 46 dhe 56 te ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 "Për prokurimin publik" dhe me Kreun V, pika 4, te VKM-në nr.1, dt.10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" të ndryshuar.

Pasoja e ketyre shkeljeve ka sjell rritje te koston se blerjeve e ketyre paisjeve ne vleren 2,276,500 leke qe perfageson diferencen e ofertes se operatorit ekonomik fitues "APG" me vleren e ofertes se operatorit "Erzeni", i cili ka paraqitur oferten me te ulet ne tender.

Vlen te theksojme se Sektori i Auditit te Brendshem i DPSHTRR, gjate muajit tetor 2010, ka ushtruar kontroll tematik vetem per proceduren e prokurimit te fundit dhe per zbatimin e kontrates. Grupi i auditit per problemet e konstatuara ne zbatimin e kontrates ka mbajtur procesverbal me komisionin e marrjes ne dorezim te paisjeve. Ne observacionet e paraqitura nga ky komision ne perberje te te cilit eshte edhe nje anetar i KVO, eshte thene qe parregullsite ne marrjen ne dorezim te paisjeve kane ardhur pasi 20% e mallit është lëvruar para përfundimit të procedurës së prokurimit.

Pra del e qarte se ky deponim perforcon edhe shkeljet e konstatuara nga kontrolli qe procedurat e prokurimit jane kryer formalisht dhe fituesi eshte parazgjedhur nga Autoriteti Kontraktor.

Përgjegjësi mbajne anetaret KVO: z. Eduart Gjermeni, z. Adil Gjoni, z. Gjovalin Sula, z. Rasim Allushi, z. Adriatik Gjura dhe z. Elez Gjoza me cilesine e ish-Titullarit te Autoritetit Kontraktor i cili ka pranuar dhe lejuar furnizimin e mallit para se te perfundonin procedurat e prokurimit.

Nuk u paraqiten observacione per projektraportin e kontrollit nga KVO, por jane paraqitur observacione per procesverbalin, nga shqyrtimi i te cilave jane marre ne konsiderate pjeserishte. Nuk eshte merrre ne konsiderate shkelja e nenit 49 te LPP, pasi operatoret ekonomik



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR".

kane terhequr ofertat ne nenvre te njehuneslme dhe dikej ti konfiskohej garancia e ofertave. Shkeljet e tjera pronohen nga KVO me pretendimin se jane gabime njerezore. Per keto shkelje, APP ka dhene masa, per te cilat KVO eshte ankuar dhe aktualisht eshte ne proces gjyqesor. Ndersa per shkeljen: "parazgjedhja e fituesit dhe kryerja formale e procedurave te prokurimit" te cilat vertetohet nga deponimet e dy anetareve te Komisionit te Marrjes ne Dorezim, njeri nga te cilet ka qene edhe anetar i vete KVO, pergjegjesia bie mbi z. Elez Gjoza ish-Titullarin e Autoritetit Kontraktor i cili ne daten daten 11.06.2012 ka protokoluar ne KLSH observacione per keto shkelje. Dhe pas shqyrtimit te tyre dofen ne konkluzionin se nuk merrren ne konsiderate, pasi ne to sic u tha edhe me larte vetem sa behet teori per te justifikuar shkeljen dhe nuk jepen argumenta ligjor apo dokumenta te tjera shikersore qe te hedhen poshte shkeljen e konstatuar. Me subjektin fitues "APG" ne daten 25.02.2011, eshte lidhur kontrata e furnizimit me vlere 9,118,800 leke me TVSH.

Me date 30.03.2011 eshte mbajtur procesverbali nga komisioni per marrjen ne dorezim te paisjeve. Sipas ketij procesverbali jane marre ne dorezim te gjitha paisjet ne perputhje me specifikimet teknike te materialeve te percaktuara ne dokumentat standarte te tenderit dhe ne kontraten e zbatimit me vlere 9,118,800 leke me TVSH.

Por nga kontrolli mbi sasite e furnizuara dhe cilesine e prodhimit te ketyre paisjeve u konstatuan keto mangesi :

- Sasite e Furnizuara:

Shoqeria sipermarrrese "APG" nuk ka sjelle 30 cope paisje te ndryshme nw vlere 820,560 leke me TVSH. Vlera e ketyre paisjeve eshte kompensuar me paisje te tjera te cilat nuk kane qene percaktuar ne dokumentet e tenderit dhe ne kontraten e zbatimit. Konkretisht keto mungesa paraqiten ne tabelen e me poshteme:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia sipas		Nifite	Cmimi	Vlera pa	TVSH	Vlera me
			Prevena.	Fakt	renca	njesi	TVSH	10%	TVSH
0	1	2	3	4	5=3-4	6	7=(5x6)	8	9=(7+8)

I. Prodhime me pak:

1	Abazhur tavoline	cope	1	0	1	6000	6000	1200	7200
2	Abazhur toke	cope	1	0	1	12000	12000	2400	14400
3	Dollap 180x40x202	cope	1	0	1	120000	120000	24000	144000
4	Dollap 90x45x202	cope	2	0	2	60000	120000	24000	144000
5	Karrige pune	cope	4	0	4	5700	22800	4560	27360
6	Kasaforte	cope	1	0	1	11000	11000	2200	13200
7	Minifrigj	cope	1	0	1	25000	25000	5000	30000
8	Raft 110x35x70	cope	2	1	1	9000	9000	1800	10800
9	Raft 120x35x110	cope	4	1	3	21000	63000	12600	75600
10	Raft 120x35x202	cope	2	1	1	48000	48000	9600	57600
11	Raft 30x25x120	cope	4	0	4	7000	28000	5600	33600
12	Raft 65x35x100	cope	4	0	4	11000	44000	8800	52800
13	Raft 90x35x202	cope	4	3	1	48000	48000	9600	57600
14	Set tavoline, kancelarie	cope	1	0	1	7000	7000	1400	8400
15	Tavoline pune 120x30 me kaseta	cope	3	0	3	39000	117000	23400	140400
	Shuma I				30				820560

- Cilesin e paisjeve:



KOMISIONI I TENDERTË

REKORTI I PËRFAJESIMIT DOKUMENTAR I DORËZIMIT DHE PËRVEKTIUT
TE ENJE BULISEVE TE TRANSPORTIT RUGOR.

- Në dollapet e prodhuar nuk është zbatuar kushti teknik ku specifikohet që këmbet plastike të jenë të fshehura me strukture druri melamine. Për të gjithë dollapet e prodhuar nuk janë vendosur 40 ml melamine me vlerë 70,000 leke.

- Ndarja e brendeshme të dollapeve nuk janë bere cdo 35 cm që i korespondojnë, sipas specifikimeve teknike, cdo dollap me lartësi 202 cm të ketë gjashtë ndarje me raftë. Në fakt të gjithë dollapet janë bere me katër ndarje. Për cdo dollap nuk janë vendosur dy raftë ose për 10 dollapet me dimensione (90x46x202) cm dhe për 6 dollapet me dimensione (180x46x202) cm nuk janë vendosur 44 raftë me sipërfaqe 11 m² melamine dhe me vlerë 77,000 leke. Nga mos zbatimi i këtij kushti teknik shoqëria A.P.G. sh.p.k. ka përfituar me tepër 176,400 leke me TVSH ($70,000 + 77,000 = 147,000 \text{ leke} + 20\% \text{ TVSH} = 176,400 \text{ leke}$).

-Jenë prodhuar gjithsej 58 cope tavolina me kasetiera me dimensione (120 x 80) cm me çmim 30,000 leke/cope. Për keto prodhime nuk është zbatuar kushti teknik që ato të jenë të pajisura me një sirtar me shina për vendosjen e tasierës së kompjuterit. Ky element mungon dhe i vlerësuar 2,000 leke/cope, rezultojnë se shoqëria "A.P.G." sh.p.k. ka përfituar 139,200 leke me TVSH me tepër ($58 \text{ cope} \times 2,000 \text{ leke/cope} = 116,000 \text{ leke} + 20\% \text{ TVSH} = 139,200 \text{ leke}$)
Sa sipër në total shoqëria "A.P.G." ka përfituar padrejtësisht duke i shkaktuar buxhetit të kesaj ndërmarrjeje dëm ekonomik në vlerën 385,600 leke.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me specifikimet teknike të materialeve të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit dhe në kontratën e zbatimit datë 25.02.2011.
Përgjegjësi mbajnë anëtarët e Komisionit të Marrjes në Dorezim të Pajisjeve: z. Rasim Allushi, z. Eris Cibuku dhe z. Edril Vuthi.

Nuk u paraqitën observacione për projektraportin e kontrollit nga Anëtarët e Komisionit të Marrjes në Dorezim të pajisjeve.

4.9. Kontroll në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Gjirokastrë.

Kontrolli u ushtrua vetëm për zbatimin e punimeve për "Ndertimin e Godinës për Sistemin e Sektorit të Lejeve të Drejtimit dhe Kontrollit Fizik", për Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Gjirokastrë.

Nga kontrolli u konstatua:

Ndertimi i këtij objekti u bë i domosdoshëm për krijimin e ambjentëve të reja për zyra administrative dhe sallë shërbimi për DRSHTRR, Gjirokastrë.

Projekti i zbatimit dhe preventivi për godinën e re është hartuar nga Ing. Genci BREGU dhe Andi DEJI me vlerë të preventivuar të përpunuar nga Znj. Etleva DANAJ 20,990,075 leke me TVSH. Kjo vlerë shërbeu për përcaktimin e fondit limit të objektit.

Objekti përbëhet nga tre nënobjekte:

1. "Rikonstruksioni i Godinës Ekzistuese", me vlerë të preventivuar 2,242,106 leke me TVSH.
2. "Godinë e Re 2 kate", me vlerë të preventivuar 17,898,526 leke me TVSH dhe "Fenda e kontrollit fizik", me vlerë të preventivuar 849,441 leke me TVSH.



Operator fitues është shpallur shoqëria "REDIUM & NEAL -86" sh.p.k. me të cilën është lidhur kontrata e sipërmarrjes me datë 07.12.2010 me nr.2922 prot. me vlerë 15,643,148 leke me TVSH ose 25% me ulët se fondi limit, me afat perfundimi 150 ditë kalendarike.

Gjatë procesit të zbatimit të punimeve në objektin kryesor "Ndërtimi i zyrave të reja,, janë bërë ndryshime të projektit të zbatimit që lidhen me sistemin e ngrohje ftohjes. Sipas projektit fillestar të hartuar nuk ishin parashikuar punimet e gipsit për tavanin e godinës së re për 206.4 m2 dhe mure gipsi për 6.8 m2 me vlerë 511,680 leke me TVSH të cilat u situacionuan nga operatori fitues. Kryerja e këtyre punimeve solli që punimet e parashikuara e të preventivuarat për nën objektin "*Tenda e kontrollit fizik,*" të mos perfundojnë plotësisht, të mos kryen punimet për mbulimin e objektit dhe aktualisht ky nënobjekt nuk ka perfunduar. Për perfundimin e tij janë kërkuar fonde shtesë të cilat nuk janë miratuar akoma nga DPSHTRR, Tirane.

Situacioni perfundimtar është në vlerën 15,639,198 leke me TVSH.

Objekti është marrë në dorezim me datë 15.10.2011 dhe është vënë në shfrytëzim me përjashtim të nënobjektit "*Tenda e kontrollit fizik,*"

Nga kontrolli i kryer mbi dokumentacionin teknik të zbatimit dhe verifikimet e punimeve në objekt nuk rezultuan shkelje.

Nuk u paraqitën observacione, pasi aktverifikimi i mbajtur është konfirmuar nga punonjësi perkates.

IX. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në DPSHTRR, nga grupi i kontrollit, u hartua pyetësori u hartua pyetësori i përshtatur për këtë institucion, duke ndërtuar pyetje të mundshme për komponentët "Mjedisi i kontrollit", "Menaxhimi i riskut", "Aktivitetet e kontrollit", "Informimi dhe Komunikimi" dhe "Monëtorimi" me synim vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Nga kontrolli i ushtruar rezultoi:

1- Në zbatim të nenit nr 9 të ligjit nr 10 296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" është dërguar në Ministrinë e linjës Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë DPSHTRR dhe pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e MF&K për vitin 2011.

2- Nga ana e njësisë të varëtisë Drejtorisë së Përgjithshme nuk është hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme raporti për gjendjen e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm sikurse përcaktohet në nenin nr 9 pika 3 e ligjit nr 10296 datë 08.07.2010 sipas të cilit: Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë të varëtisë janë përgjegjës dhe i raportojnë nëpunësit autorizues sipas shkallës hierarkike deri te nëpunësi autorizues i njësisë publike për statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm për riskun e mashtrimit e të parregullsive dhe të çdo mangësie serioze që pengon realizimin e objektivave ose risqe të cilat nuk janë adresuar nga njësia, masat korrektuese të marra dhe të përmbushura nga nivelet e menaxhimit të njësisë që drejtojnë.

Zbatimi i këtij kriteri ligjor vlerësohet i domosdoshëm me synim identifikimin nga Nëpunësi autorizues i Drejtorisë së Përgjithshme të të gjitha mangësive dhe përcaktimin dhe marrjen e masave që synojnë zbatimin e kritereve të Ligjit "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" edhe nga ana e njësisë të varëtisë.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e DPSHTRR-së si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit më poshtë rendisin mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë



komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në drejtim të plotësisimit të kriterëve për çdo komponent të menaxhimit financiar dhe kontrollit për periudhën që është realizuar pyetësori, po pasqyrojmë në mënyrë përmbljedhur rezultatet, si më poshtë :

1. Në drejtim të Mjedisit të Kontrollit

Mjedi i kontrollit i jep tonin të gjithë institucionit. Ai përbën themelet ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të menaxhimit financiar dhe kontrollit, pasi vendos strukturat dhe disiplinën.

Në lidhje me kërkesën e bërë nga ana jonë që: A kenë plan-veprime të miratuara për arritjen e qëllimeve strategjike, që përmbajnë veprime, afate, dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar?

Në përgjigjen e dhënë citohet që: Në plotësimin e programeve strategjike 5 vjeçare përkrahur dhe rrugët e realizimit të tyre. Megjithatë nuk ka ndonjë plan veprimi ku të përcaktohen detyrat dhe veprimet që duhen ndërmarre duke përcaktuar afatet dhe emrat e personave përgjegjës.

Përsa i përket verifikimit nëse ka ndonjë rregullore/udhëzim të brendshëm në mbështetje të kuadrit ligjor egzistues mbi etikën, konfliktin e interesit, marrëdhëniet midis menaxhereve, marrëdhëniet me të tretët, u konstatua se është hartuar një rregullore e re "Rregulloja e Personelit" që parashikon raportet punedhënës-punëmarrës dhe midis vete punëmarrësve, pjesë integrale e së cilës është edhe Kodi i Sjelljes ku përcaktohet edhe konflikti i interesit dhe deklarimi i tij, marrëdhëniet me të trete etj.

Përsa i përket vlerësimit të nënkomponentit –"Struktura organizative duhet të jetë në funksion të objektivave të njësisë" rezultoi se:

Aktualisht në fuqi është Rregullorja e Brendshme e DPSHTRR, dërguar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit me shkresën Nr. 4463, datë 24.09.2003.
Sikurse konstatohet veprimtaria e këtij institucioni rregullohet me një akt të viti 2003 i cili nuk është aktual si dhe nuk i përgjigjet ndryshimeve strukturore që ka pësuar ky institucion në vite. Nga grupi i kontrollit u kërkuar informacion në lidhje me shkaqet e moshartimit dhe zbatimit të një rregulloreje e cila të përshtatet ndryshimeve strukturore që pëson ky institucion në vijimësi. Në informacione paraqitur theksohet se ka ndikuar edhe planifikimi dhe implementimi i projektit të automatizimit dhe informatizimit të shërbimit të regjistrimit të mjeteve dhe të gjitha shërbimeve të tjera. Grupit të kontrollit iu dorëzua një "Projekt rregullore" e cila reflekton ndryshimet e reja por ende nuk është miratuar.

1- Meqenëse kjo rregullore është në fazën e projektit nga ana e institucionit duhet të merren masa të reflektohen të gjitha detyrimet mbi reflektimin që rrjedhin nga Ligji "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" në lidhje me përgjegjshmërinë menaxheriale kompetencat dhe përgjegjësitë e Nëpunësit Autorizues, Nëpunësit Zbatues dhe menaxherët e tjerë të njësisë.

Në këtë institucion Nëpunësi autorizues është Drejtori i përgjithshëm ndërsa në rolin e nëpunësit zbatues është Drejtori Ekonomik i Drejtorisë.

2- Referuar organigramës Nëpunësi zbatues i drejtorisë së Përgjithshme dhe



KONTROLLI I RASTË TË RASTIT

RAPORTI PËR AUDITIMIN E DREJTUESIË DREJTORE E ZEMENDËS TË
TË SHËRREVEVE TË TË NËPUNËSIT DREJTORE

Drejtorisë rajonale të Tiranës referuar linjave të varësisë dhe raportimit rezultojnë në varesi të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm ekonomik ndërkohë që referuar nenit 12 të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenit 12 Përgjegjëshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues “ përcaktohet që: Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues për garantimin e cilësisë.....etj.

Në lidhje me nënkomponentin “Politikat dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore” rezultojnë se:

Në lidhje me pyetjen : A ekzistojnë rregullore të brendshme specifike lidhur me përzgjedhjen, emërimin si dhe përcaktimin e pages dhe të shpërblimeve për punonjësit apo lidhur me vlerësimin e performancës dhe vendosjen e sanksioneve në rast të mos përmbushjes së detyrave?

Në përgjigjen e kthyer dhe verifikimin e kryer rezultojnë se ky do të jetë objekt i rishikimit në projekt rregulloren. Edhe nga verifikimi në projekt rregulloren nuk u gjenden të përcaktuara procedurat që do ndjekë institucioni (konkurrim etj) për rekrutimin e punonjësve. Në përgjigjen e kthyer nënvizohet se Përmbushja e kritereve për çdo vend pune dhe përcaktimi i pages sipas tyre, përcaktimi i pages, shpërblimeve apo lidhur me vlerësimin e performancës bëhet me Vendim të Keshillit Drejtues të DPSHTRR rast pas rasti. E njëjta gjë vlen edhe për përcaktimin e nivelit arsimor sipas pozicioneve të punës (pra me Vendim K.D)

Në lidhje me pyetjen që: A keni miratuar ju përshkrime pune për çdo pozicion pune në institucion, në të cilat të përfshihen detyrat individuale që duhen kryer, kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme dhe linjat e raportimit? (kjo pyetje lidhet me punonjësit e të gjitha niveleve në institucion dhe përfshin edhe drejtuesit e lartë) Përgjigja e kthyer është që: Rregullorja e brendshme përmban të tilla. Megjithatë është objekt ndryshimi pasi nuk përshkruhet me ndryshimet strukturore aktuale.

Për sa i përket kryerjes së vlerësimeve periodike të punonjësve në institucion, lidhur me detyrat që ata kryejnë si pjesë e përgjegjësisë të tyre rezultojnë se nuk kryhen vlerësime periodike por në rregulloren e re të personelit janë reflektuar procedurat të tilla.

Në lidhje me vlerësimin e komponentit të Menaxhimit të riskut rezultojnë:

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin dhe analizën e risqeve që mund të kenë rëndësi për arritjen e objektivave të institucionit dhe përcaktimin e një përgjigjeje të përshtatshme ndaj këtyre risqeve.

Konstatohet se për këtë komponent nuk janë ndërmarrë hapat e përcaktuara në “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 21 Nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e riskut apo përcaktimi i procedurave për menaxhimin e riskut . Nga verifikimet rezultojnë se gjatë viti 2012 do të ndërmerrin hapat e nevojshme për përmbushjen e kërkesave ligjore.

3. Në Drejtim të Aktiviteteve të Kontrollit, të Informimit, Komunikimit dhe monitorimit.

Aktivitetet e kontrollit janë politikat dhe procedurat e vendosura për të adresuar risqet dhe për arritur objektivat e institucionit. Ato përfshijnë një gamë veprimesh kontrolluese me karakter parandalues dhe zbulues.

Në aktivitetet e kontrollit hyjnë një ndarje e përshtatshme e detyrave, në mënyrë që i njëjti person/strukturë të mos përfshihet njëherësh në zbatimin e dy, ose në shumë detyrave që lidhen me: miratimin, zbatimin dhe regjistrimin e operacioneve, vendosja e rregullave të



KONTROLLI I LIRISË E LUTORIT

RAPORTI MBI AUDITIMIN E LUTORIT NË DPSHTRR, SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RUGOR

brendshme mbi kontrollin para faktit ose paraprak të ligjshmërisë, veprime të përshtatshme kontrolli për sistemet e IT-së, etj.

Referuar përgjigjeve të pyetësorit rezultoi, se në këtë institucion vlerësohet më pozitivisht funksionimi i këtij komponenti dhe në disa aspekte ka ecuri progresive sidomos në informatizimin të të gjithë procesit të shërbimeve ndaj qytetareve.

Në informacion theksohet që: Ka përfunduar informatizimi i shërbimeve të Regjistrimit të mjeteve, taksave, shërbime të cilat janë konceptuar të qendëruara në serverat qendror të DPSHTRR-së. Si rezultat i këtij qendërimi dhe konceptimit të moduleve të vecanta të auditimit të cilat janë të instaluar në softet e reja behet kontrolli i të gjithë përdoruesve që punojnë me këto programe informatike. Projekti informatizimit i konceptuar nga Agjensia Kombëtare e Shërbimeve të Informacionit, ka parashikuar kontrollin e këtyre sistemeve.

4. Në drejtim të Informimit, Komunikimit të Informimit, Komunikimit dhe Monitorimit.

Informimi dhe komunikimi janë thelbësorë për zbatimin e të gjithë objektivave të kontrollit të brendshëm. Si proces i rëndësishëm, sistemet e kontrollit të brendshëm duhen monitoruar për të vlerësuar cilësinë e sistemit të performancës në kohë. Monitorimi kryhet nëpërmjet një monitorimi në vazhdimësi, nëpërmjet vlerësimeve të shkëputura, ose duke i kombinuar të dyja. Monitorimi i aktiviteteve të kontrollit të brendshëm duhet të dallohet qartë nga verifikimi dhe monitorimi i operacioneve të institucionit.

Në lidhje me këtë komponent vlerësohet pozitivisht funksionimi i tij pasi në mënyrë periodike kryhen analizat mbledhjet për veprimtarinë e hallkave të ndryshme të institucionit rezulton komunikim zyrtar shkresor dhe elektronik etj.

X. Vlerësimi i funksionimit të Auditimit të Brendshëm

Mbi organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm publik në DPSHTRR, është e organizuar në nivel drejtorie, si strukturë në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm dhe Këshillit Drejtues, konform kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe VKM Nr. 345, datë 01.06.2004 "Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm", Kapitulli II/4.

Me shkresën e MPPTT nr. 4836/1 datë 09.07.2008, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, funksionin sipas organikës së përbërë nga 3 punonjës, nga të cilët: një Drejtor Drejtorie dhe 2 specialistë. Struktura sipas arsimimit përbëhet, nga 2 punonjës me profesion ekonomist financë dhe 1 ekonomist industriale, të tre audituesit janë të certifikuar. Sipas kriterit të vjetërsisë së punës në strukturat e kontrollit dhe të auditimit, punonjësit grupohen: një punonjës deri në 5 vjet pune dhe dy punonjës mbi 10 vjet pune.

Hartimi i planeve të Auditimit të Brendshëm. Përgatitja dhe hartimi i programeve të auditimit, llojet e auditimit.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka në vartësi gjithsej 14 subjekte, nga të cilat 12 Drejtori Rajonale. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për vitin 2010 ka hartuar planin vjetor, i cili është miratuar nga Titullari me nr. prot.769S, dt. 06.11.2009 dhe nr. prot.7993, dt. 15.11.2010, për ushtrimin e veprimtarisë audituese, në mbështetje të kërkesave të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe VKM Nr. 345, datë 01.06.2004 "Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm", Kapitulli II/4. Për periudhën objekt kontrolli fushat prioritare të auditimit dhe veprimtaria audituese është përqëndruar kryesisht në:



-Programimin dhe kryerjen e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke ruajtur frekuencën e auditimit, vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit.

-Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tij.

-Auditimi në vazhdimësi i rekomandimeve të dhëna bazuar në planin për ndjekjen e tyre.

Prioritetet e drejtorisë së auditimit, në zbatim të kërkesave të ligjit për auditimin, kanë qenë auditimet e plota në subjekte, si auditime me efektivitet si dhe auditimet tematike me probleme që paraqiten në drejtimit:

-Auditimi i fondeve të miratuara, shpenzimet dhe të ardhurat e realizuara.

-Auditimi i realizimit të investimeve dhe realizimi i kontratave.

-Zbatimi i procedurave të prokurimit publik.

-Deklaratat financiare dhe bilanci kontabël.

-Administrimi i vlerave materiale e monetare.

-Zbatimi i tarifave dhe afateve të shërbimit, taksave të regjistrimit, qarkullimit dhe të lejeve të drejtimit, si dhe shërbimet e tjera që ofron DPSITR.

-Zbatimi i ligjeve, udhëzimeve e shkresave të nxjerra nga MPPTT apo DP në sektorët e shërbimit në drejtoritë rajonale.

Për vitin 2010 në planin e auditimit janë parashikuar 13 auditime të plota të ndarë sipas 3/mujorëve. Frekuenca e auditimit është parashikuar konform VKM nr.345, datë 01.06.2004 "Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm, kodit etik dhe të kartës së auditimit të brendshëm publik", sipas të cilit të gjitha objektet janë parashikuar për t'u kontrolluar dy herë në tre vjet. Programet e auditimit janë hartuar në mënyrë të veçantë për çdo auditim dhe sipas veçorive të çdo objekti që i nënshtrohet auditimit. Në programet e kontrollit është parashikuar:

- Auditimi i aktivitetit ekonomiko-financiar;

- Auditimi i performancës;

- Auditimi i pajtueshmërisë, në të cilën janë parashikuar për t'u audituar investimet e kryera me fondet e ndërmarrjes, blerjet e mallrave, shërbimet dhe procedurat e prokurimit, auditimi i pasqyrave financiare, auditimi i llogarive dhe i bilancit kontabël.

Kryerja e auditimeve është zhvilluar në bazë të planit, duke u bazuar në vlerësimin e riskut, nivelin e materialitetit, flukset e punës, objektivat e institucionit dhe ecurinë e tyre etj.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", VKM nr.345, datë 01.6.2004 "Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm", seksioni II, pika 9 "frekuenca e auditimeve", për t'u dhënë prioritet në fillim të vitit, auditimit të subjekteve që plotësojnë frekuencën gjatë vitit 2010-2011 dhe në varësi të burimeve të auditimit, është synuar që subjektet t'i nënshtrohen auditimit ç'do vit, qoftë dhe për probleme të veçanta.

- Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit.

Për vitin 2010 janë planifikuar për auditim të plotë 13 drejtoritë Rajonale Durrës, Korçë, Shkodër, Elbasan, Kukës, Berat, DP, Gjirokastrë(Sarandë), Laç, Tiranë, Fier, Vlorë dhe Drejtoria Targave dhe Shtypshkrimeve.

Për vitin 2011 është hartuar dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me shkresën nr.prot.7993, dt.15.11.2010, objekti dhe programi i auditimit të brendshëm ku janë planifikuar për auditim gjithsej 14 subjekte nga të cilët të plotë 6 drejtoritë Rajonale Korçë, Dibër, Shkodër, Kukës, Gjirokastrë, Sarandë dhe 8 të pjesshëm në drejtoritë Rajonale Durrës, Elbasan, Berat, DP, Laç, Tiranë, Fier, Vlorë.



REPUBLIKA E ALBANIË

MINISTRI E TËRËSIA DHE INFRASTRUKTURË
DIPLOMË E PËRFUNDIMIT DHE RAPORTI I
TË TË DOKUMENTIT E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURË

Dokumentacioni i auditimit është plotësuar konform dispozitave ligjore, kështu, para fillimit të auditimit janë plotësuar deklaratat përkatëse në se audituesi ka konflikt interesi me subjektin e kontrollit. Në përfundim të kontrollit janë mbajtur procesverbale apo aktverifikime dhe më pas është hartuar Projekt Raporti i Kontrollit, i cili është lënë në dispozicion të subjektit të kontrollit sipas afatave të përcaktuara në ligjin për auditimin në sektorin publik. Janë shqyrtuar me korrektësi sqarimet apo observacionet e subjektit të kontrolluar dhe mbi bazën e këtyre ndryshimeve është hartuar memorandum i për Raportin Final, me të cilin është informuar titullari dhe këshilli administrativ. Në përfundim të shqyrtimit nga këshilli drejtues, janë hartuar konkluzionet përfundimtare dhe është dërguar Raporti Final subjektit të audituar.

Në përfundim të çdo auditimi, është llogaritur kosto e auditimit, në të cilën janë përfshirë pagat e punës, dietat, si dhe shpenzime të ndryshme. Në fund të çdo viti kalendarik është llogaritur edhe kosto totale e shpenzimeve të kryera gjatë vitit ushtrimor.

- *Evadimi i materialeve të auditimit, ruajtja dhe arkivimi i tyre.*

Nga kontrolli rezultoi, se dosjet e auditimit të cilat konsiderohen të përfunduara janë arkivuar konform ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" së bashku me inventarin e dosjes.

- *Mbi auditimin e kryer nga organi epror.*

Auditimi nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit është kryer i plotë për periudhën 01.04.2009 deri në datën 31.03.2010 dhe për periudhën 01.04.2010 deri në datën 30.06.2011 sipas drejtimeve të përcaktuara në programin nr. 2263/3, datë 26.04.2010 dhe në programin nr.3297/2, datë 15.08.2011 e konkretisht mbi: Vlerësimin e Auditimit të Brendshëm dhe sistemin e kontrollit, vlerësimin e riskut, sistemin e informimit dhe komunikimit, auditimin e performancës, auditimin e pajtueshmërisë, auditimin e sistemit të pagave dhe auditimin e deklaratave financiare.

Nga kontrolli i ushtruar në treguesit ekonomikë të realizuar nga DPSHTRR për vitin 2010-2011 sipas raportit përfundimtar të kontrollit rezultoi:

000/lekë								
Treguesit	Program Viti 2010	Realizimi Viti 2010	Diferenca	Realizimi në %	Program Viti 2011	Realizimi Viti 2011	Diferenca	Realizimi në %
Të ardhurat	1,494,900	1,330,336	-164,564	88.99	1,443,910	1,470,499	26,589	101.94
Shpenzimet	1,133,676	1,076,666	-107,010	90.96	1,279,350	1,205,693	-73,667	91.24
Realizimi (bruto)	311,224	253,670	-57,554	81.51	164,560	264,806	100,246	160.93

Të ardhurat për vitin 2010, janë realizuar në shumën 1 330 336mijë lekë nga 1 494 900mijë lekë të programuar ose realizuar në masën 89%, dmth më pak në vlerë absolute 164 564mijë lekë. Në hartimin e programit të vitit 2010, nuk është vlerësuar numri i mjeteve të regjistruara në inventarin e DPSHTRR dhe që duhet të paguajnë taksat sipas ligjit, detyrë kjo e lënë dhe nga auditimi i MPPTT, i cili përbën një kapacitet fiskal, që duhet të përllogaritet e programohet si e ardhur e subjektit. Për periudhën e vitit 2010, me tejkalim të të ardhurave, paraqiten DR Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Shkodër, Tiranë, Vlorë dhe DTSII. Në raportimet e dërguara nga DR, në DPSHTRR, lidhur me shkaqet e mosrealizimit të të ardhurave janë: ulja e numrit të veprimeve, për ndërrimin e pronësisë së mjeteve, me hyrjen në fuqi të Udhëzimit nr.2, datë 25.07.2010 "Për taksën e mjeteve të përdorura", ulja e regjistrimeve të reja për mjete dhe motomjete, ulja e veprimeve, kryesisht regjistrimet e kursantëve të rinj, etj. Për vitin 2010, janë kryer shpenzime në shumën 1 076 666mijë lekë, ndaj 1 133 676mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik. Rezulton të jenë kryer shpenzime në shumën 107 010mijë lekë më pak ose në nivelin 90%. Konstatohen tejkalime në zërat: blerje materiale,



KONTROLI I ASHTË I FAKTIT

SEKTORI I PËR LIDHJET E GJITHSHKALLSHME TË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

karburant, blerje energji elektrike, udhëtime e dieta etj. Nga raportimet vjetore të dërguara në DPSHTRR, nga DR, nuk bëhet një analizë e detajuar e shkaqeve të tejkalimit të shpenzimeve sipas zërave përkatës, siç është rasti i DR Berat dhe Gjirokastrë. Gjithashtu, konstatohet mosprogramim i saktë i shpenzimeve për energji elektrike nga DR Fier, Dibrë dhe Laç. Fitimi bruto për vitin 2010, rezultoi në shumën 253 670 mijë lekë ndaj shumës 311 224 mijë lekë e parashikuar në program, pra rezultoi me një mosrealizim në masën 18.76% krahasuar me programin për të njëjtën periudhë.

Të ardhurat për vitin 2011, janë realizuar në shumën 1 470 499 mijë lekë nga 1 443 910 mijë lekë të programuar ose realizuar në masën 101.84%, dmth më shumë në vlerë absolute 26 589 mijë lekë. Për vitin 2011, janë kryer shpenzime në shumën 1 205 6693 mijë lekë, ndaj 1 279 360 mijë lekë të parashikuara në programin ekonomik. Rezultoi të jenë kryer shpenzime në shumën 73 667 mijë lekë më pak ose në nivelin 94.24%. Fitimi bruto për vitin 2011, rezultoi në shumën 264 806 mijë lekë ndaj shumës 164 550 mijë lekë e parashikuar në program, pra rezultoi me një realizim në masën 160.93% krahasuar me programin për të njëjtën periudhë.

-Hartimi i Raportit final të auditimit dhe sigurimi i cilësisë. Baza ligjore për detyrat e lëna dhe rekomandimi i masave për përmirësimin e gjendjes.

Raporti final është hartuar konform ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", VKM nr. 345, datë 01.6.2004 "Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm".

-Evidenca e zbulimeve nga auditimet e kryera. Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna dhe masat e marra nga subjektet e kontrolluara.

VITI 2010

000/lekë

Nr.	Misionet të realizuara	Ebazën dhe dën ekonomik	Masa për zhëdëmtim			Masa administrative		Rekomandime	
			Ngarkuar për zhëdëmtim	Zhëdëmtuar	Mbletur për zhëdëmtim	Propozuar	Zbatuar	Të dhëna	Zbatuar
1.	DR Durrës	94	94	94	0	2	2	13	10
2.	DR Korçë	1509.8	1509.8	592.1	917.7	3	3	13	13
3.	DR Shkodër	0	0	0	0	1	1	19	-
4.	DR Elbasan	0	0	0	0	0	0	8	8
5.	DR Berat	0	0	0	0	0	0	7	-
6.	DR Kukës	661.6	661.6	-	-	1	1	16	-
7.	DR Laç	1841.2	1841.2	356.4	1484.8	11	11	20	12
8.	DR Gjirokastrë	995.2	995.2	675.2	320	0	0	14	10
9.	DR Sarandë	0	0	0	0	0	0	7	6



KONSTATIMET E AUDITIMIT

KONTROLI I PËRSHKËRITËS AKADEMIA E SHKENCËVE DHE ARTET
E VËLJEVE E TRANSPORTIT AKADEMIA

10.	DR Tiranë	568	568	456.4	0	18	18	11	7
11.	DR Fier	351.5	351.5	-	-	0	0	5	-
12.	DR Vlorë	260.1	260.1	216.6	43.5	3	3	7	5
	SHUMA	6281.4	6281.4	2390.7	2461.2	19	39	145	70

Për vitin 2010 gjetjet nga auditimi janë në vlerën 6 281 400lekë që përbëhet nga evazion fiskal dhe dëm ekonomik i shkaktuar nga subjektet. Evazoni fiskal përbëhet prej taksa mjeteshe të paarkëtuara gjatë kryerjes së shërbimeve që ofron subjekti ndërsa dëmi ekonomik rrjedh nga mosarkëtimi i gjobave të kontrollit në rrugë apo me karakter financiar. Është zhdëmtuar vlefë prej 2 390 700 lekë ose 38% e shumës së kërkuar. Pjesa e mbetur është në pritje të arkëtimit të shërbimit të radhës së njetit të konstatuar me detyrime ligjore të paarkëtuara dhe arkëtimit pjesor nga paga e punonjësit përgjegjës. Janë propozuar dhe zbatuar në 38 raste masa administrative ndaj punonjësve përgjegjës. Subjekteve të audituara u janë lënë 83 rekomandime, nga të cilat 57 prej tyre janë realizuar ose 69%. Gjatë vitit 2010 janë lënë rekomandime përveç përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimi korrekt i detyrave funksionale, udhëzimeve apo legjislacionit. Auditimet pasardhëse i kanë konsideruar si të pazbatuara apo zbatuar pjesërisht këto rekomandime kur janë rikonstatuar përsëri mangësi të tilla. Të dhënat e mësipërme të detajuara për çdo subjekt janë:

-DR Durrës. Evazoni fiskal dhe dëmi ekonomik i konstatuar është 94 000lekë i cili është zhdëmtuar plotësisht. Janë propozuar dhe zbatuar 2 masa administrative. Janë lënë 13 rekomandime dhe zbatuar 10 prej tyre.

-DR Korçë. Evazoni fiskal dhe dëmi ekonomik i konstatuar është 1 509 800lekë i cili është zhdëmtuar në masën 39% ose 592 100lekë. Janë propozuar dhe zbatuar 3 masa administrative. Janë lënë 18 rekomandime dhe zbatuar 13 prej tyre.

-DR Kukës. Evazoni fiskal dhe dëmi ekonomik i konstatuar është 661 600lekë. Është propozuar dhe zbatuar 1 masë administrative. Janë lënë 16 rekomandime të cilat do të verifikohen në auditimin e radhës.

-DR Laç. Evazoni fiskal dhe dëmi ekonomik i konstatuar është 1 841 200lekë i cili është zhdëmtuar në masën 19% ose 356 400lekë. Janë propozuar dhe zbatuar 11 masa administrative. Janë lënë 20 rekomandime dhe zbatuar 12 prej tyre.

-DR Gjirokastër. Evazoni fiskal dhe dëmi ekonomik i konstatuar (rishikuar) është 995 200lekë i cili është zhdëmtuar në masën 68% ose 675 200lekë. Nuk janë propozuar masa administrative. Janë lënë 14 rekomandime dhe zbatuar 10 prej tyre.

-DR Tiranë. Evazoni fiskal dhe dëmi ekonomik i konstatuar është 568 000lekë i cili është zhdëmtuar në masën 80%. Janë propozuar dhe zbatuar 18 masa administrative. Janë lënë 11 rekomandime dhe zbatuar 7 prej tyre.

-DR Fier. Evazoni fiskal dhe dëmi ekonomik i konstatuar është 351 500lekë. Nuk janë propozuar masa administrative. Janë lënë 5 rekomandime të cilat do të verifikohen në auditimin e radhës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT "PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËR GJITHSHMË TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR".

-DR Vlorë. Evazioni fiskal dhe dëmi ekonomik i konstatuar është 260 100lekë i cili është zhvendësuar në masën 83% ose 216 600lekë. Janë propozuar dhe zbatuar 3 masa administrative. Janë lënë 7 rekomandime dhe zbatuar 5 prej tyre.

VITI 2011

Nr.	Gjetjet e rezultuar sipas auditimeve me bazë shtetimi	Subjekti i audituar	Vlera e gjetjes në 000/lekë	Vlera e urkëtar në 000/lekë
A.	Buxheti			
1.	Shpenzime telefonike të pabaratuara	DRSHTRr Durrës	75.6	0
2.	Pagesa për shpërblime komisionit të kundërvajtjeve administrative	DRSHTRr Diber	75	75
3.	Pagat e punonjësve, % vjetërsisë	DRSHTRr Diber	5	5
4.	Procese gjyqësore	DRSHTRr Korçë	809	0
B.	Sistemi i Prokurimeve			
1.	Diferencë në primin të ofruar me atë të kontraktuar e të zbatuar.	DRSHTRr Laç	47.9	47.9
C.	Sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të institucionit			
1.	Moskëmbim për gjëra të kontrollit rrugor sipas pronësisë (Për mjete të tjera që kryejnë shërbime).	DRSHTRr Laç, Korçë	69	69
2.	Moskëmbim gjelash të KR në mjete që kanë kryer shërbime pranë DR.	DRSHTRr Laç, Korçë, Diber, Durrës, Vlorë, Sarandë	375.2	135.6
3.	Mbi licensimet dhe certifikatat, rrahimi i lëshimeve përkatëse	DRSHTRr Laç, Elbasan	23.5	23.5
4.	Evazion fiskal që rrjedh nga moskëmbimi i taksave, mospërcaktimi i saktë i parametereve në DRM.	DRSHTRr Diber, Vlorë, Tiranë	637	374.4
5.	Ardhëtor me tepër taksë në shërbimet e DRM	DRSHTRr Diber, Elbasan, Vlorë, Tiranë	368.9	0
6.	Evazion fiskal që rrjedh nga moskëmbimi i taksave, në sektorin e Taksave	DRSHTRr	323.8	0
7.	Dëmi ekonomik që rrjedh nga moskëmbimi i gjoshes së KTV	DRSHTRr Tiranë, Vlorë, Sarandë	2437	0
	SHUMA		4876	510.4

Masat për zhvendësimin. Çdo dëm ekonomik, evazion fiskal apo shkelje e disiplinës financiare me karakter ekonomik e konstatuar, e raportuar është shoqëruar me zhvendësim të saj në rastet kur përgjegjësia dhe baza ligjore kanë qenë të evidentueshme.



KOMITETI I ARTIT DOKUMENTI

REKORDI PËR AUDITIMIN E Udhëimeve të Drejtimit të Përgjithshme të
Qendrës së Transportit Publik.

-Për Durrës janë dhënë 5 masa zhdëmtimi, një për shumën 75.7mijë lekë (shpenzime telefonike) dhe katër sipas personave përgjegjës për shumën e mbetura pas parashkrimit të gjobave të kontrollit në rrugë të konstatuara të paarkëtuara nga mjetet përkatëse (vlera e konstatuar është 237.6mijë lekë).

-Për Laç janë dhënë pesë masa zhdëmtimi në vlerë totale 328.7mijë lekë ndaj katër punonjësve.

-Për DR Korçë është dhënë 1 masë zhdëmtimi për arkëtim 500lekë. Është kërkuar me proces gjyqësor zhdëmtimi ndaj personit përgjegjës i shumës 809mijë lekë, dëm që rrjedh nga humbja (për faj të tij) i dy proceseve gjyqësore me vlerën e mësipërme.

-Për Dibër janë dhënë 2 masa zhdëmtimi në vlerë totale 94.4mijë lekë ndaj shtatë punonjësve.

-Për DR Vlorë janë arkëtuar 118.4mijë lekë. Gjithashtu është kërkuar zhdëmtimi i 323.8mijë lekëve ndaj 2 punonjësve. Vlera prej 240mijë lekë pas rakordimit përfundimtar me shoqërinë SGS Automotive Albania do të kërkohej për zhdëmtim 2 punonjësve përgjegjës.

-Për DR Sarandë janë arkëtuar 4600 lekë. I është kërkuar zhdëmtimi prej 9 mijë lekë dëm ekonomik 1 punonjësi përgjegjës.

-Për DR Tiranë janë evidentuar përfundimisht dhe kërkuar për zhdëmtim 10 punonjësve 462.6mijë lekë evazion fiskal. Gjithashtu pritet të saktësohen arkëtimet e taksave për rreth 600 mjete me mungesë informacioni, punonjës përgjegjës janë 8 të tillë. Vlera prej 2 188mijë lekë pas rakordimit përfundimtar me shoqërinë SGS Automotive Albania do të kërkohej për zhdëmtim 16 punonjësve përgjegjës.

Pas miratimit të memorandumeve nga Titullari u janë dërguar rekomandimet e lëna subjekteve të audituara të cilat janë dhe objekt auditimi në misionin pasardhës. Nisur nga konstatimet e shprehura në raportimet, të shoqëruara nga përgjegjësitë në burime njerëzore e ligjore, në përfundim të çdo misioni auditimi janë lënë dhe rekomandimet përkatëse. Çdo konstatim i shoqëruar me gjetje të karakterit teknik e financiar që nuk është parashikuar në udhëzimet e shkresat aktuale të nxjerra nga DPSHTRr përbëjnë objekt rekomandimi. Ato janë për subjektin e audituar si dhe për Drejtorinë e Përgjithshme e drejtuar sipas Drejtorisë përkatëse. Më të detajuara janë:

-Për DR Durrës janë lënë 7 rekomandime kryesisht për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe funksionimin e sektorit të kontrollit në rrugë.

-Për DR Laç janë lënë 5 të tilla ku në veçanti përmendim përmirësimin në fushën e liqensimeve dhe arkëtimin të gjobave të kontrollit në rrugë.

-Për DR Korçë janë lënë 6 rekomandime kryesisht për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, funksionimin e sektorit të kontrollit në rrugë, liqensimet, shpenzimet etj.

-Për DR Elbasan janë lënë 7 rekomandime kryesisht për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, degës së lejes së drejtimit dhe shpenzimeve. Njëkohësisht është rekomanduar shkurtimi i strukturës së kontrollit në rrugë.

-Për DR Vlorë janë lënë 7 rekomandime kryesisht për përmirësimin e sistemit të ruajtjes dhe administrimit të letrave me vlerë.

-Për DR Sarandë janë lënë 8 rekomandime kryesisht për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe informacionit.

-Për DR Tiranë janë lënë 6 rekomandime në lidhje me përmirësimin e dokumentimit dhe arkëtimin të vlerave monetare në sektorin e taksave.

Masat administrative. Krahas gjetjeve, përcaktimit të bazës ligjore të shkelur dhe përgjegjësiave janë rekomanduar dhe zbatuar masa disiplinore administrative.

-Për DR Durrës janë dhënë 3 vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra ndërsa 1 punonjësi ka shkëputur më parë marrëdhëniet e punës.

-Për DR Laç janë dhënë 3 vërejtje me paralajmërim dhe për largim nga detyra 5 vërejtje.



-Për DR Korçë janë dhënë 6 vërejtje të thjeshta, 1 vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra dhe 2 largime nga puna.

-Për DPShTRr nuk janë propozuar masa administrative ndërsa në DRShTRr Vlorë, Tiranë mendohet se numri i tyre do të jetë i lartë referuar gjetjeve në këto misione auditimi.

Zbatimi i tyre ka qenë i pjesshëm në DPShTRr dhe DRShTRr-te, kryesisht të arkëtimit të shumave për zhdëmtim nga personi përgjegjës (të cilët nuk kanë marrëdhënie pune me DR) apo arkëtimit të taksave të mjeteve (mosparaqitje për shërbim të radhës të mjeteve).

Për çdo auditim të përfunduar në drejtoritë rajonale Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka hartuar kapitull të veçantë për:

1.**Vlerësimin e riskut.** Një vend të rëndësishëm në programet e auditimit ka qenë edhe vlerësimi i riskut dhe matja e mundësisë së ekzistencës së tij në fushat ku krijohen të ardhurat e institucionit. Në raportet dhe konkluzionet përfundimtare vëmendje e veçantë i është kushtuar auditimit të aktivitetit ku krijohen të ardhurat si në kontrollin teknik periodik dhe në respektimin e dispozitave ligjore për taksat që paguajnë drejtuesit e mjeteve.

2.**Vlerësimin e drejtimit.** Në programet e kontrollit dhe në auditimet e kryera, është parashikuar vlerësimi i drejtimit të çdo drejtorie rajonale. Në përfundim të kontrollit është konstatuar se nga drejtoritë rajonale në hartimin e programit ekonomik e financiar për vitet 2010 dhe 2011 nuk janë parashikuar dhe përcaktuar mënyrat dhe rrugët për arritjen e objektivave në drejtim të arkëtimit të detyrimeve të prapambetura nga drejtuesit e mjeteve që nuk paraqiten për pagimin e detyrimeve sipas ligjit, pasi këto detyrime përbëjnë rezerva potenciale të konsiderueshme në të ardhurat e institucionit. Gjithashtu drejtoritë rajonale nuk kanë përcaktuar mënyrat e zgjidhjes për arkëtimin e tyre. Një ndër mangësitë kryesore në sistemin e drejtimit të drejtorive rajonale që Drejtoria e Auditimit ka konstatuar, është mosmarrja e masave të plota në drejtim të arkëtimit të taksës së regjistrimit të mjeteve, me pasojë evazion fiskal në disa drejtori rajonale e konkretisht për vitin 2010 kemi: 1 508 mijë lekë në fund të 3/m- I-rë, 1 831.4 mijë lekë në fund të 3/m II-të, 122.8 mijë lekë në fund të 3/m III-të dhe 424.4 mijë lekë në fund të 3/m IV-të të cilat janë lënë për arkëtim në shërbimin në të parë të këtyre mjeteve pranë DR-le apo personelit përgjegjës. Pësha kryesore e diferencës së mësipërme është konstatuar në DR Korçë me 1 410 mijë lekë dhe DR Laç me 1 804 mijë lekë.

Për vitin 2011 e kemi në total jo të ndarë në 3/mujorë si gjetje të rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi në buxhet, në sistemin e prokurimeve dhe sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të institucionit për drejtori rajonale të ndryshme të vendit për shumën 4 876 mijë lekë vlera e gjetjes dhe vlera e arkëtuar 530.4 mijë lekë.

3.**Auditimin e deklarave financiare.** Gjatë auditimeve një vend të rëndësishëm ka zënë auditimi i veprimeve për arkëtimin e taksave dhe derdhja e tyre në afat në buxhetin e shtetit. Në këtë drejtim vëmendje e veçantë i është kushtuar kontrollit të njëpasnjëshëm të veprimeve të arkës, mbylljen e rezultatit në fund të ditës dhe derdhjen e tyre në bankë në favor të Buxhetit të Shtetit. Në disa raporte auditimi janë evidentuar se, disa drejtori rajonale në fund të muajit mbajnë gjendje e lartë e mjeteve monetare mbi kufirin e lejuar, për këtë grupit i auditimit ka marrë masa të menjëhershme për derdhjen e mjeteve monetare në bankë. Në DR Durrës janë konstatuar vonesa në pagesa të detyrimeve ndaj Thesarit për të ardhurat nga gjobat e kontrollit në rrugë, licencimeve dhe certifikatat në fushën e transportit rrugor etj. Në DR Laç dhe Sarandë është konstatuar një raportim i pasaktë i evidencave periodike mbi aktivitetin e sektorit të kontrollit në rrugë ndërsa në DR Dibër mosraportim të saktë të shpenzimeve në zërin "Riparim e mirëmbajtje". Nuk është pasqyruar në librin e blerjeve në DR Laç një blerje duke shkaktuar evazion fiskal prej 11.6 mijë lekë TVSH të pa raportuar. Në DR Gjirokastrë është konstatuar likuidimi i shoqërisë së sigurimit të objektit sipas vlerës së faturës mujore, vlerë e cila duhej



ndarë sipas përkatësisë me shoqërinë SGS (konçensionare për shërbimin KTM) për muajt Nëntor 2009-Shkurt 2010 dhe arrin vlerën 849.2mijë lekë. Në DR Fier nuk është raportuar TVSH e zritshme për shumën 93.7mijë lekë ndërsa në DR Tiranë janë likuiduar me vonësë TAP

dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore (gusht 2008) duke u gjobitur ky subjekt me 397.3mijë lekë.

4. *Auditimi mbi respektimin e organikës, strukturën dhe pagat.* Nga auditimet e kryera është konstatuar se në përgjithësi Drejtoritë Rajonale kanë respektuar organikat dhe tabelat e pagave të miratuara nga Bordi Drejtues.

5. *Auditimi e bilancit kontabël.* Në programet e auditimit dhe në raportet finale një vend me rëndësi ka zënë edhe auditimi i bilancit kontabël të periudhës ushtrimore. Nga auditimet ka rezultuar se, sektorët e financës kanë zbatuar drejt ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet, e për rrjedhojë në pasqyrat financiare janë paraqitur në mënyrë korrekte jo vetëm pasuria e ndërmarrjes por edhe të ardhurat, shpenzimet dhe rezultati përfundimtar.

6. *Mbi auditimin në sektorin e lejeve të drejtimit.* Janë zbatuar drejt procedurat e regjistrimit për rinovimet ashtu dhe për paisjen për herë të parë me leje drejtimi. Megjithatë janë konstatuar dhe mangësi në pranimin e dokumentacionit. Tarifat dhe afatet e shërbimit janë zbatuar. Tarifa e riprovimit në disa raste nuk është arkëtuar në momentin e lindjes së këtij detyrimi por disa ditë pas përfundimit të shërbimit, kjo në DR Korçë. Vonesa janë konstatuar në transferimet e dosjeve të drejtuesve të mjeteve në drejtoritë e tjera rajonale si DR Kukës, Tiranë dhe Korçë. Janë konstatuar kursantë të regjistruar mbi kapacitetin maksimal të autoshkollave. Kjo në DR Fier dhe Vlorë.

7. *Mbi auditimin në sektorin e regjistrimit të mjeteve* janë zbatuar drejt procedurat. Tarifat dhe afatet e shërbimit janë zbatuar drejt. Vonesa janë konstatuar në transferimet e dosjeve të mjeteve në drejtoritë e tjera rajonale si në DR Korçë e Kukës. Për të gjitha regjistrimet e reja janë nxjerrë më parë nga sistemi të dhënat mbi arkëtimin e detyrimit doganor dhe verifikimi në sistemin e interpolit ASP-2 pritime të cilat janë nënshkruar dhe depozituar në dosjen e mjetit. Në DR Tiranë janë konstatuar vonesa në zhblokimin e dosjeve nga DTT apo nga Përmbarimi Gjyqësor, shërbimi i mjeteve që rezultojnë me të njëjtin numër identifikimi edhe pas ekspertizës ligjore. Në këtë rast duhej të kishte korespondencë me DP si autoritet vendimarrës.

8. *Mbi auditimin në sektorin e kontrollit rrugor* është i vetmi aktivitet me humbje në të gjitha DR-le. Mangësi janë konstatuar në vjeljen e këtyre gjobave ku në shkallë drejtorie ato janë arkëtuar 50%, janë kryer shërbime mjeteve me detyrime për gjobat të pa arkëtuara, janë parashkruar mjete të cilat kanë kryer shërbime pranë DR-le. Shumat përkatëse janë konsideruar dëm ekonomik dhe u janë vënë në ngarkim personave përgjegjës.

9. *Mbi auditimin në sektorin e kontrollit teknik* janë zbatuar procedurat e kontrollit teknik, tarifat dhe afatet e shërbimit. Është zbatuar Kodi Rrugor nen 79 pika 10 mbi tejkalimin e afatit të kolaudit të mjeteve mbi 10 ditë. Në disa DR kontrolli kryhet me metodën vizuale pasi nuk janë në funksion të gjitha paisjet e kontrollit teknik si në DR Laç, Gjirokastrë dhe Berat. Aktualisht ky shërbim është dhënë me konçension që prej shtatorit 2009.

10. *Vlerësimi i kontrollit të brendshëm.* Nga auditimet e kryera ka rezultuar se, drejtoritë rajonale kanë hartuar dhe miratuar nga titullarët planet e kontrollit të brendshëm. Ndërsa zbatimi i tyre ka qenë i pjesshëm dhe nuk është shtrirë në të gjithë sektorët e shërbimit, veçanërisht nga DR Laç, DR Korçë dhe DR Kukës.

Nga auditimet e kryera në drejtori rajonale është konstatuar se, në partitarin analitik të kreditorëve mbahen në analiza të veçanta subjekte për shërbime të arkëtuara por të pakryera. Në këtë llogari vlerë të konsiderueshme zënë taksat e paguara nga subjektet fizike e juridike,



shtetërore të cilët kanë kryer pagesën por nuk janë paraqitur për të kryer shërbimin e kërkuar, po kështu dhe në sektorin e lejeve të drejtimit. Kjo mënyrë veprimi pakëson padrejtësisht detyrimet e papaguara të pasqyruara në bilanc.

Sektori i taksave si aktivitet me risk të lartë, ka funksionuar mirë duke arkëtuar me përgjegjësi taksat në vazhdim si dhe ato të viteve paraardhëse. Si tregues kryesor për arkëtimin e taksave të mjeteve shërben rakordimi me numrin e kontrolleve teknik të mjeteve.

Nga rakordimi i kryer midis numrit të kontrolleve teknike me taksat e arkëtuara rezulton se, në të gjitha Drejtoritë Rajonale numri i taksave të arkëtuara ka qenë rreth 10-12% më i lartë se numri i kontrolleve teknike vjetore, pasi pagimi i taksave nuk përkon me afatin e kontrollit teknik periodik të mjeteve. Taksat e arkëtuara janë derdhur rregullisht në buxhet pas rakordimeve me drejtoritë rajonale të tatim-taksave dhe thesarit në rrethe. Me gjithë punën e mirë janë konstatuar dhe mangësi në arkëtimin e tyre e konkretisht: në DR Korçë dhe Laç ka mangësi në dokumentacionin e përcaktimit të saktë të llojit të mjeteve në kundërshtim me Udhëzimin "Mbi klasifikimin e mjeteve për efekt takse".

Në të gjitha këto raste grupi i auditimit ka llogaritur detyrimet e paarkëtuara sipas targave të mjeteve, i ka klasifikuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 1.803 mijë leke. Për këtë, Drejtoria e Auditimit ka dërguar informacion periodik Drejtorive Rajonale të Tatim Taksave, Organeve të Qarkullimit Rrugor dhe Prefekturave për mjetet me detyrime të pashlyera.

Në auditimet e kryera për blerjet me vlera të vogla, Drejtoria Auditimit ka konstatuar se, në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e VKM nr.1, datë 20.03.2007 megjithatë në disa Drejtori Rajonale janë konstatuar tejkalime të limitit të blerjeve me vlera të vogla për të njëjtin artikull apo grup artikujsh, si p.sh. në DR Elbasan, Durrës, Berat, Korçë, Gjirokastrë dhe DR Tiranë ku ndaj personave përgjegjës janë marrë masa disiplinore.

Nga kontrollet e kryera në procedurat e Prokurimit Publik, rezulton se është hartuar regjistri i parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike, të cilat janë dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik, konform ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" duke respektuar kufijtë monetare në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, llogaritjen e vlerës, hartimi dhe miratimi i dokumentacionit të tenderit kërkesat, afatet dhe kushtet për njoftimin e kontratës, njoftimin e fituesit, njoftimin e lidhjes së kontratës dhe publikimit të tyre në buletin e Agjencisë së Prokurimit Publik etj.

Autoriteti Kontraktor në DRShTRr Korçë, Laç dhe Tiranë kanë vepruar jo konform përcaktimeve të pikave përkatëse të VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar dhe VKM nr.45, datë 21.01.2009 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike", e konkretisht:

- Dosjet e procedurave të prokurimit janë të pasistemuara, pa inventarizuar dhe padorëzuara në arkiv.

- Nuk mbahet procesverbal nga njësia e prokurimit për përcaktimin e fondit limit, dokumentacionit standard të tenderit, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, kapaciteti financiar, garancia, sigurimi i kontratës, kriteret e përzgjedhjes etj.

- Mungojnë dokumentat standarde të tenderit.

- Formularët e deklarimit nëse ka konflikt interesi të njësisë së prokurimit janë pa datë dhe të panënshkruar.

- Nuk ka procesverbal për përcaktimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Nuk u paraqiten observacione për projekta raportin e kontrollit.



XI. Probleme të ndryshme të data gjatë kontrollit:

Gjatë kontrollit në përgjithësi, u vërejtën edhe disa anomali apo shqetësime që lidhen me procesin e vlerësimit të kryerjes së shërbimeve si më poshtë:

1. Për të regjistruar një mjet në Degen e Regjistrimit të Mjeteve, përveç të tjerash kerkohet edhe një vertetim nga Dega e Finances për të vertetuar faktin që subjekti nuk ka detyrime. Pra DRSHTRR kërkon një vertetim që leshohet po nga DRSHTRR. Kjo sjell vonesa në kryerjen e veprimeve të subjekteve që paraqiten në të gjithë DRSHTRR-te.

2. Vërehet një mungesë bashkëpunimi midis organeve të policisë së shtetit, organeve tatimore dhe DPSHTRR, konkretisht:

-Gjatë shërbimeve të rrabdhës që kryejnë pronaret apo drejtuesit e mjeteve në sportelet e DPSHTRR, nuk u kerkohet edhe një dokument që verteton se nuk kanë detyrime ndaj organeve të policisë rrugore për gjoba nga kundravajtjet administrative. Mungesa e këtij rakordimi sjell shmangjen e ketyre gjobave, pasi mjeti humbet gjunnet lehtësisht duke ndërruar targon pikerisht vetëm për shkak të gjobave të papaguara.

-Po kështu edhe subjektet që janë debitore ndaj zyrës së tatimeve kryejnë lehtësisht shërbimet pa u penguar në DRSHTRR, pasi nuk u kerkohet ndonjë dokument që i kanë shlyer detyrimet ndaj zyrës së tatimeve dhe anasjelltas zyra e tatimeve u kryhen veprime subjekteve pa u kërkuar me pare dokument që të vertetojë se kanë paguar detyrimet ndaj DPSHTRR. Këto veprime sjellin mosarketim të vlerave monetare në favor të buxhetit të shtetit.

U paraqiten observacione për problemet e mësipërme. Subjekti i vlerëson të drejte problemet e ngritura dhe sqaron se po punon për lidhjen e marrëveshjeve me institucionet e mësipërme.

Konkluzionet dhe rekomandimet:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME DHE PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

I. Për: Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe Ministrinë e Punëve Publike, Transportit.

1. Referuar disa tregueseve që pasqyrojnë rezultatet e drejtimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, ecuria e kësaj Drejtorie në dukje është pozitive dhe tejte e shëndoshë financiarisht, pasi për vitin 2010 ka realizuar fitim bruto 310,655,100 lekë. Por, nga analiza e të ardhurave të arkëtuara sipas objektivit kryesor të veprimtarisë për të cilën është krijuar kjo ndërmarrje, vërejmë se, nga totali i të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2010 prej 1,334,976,608 lekë, 76.7% e tyre ose 1,023,927,058 lekë janë të ardhura të shfrytëzimit, të cilat janë përcaktuese në ecurinë e shoqërisë. Pjesa tjetër prej 311,049,549 lekë janë të ardhura që nuk kanë të bëjnë me aktivitetin kryesor të kësaj ndërmarrje, pasi janë të ardhura dytësore. Pjesën më të madhe të këtyre të ardhurave e zënë të ardhurat nga kryerja e veprimtarisë si agjent tatimor për mbledhjen e taksave kombëtare për të cilat përfiton 5-6% të tyre, konkretisht, për vitin 2010 ka përfituar rreth 305 milion leke. Pra, fitimi para tatimit për vitin 2010 është 310,655,100 lekë, ndërsa të ardhurat nga agjenti tatimor janë 305 milion lekë, prej ku del qartë

• •



se, rezultati financiar pozitiv i ndërmarrjes ka ardhur nga aktiviteti si agjent tatimor. Po kështu, vlerat e tarifave të shërbimeve nga ky përfitohen të ardhurat e shfrytëzimit mbartin në strukturën e çmimit një norme fitimi tejte të lartë që shkon rreth 50-60 % kundrejt shpenzimeve të përgjithshme.

Nisur nga analizat e mësipërme ku dalin në pah rezerva në menaxhimin dhe administrimin e ndërmarrjes, si dhe nga Urdhri 8, datë 29.05.2008 i Ministrisë të PPT, me anën e të cilit, Ministri ka të drejtë të urdhërojë derdhjen në buxhetin e shtetit të fondeve të tepërta të krijuara nga fitimet e ndërmarrjes, konkretisht gjate vitit 2010 nga fitimi i ndërmarrjes janë derdhur në buxhetin e shtetit 200 milion lekë, me qëllim përmirësimin e formës së drejtimit të kësaj ndërmarrje e cila ka statusin juridik "Ndërmarrje Shtetërore me vetëfuancim, rekomandojmë që: *Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit duhet të rishikojë:*

-VKM nr. 343, datë 21.07.1999 "Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor" dhe Statutin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor nr.40703, datë 22.01.1999 i miratuar nga Ministri i Transporteve dhe Telekomunikacionit, i ndryshuar me Urdhrin nr.80, datë 29.05.2008 të Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor

1. Në vlerën e tarifës janë përfshirë të gjitha shpenzimet që kryhen për shërbimin e ofruar dhe mbi këtë vlerë është parashikuar që ndërmarrja të ketë 25% rentabilitet. Po kështu u analizua edhe çmimi i materialeve që kanë të bëjnë me blerjen e lëndës së parë dhe prodhimin e tyre e u vërejte se, mbi shpenzimet e përgjithshme është shtuar edhe një norme fitimi prej 30%. Pra, vlerat e tarifave të shërbimeve kanë në vetvete dy norma fitimi, një norme prej 30 % të çmimit të shitjes së prodhimit të materialeve dhe një norme fitimi 25 % të shitjes përfundimtare të shërbimit, si dhe të gjitha këto vlera pothuajse nuk kanë pësuar ndryshime që nga vitit 2008. Me qëllim përmirësimin e këtyre tarifave rekomandojmë që:

- Të rishikohen dhe të rivlerësohen të gjitha vlerat e tarifave të shërbimeve dhe për çdo vit të korrektohen në bazë të indeksit që tregon inflacionin zyrtar, referuar të dhënave të nxjerra nga Instituti i Statistikave (INSTAT). Tarifat e reja të propozohen për miratim Këshillit Drejtues dhe Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit.

Menjëherë

2. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm janë bllokuar dhe nuk lëvizim të gjitha automjetet që janë në dispozicion të sektorëve të Kontrollit Rrugor. Mungesa e këtij kontrolli, përveç mosarkëtimit të të ardhurave nga gjobat për kondravajtjet administrative, sjell indirekt edhe humbje të tjera që vijnë si pasojë e mos detyrimit të paraqitjes së shumë subjekteve në sportelet e DRSHTRR për të shlyer detyrimet e prapambetura që kanë ndaj saj. Me qëllim eliminimin e këtyre pasojave rekomandojmë:

-Të shfuqizohet Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Transportit Rrugor Nr. 168, datë 01.04.2011 "Për përdorimin e automjeteve të Sektorit të Kontrollit Rrugor". Fillimin e menjëhershëm të punës së sektorëve të kontrollit rrugor në Drejtorinë Rajonale.

Menjëherë

3. Nga rakordimi e numrit të mjeteve që kanë kryer kontroll teknik të detyrueshëm nga konçesionari me numrin e mjeteve të regjistruara të cilat kanë paguar taksat vjetore në DPSHTRR, rezultoi se, 6,655 mjete kanë paguar taksat vjetore, por nuk kanë kryer kontrollin teknik të detyrueshëm. Mos kryerja e kontrollit teknik, sjell mosarkëtim të tarifave të këtij



kryerja e këtij e shërbimi ju ngarkua edhe njëherë tjetër një personit fizik për të cilën është paguar përsëri në vlerën 202,500 lekë.

Menjëherë

2. Të ndiqen procedurat ligjore për t'i kërkuar firmës ndërtuese "Vila, sh.p.k", shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën 806,830 lekë. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht gjatë zbatimit të kontratës për "Instalimet elektrike në gabine, në rrjetin e jashtëm dhe në gjenerator për zyrat e reja të DRSHTRR, Tiranë", pasi ka llogaritur, situacionuar dhe përfituar TVSH mbi vlerën e makinerive e pajisjeve në shumën 806,830 lekë.

Menjëherë

3. Të ndiqen procedurat ligjore për t'i kërkuar firmës "A.P.G", shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën 385,600 lekë. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht gjatë zbatimit të

kontratës për furnizimin me pajisje dhe mobilimin e zyrave të reja të DRSHTRR, Tiranë, pasi pajisjet nuk janë në përputhje me specifikimet teknike siç kërkohet në kontratën e lidhur dhe në dokumentet e tenderit, si dhe janë marrë në dorëzim me mungesa për pasojë është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën e mësipërme.

Menjëherë

4. Të ndiqen procedurat ligjore për t'i kërkuar Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave: z. Eduart Gjermeni z. Adil Gjoni, z. Gjovalin Sula, z. Adriatik Gjura dhe z. Rasim Allushi, dhe ish-Drejtor Rajonal i Shërbimit të Transportit Rrugor, Tiranë z. Elez Gjoza shpërblimin e dëmit ekonomik në shumën 728,196 lekë. Këta punonjës kanë vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik në tenderin "për blerjen e pajisjeve dhe mobilimin e zyrave të reja të DRSHTRR, Tiranë", me fond limit 14,563,975 lekë, pasi tre operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike me vlera më të ulëta se oferta e fituesit janë tërhequr në mënyrë të njëanshme nga tenderi. Për këtë tërheqje brenda afatit të vlefshmërisë së ofertave, nuk u është konfiskuar sigurimi i ofertave në vlerën e mësipërme. Pasoja e kësaj shkeljeve ka sjell rritje fikrive të kostos së blerjes së pajisjeve në vlerën 2,276,500 lekë.

Menjëherë

5. Pas nxjerrjes së përgjegjësi të personat përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit ekonomik:

- Në vlerën 4,864,009 lekë, vlerë kjo që përfaqëson pagesat e dyfishta për të njëjtin vend pune për 5 punonjës të larguar nga puna gjatë periudhës 01.10.2009 deri më 31.12.2011, të cilët janë shpërblyer në bazë të vendimeve të Gjykatave, si pasojë e vendimmarrjeve të padrejta të ish-Drejtuësve të DPSHTRR.

- Në vlerën 10,679,066 lekë, pasi gjatë periudhës 01.10. 2009- 31.12.2011 në bazë të vendimeve të Gjykatave, si pasojë e vendimmarrjeve të padrejta të ish-Drejtuësve të DPSHTRR, janë shpërblyer 15 punonjës të larguar nga puna

KONTROLI I LARTË I SHTETIT